

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7475 E mërkurë 21 Mars 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Lakmia është një pasion që nënkupton një etje të pashuar për të fituar para, pasuri dhe çdo kënaqësi egoiste pa u interesuar për të tjerët, madje dhe duke ...
Vijon në faqen 20

Nga MIRON ÇAKO

Lakmia për para, burim i gjitha të këqijave



Opinion i Ditës

E vetmja gjë që nuk pritej dhe nuk u pa në zgjedhjet presidenciale të 18 mars në Rusi ishte një shenjë sado e vogël jete për social-demokracinë, tatëpjeta e të cilës ...
Vijon në faqen 21

Nga JORGJI KOTE

Pasokzimi i social-demokracisë



Zbardhet dosja e plotë e prokurorisë, ja personat e përfshirë

Skandali i pronave në Lezhë, skema si u vodh toka e shtetit me falsifikim

Dokumentet e 9 përfituesve u firmosën nga kryetari i Bashkisë Fran Frrokaj

Nga INA ALLKANJARI

Zbardhet skandali i pronave në bregdetin e Lezhës. "Gazeta Shqiptare" ka mundur të sigurojë dosjen e plotë në lidhje me tjetërsimin e pronësive së tokave në zonën "Rana e Hedhun" në Shëngjin. Në këtë dosje jepet në mënyrë ...
Në faqet 6-7

VENDIMI, CILAT JANE KATEGORITE PERFITUESE QE ÇLIROHEN NGA 609 MLN LEKE DETYRIM

FALEN KREDITE E SHTEPIVE, PERFITOJNE 1084 FAMILJE

Enti Shtetëror i Banesave: "Fshirja" për periudhën 1995 e deri më 31 dhjetor 2015. Arsyet, jetesa në kushte varfërie e pamundësia për të paguar



(Në foto) Pallate të vjetra

TAKIMET NE BRUKSEL

Kryeministri Rama: Duam negociatat, i dimë problemet që kemi. Mogherini: Ju mbështesim
Në faqen 3

NGJARJA NE DIBER

Ekzekutohet në derë të shtëpisë biznesmeni Elsi Kosiqi, kapet pas disa orësh autori
Në faqen 11

FAKTET KONKRETE

Skandali me listën fituese në portalin e infermierëve, emrat përsëriten disa herë
Në faqen 12

"SKICIDEJA IME"

Bujar Kapexhiu: Nuk e gëlltisim me pahir! Projekti i qeverisë për teatrin stonon
Në faqen 17

VIP PAGES



Tërhoqi vëmendjen e të gjithëve, flet policja seksi: Kush nuk i pranon komplimentet?
Suplement

Ministri i Financave dhe Ekonomisë nxjerr urdhrin dhe për shitjen

Vendim i ri, procedurat për privatizimin e tokave shtetërore

Kërkesa brenda 30 ditëve, toka me qira, afatet dhe çmimet e reja

Nga ORNELA MANJANI

Ndryshojnë procedurat për privatizimin dhe shitjen e tokave shtetërore. Këshilli i Ministrave ka miratuar ndryshimin e kriterëve të vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe pro-



cedurën e shitjes. Qeveria vendosi që kësaj procedure t'i nënshtrohen të gjitha ndërmarrjet apo objektet e veçuara, mjetet kryesore, mjetet e xhiros në administrim apo në ruajtje të institucioneve, ndërmarrjeve dhe shoqërive tregtare ...
Në faqen 9

BISEDIMET ME GREQINË REAGIMET

Presidenti flet pas autorizimit, Krisafi u shtohet negociatorëve

Pakti detar me Greqinë, Meta: Një proces solid e kushtetues

Presidenti Ilir Meta deklaroj dje se pas dhënies së autorizimit, mendon se bashkë me ministrin e Jashtëm, Ditmir Bushati kanë realizuar një bashkëpunim mjaft konstruktiv. Në një prononcim për mediat, kreu i shtetit tha pas përsëritjes së simpoziumit: "Imam Aliu midis traditës dhe modernitetit". Për bektashinjtë tanë Shqipëria ngelet mbi gjithçka! se janë në një proces solid. "Besoj se tashmë kemi realizuar një bashkëpunim mjaft konstruktiv dhe të dobishëm, për të pasur një proces solid e kushtetues, por edhe tekniko-logjore për negociatat sa më të suksesshëm. Unë

besoj se është bërë një punë mjaft e konsiderueshme dhe jemi në një proces solid nga pikëpamja kushtetuese", u shpreh Presidenti Meta. Në listën e grupit negociator është shtuar edhe profesori i së drejtës ndërkombëtare, Ksenofon Krisafi, për të cilin Meta tha se "ka qenë një propozim shumë pozitiv dhe i mirëpritur nga ana ime, pasi është një personalitet me mjaft eksperiencë në drejtësinë ndërkombëtare".

Pyetjet
Z. President, lidhur me



plotfuqishmërinë, ajo që u vu re në njoftimin për shtyp ishte fakti që ju i kërkonte Ministrisë për Evropën

dhe Punët e Jashtme që të zbatohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Kjo tregon që në informacionin e ardhur nuk është, le të themi, plotësisht i zbatuar vendimi i Gjykatës Kushtetuese, apo është një parantezë që ju i bëni që të jenë të kujdesshëm?

Besoj se tashmë kemi realizuar një bashkëpunim mjaft konstruktiv dhe të dobishëm për të pasur një proces solid nga pikëpamja kushtetuese, por edhe tekniko-logjore për negociatat sa

më të suksesshme për një marrëveshje të drejtë me Greqinë.

A i përmbushi të gjitha kërkesat tuaja ministri Bushati?

Unë besoj se është bërë një punë mjaft e konsiderueshme dhe jemi në një proces tashmë, do të thosha, mjaft solid nga pikëpamja kushtetuese.

U shtua një tjetër negociator. Nuk i përmbushte ai grup pritshmëritë? Sipas jush, duhet të ishte që në fillim pjesë e stafit?

Ka qenë një propozim shumë pozitiv edhe mjaft i mirëpritur dhe nga ana ime, për arsye sepse është një personalitet në fushën e së drejtës ndërkombëtare, por edhe me mjaft eksperiencë për raste të tilla.



Ministri i Jashtëm: Shpresojmë që për pak ditë të bëjmë raundin e parë të diskutimeve me palën greke

Bushati: Të mos përsërisim gabimet e 2009-ës me Greqinë

"Çështjet që ka shtruar presidenti do të jenë material mjaft i mirë orientues për negociatat"

Bisedimet Shqipëri-Greqi do të nisnin për pak ditë", - deklaroi dje ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati nga Brukseli. Në një intervistë për RTSH, Bushati u shpreh: "Jemi shumë të vendosur për të shkuar drejt një marrëveshjeje sa më të drejtë, sa më të ndershme, për të mos përsëritur asnjë nga gabimet e 2009-ës". Ai shtoi më tej se e rëndësishme është që marrëveshja të jetë e zbatueshme. I pyetur nëse autorizimi i presidentit kishte klauzola kufizuese, zoti Bushati tha se autorizimi është i bazuar në legjislacionin shqiptar dhe ka një material voluminoz, mjaft të mirë orientues për grupin negociator.

Presidenti dha dje autorizimin për vazhdimin e negociatave me Greqinë. A mund të na zbuloni konkretisht çfarë përmban ky autorizim dhe si do të vijojë ky proces në prill?

Presidenti i Republikës ka dhënë autorizimin që më krijon mua mundësinë si ministër i Jashtëm, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve të vendit, plotfuqishmëri për fillimin e bisedimeve me Greqinë, me synimin për të arritur një marrëveshje të re përsa i përket delimitimit të zonave detare. Natyrisht që pa humbur kohë, ne do të procedojmë me plotfuqishmërinë dhe shpresojmë shumë që për pak ditë apo javë të bëjmë dhe raundin e

parë të diskutimeve teknike me palën greke, bazuar mbi një proces pune voluminoz dhe një punë parapërgatitore që ka ndodhur gjatë katër viteve. Jemi shumë të vendosur për të shkuar drejt një marrëveshjeje sa më të drejtë, sa më të ndershme për të mos përsëritur asnjë nga gabimet e 2009-ës dhe natyrisht, për të respektuar normat ndërkombëtare, të aplikueshme dhe detyrueshme për Shqipërinë dhe Greqinë, vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese, e cila ofron një blueprint për atë se çfarë nuk duhet të bëjmë, duke pasur parasysh praktikën e hidhur të 2009-ës, legjislacionin e brendshëm shqiptar dhe ne besojmë dhe jemi të motivuar për të shkuar drejt një marrëveshjeje, e cila do të jetë e drejtë, e ndershme, me e mirë nuk diskutohet se marrëveshja e 2009 dhe në fund të ditës, urojmë që të kemi një marrëveshje që do të jetë e zbatueshme, sepse sic vërtetohet praktika. Është e rëndësishme që përmes një procesi të ndershëm të shkojmë drejt një marrëveshjeje, që është e zbatueshme për të dyja palët dhe të dyja palët duhet të dalin nga ky proces me ndjesinë që kanë negociuar një marrëveshje të drejtë për ta.

Zoti ministër, kishte klauzola kushtetuese autorizimi i presidentit?

Autorizimi i presidentit është i bazuar në legjislacionin shqiptar. Natyrisht gjatë



Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati

kësaj periudhe kohore kemi pasur konsultime, komunikime dhe ndërveprime me Presidentin e Republikës dhe institucione të tjera. Për të gjitha çështjet që Presidenti i Republikës ka shtruar, tani ka një material shtesë voluminoz edhe falë këtij ndërveprimi, që është një material mjaft i mirë, orientues për grupin negociator.

Zoti ministër, sa parashikohet të zgjasin negociatat?

E rëndësishme është që në planin teknik këto negociatat po fillojnë dhe Shqipëria po shkon drejt një marrëveshjeje të re. Besoj se kjo është mjaft e rëndësishme, duke pasur parasysh qëndrimet e palëve gjatë këtyre viteve, praktikën e 2009-ës, që

u hodh poshtë nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Kohëzgjatja e negociatave ka një rëndësi të dorës së dytë. Për ne, rëndësi të dorës së parë ka produkti që do të dalë nga këto negociata, duke pasur parasysh faktin se gjatë këtyre katër viteve kemi bërë një punë përgatitore, jemi konsultuar me ekspertizën e huaj, praktikën ndërkombëtare, vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese për ta respektuar atë në përputhje me të drejtën vendëse dhe kemi bërë disa bisedime eksploratore me palën greke. Nuk është se palët hyjnë në këto negociata me shumë të panjohura. Dihet se ku janë defektet dhe çfarë duhet të përmirësojmë. Ne besojmë që pas këtij procesi, të kemi

Myslym Pashaj: Duhet të jemi të gëzuar që po rinegociohet

I njohur si koloneli i "detit", Myslym Pashaj deklaroi dje se "duhet të jemi të kënaqur: të gëzuar që po rinegociohet. Ky nuk është një problem personal, por një kauzë që u zbulua rastësisht. Greqia kishte marrë ujërat tona. Ky ishte përfytyrimi që më ra mua në mendje, pra pikën treshë ta kenë të tre njerëz..." - tha Pashaj në një intervistë në "Report TV". Koloneli i "detit" bën edhe përlogaritjet sesa deti i mori Greqia Shqipërisë në vitin 2009. "Ne kishim 139 km vijë bregdetare, ndërsa Greqia në arqipelagun e Korfuzit kishte vetëm 86 km dhe kur u ndanë, Shqipërisë i kishte rënë për një 1 km vijë tokësore, ishin 10 km ujë, ndërsa Greqisë për një 1 km tokë, i kishte rënë 17.9 km2 vijë bregdetare. Dhe përgjigja ishte e tmerrshme, nuk e kemi bërë matjen".

atë marrëveshje që dëshirojmë.

Duket si një atmosferë e re në marrëdhëniet me Greqinë zoti ministër? Çfarë produkti do të sjellë takimi i kryeministrit Rama me Tsipras në Tiranë, në muajin prill?

Natyrisht që takimet në nivelin e kryeministrave janë të dobishme. Dihet që kryeministrat kanë peshën kryesore politike përmes mandatit që u bëjnë ekupeve respektive nga ministri i Jashtëm. Në fund të ditës, çonjë përpara të gjithë procesin, që ka rreth dy vite që ka nisur dhe ne shpresojmë që në radhë të parë të shtojmë produktet në marrëdhëniet mes dy vendeve tona dhe këto

produkte më pas të konkretizohen përmes marrëveshjeve konkrete, që mbështeten nga ana e dy kryeministrave. Shumë e rëndësishme që krahas çështjes së vulës apostile, të vijojmë diskutimin dhe për pak javë të kemi një tjetër produkt, siç është njohja e ndërsjellët e patentave, sepse do të çlirojnë energji pozitive në marrëdhëniet mes dy vendeve tona dhe natyrisht që do të vijojmë edhe me çështjet të tjera të paketës për të cilën ka një mirëkuptim për mënyrën se si duhet të veprohet, në mënyrë që në fund të këtij procesi, qytetarët shqiptarë dhe ata grekë të kenë mundësi të prekin efektet praktike të kësaj faze të marrëdhënive.



ER

Kryeministri në Bruksel, kërkon mbështetje nga "Miq të Shqipërisë"

Edi Rama: Duam negociatat, i dimë problemet. Mogherini: Ju mbështesim

Shefja e BE: Lufta ndaj krimit, një betejë që vijon

Darina Tanushi

Përfaqësuesja e lartë e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Bashkimit European, Federica Mogherini shprehu dje, besimin se Komisioni European në 3-4 muajt që vijnë do të japë një rekomandim të pakushtëzuar pozitiv për çeljen e negociatave me Shqipërinë. Në dëgjuesën me grupin "Miq të Shqipërisë në Parlamentin European", ku ishte i pranishëm edhe kryeministri Edi Rama, Mogherini shprehu po ashtu besimin se "Këshilli European do të vendosë në qershor që të çelë negociatat e më pas të fillojë dialogu". "Procesi i integritimit të Shqipërisë në Bashkimin European, është një proces integrimi i të gjithë Ballkanit Perëndimor në BE dhe nuk është një favor që ne bëjmë, është një çështje interesesh edhe për vetë BE-në", tha Mogherini. Në fjalën e saj, Mogherini foli me entuziazëm për progresin e arritur deri tani, duke cituar reformën në drejtësi dhe politikën në çështjet e jashtme si shembuj kryesorë. Ajo tha në këtë takim se "nuk bëhet fjalë thjesht për plotësimin procedurash. Në fakt, ajo që shoh është një vendosmëri dhe përkushtim i madh, një ndësi e të genurit evropian. Është dëshira dhe aspirata për të qenë pjesë e BE-së, kjo energji që ne këtun në Europë kemi kaq shumë nevojë, veçanërisht në kuadrin e trendit politik aktual. Kjo na kujton se çfarë është mbi të gjitha BE-ja". Ajo i tha Ramës se "në aspektin e rezultateve të arritura në procesin e reformimit, veçanërisht në reformën në drejtësi dhe politikën e jashtme, Shqipëria ka bërë gjëra të pabesueshme në vitet e kaluara dhe po lëviz në drejtimin e duhur. Nuk mungon asnjë lidhje. Jemi të gjithë 100% në të njëjtën anë". "Lufta kundër krimit të organizuar është një luftë që shumë vende e disa prej vendeve anëtare po e bëjnë në faza të ndryshme", nënvizoi ajo. "Dua të them se reformat e bëra janë të jashtëzakonshme dhe me rëndësi. Besoj se është e qartë se ju i shihni problemet që ende ka vendi juaj. Ky është një proces, dhe vetingu është një reformë që po prodhon rezultate. Lufta



Përfaqësuesja e lartë e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Bashkimit European, Federica Mogherini me kryeministrin Edi Rama

DEKLARATA
"Kemi probleme me korrupsionin, kemi probleme me krimin e organizuar, kemi probleme me ndërtimin e institucioneve dhe kjo është arsyeja pse duam të nisim bisedimet e të hyjmë në një fazë të re, e cila do të japë shumë herë më tepër ndikim edhe vetë komisionit dhe do të jetë një përgjegjësi shumë herë më e madhe për të gjithë ne", u shpreh Rama.

ISH-KRYEMINISTRI

Ish-kryeministri Sali Berisha e quan një akt tradhtie marrëveshjen mes qeverisë shqiptare dhe asaj greke për detin. Në një status në "Facebook", Berisha shkroi dje, se Rama dhe Bushati i fshehën Presidentit të Republikës dhe qytetarëve shqiptarë marrëveshjen e tyre të arritur me palën greke, me të cilën, sipas tij i kanë falur Greqisë fushat më të mëdha të gazit dhe naftës në Jon dhe Mesdhe.



Kreu i PE-së, Tajani: Trafiku i drogës duhet shkullur nga rrënjët

Kryetari i Parlamentit Evropian, Antonio Tajani tha dje, se siguria e Shqipërisë është siguria e Evropës. Gjatë fjalës së mbajtur në takimin e "Miqve të Shqipërisë" në Parlamentin Evropian, ai vlerësoi bashkëpunimin me Guardia di Finanza të Shqipërisë duke nënvizuar se fenomeni i trafikut të drogës duhet "shkullur nga rrënjët". Ai theksoi se në Ballkan përveç rrezikut terrorist, ka edhe interesa financiare që synojnë kolonizim financiar për të prishur natyrën e Ballkanit Perëndimor. "Siguria e Evropës lidhet edhe me sigurinë e Shqipërisë. Plani i vepërimit kundër krimit të organizuar që Rama ka nisur, duhet të nënvizohet. Unë e cmoj bashkëpunimin me Guardia di Finanza kundër trafikut të drogës. Ne e dimë që kjo është një plagë që duhet të kurohet. Duhet shkullur me rrënjët arsyet që na kanë sjellë deri në këtë situatë dramatike. Nuk mund të tolerojmë më dhe as nuk mund të lejojmë që të mos dënohen këto fenomene", u shpreh Tajani. "Jam shumë i shqetësuar çfarë po ndodh në Ballkan. Po përpiqen të ndryshojnë morfologjinë, praninë e besimeve financiare në Ballkan. Ka prani të shumë të financiarëve që ka disa qëllime se duan ta nxjerrin Ballkanin nga rrethi i miqësisë në Evropë", u shpreh kreu i PE-së. Tajani vlerësoi si një mesazh shumë të mirë edhe modelin e bashkëjetesës fetare në Shqipëri, ku nuk ekziston problemi i përkatësive të besimit fetar, ku të krishterët dhe myslimanët frekuentohen me njëri-tjetrin, xhamia është pranë kishës. Duhet që Ballkani të jetë një rajon paqeje, tha ai duke nënvizuar se "ne duam të ndalojmë faktin që Ballkani të mos mund të zgjedhë lirisht që të jetë pjesë e BE-së në të ardhmen".

TAKIMI ME HAHN

Kryeministri Edi Rama u takua dje, me Komisionerin e Zgjerimit Johannes Hahn. Në një frymë shumë pozitive u diskutua progresi i qëndrueshëm në përmirësimin e prioritetëve kyç të integritimit, në prag të Raportit të Progresit të Komisionit European të 17 prillit. Në takim u theksua ecuria e procesit të vetingut, që këtë javë hyn në fazën vendimtare të zbatimit, me fillimin e dëgjësive publike të gjykatësve e prokurorëve të nivelit të lartë përpara komisionit të shkallës së parë.



ndaj krimit të organizuar është një betejë që vijon edhe ne vende të tjera. Duhet pranuar që problemet ekzistojnë, dhe të punojmë së bashku për t'i zgjidhur ato", tha Mogherini. "A jemi gati të ecim përpara, sepse mendoj që është korrekte të themi se rreziku i të mos lëvizurit përpara është të mos rrezohemi. Nëse rrezohet Shqipëria apo Ballkanit Perëndimor nuk është aspak në interes të rajonit e aspak në interes të BE-së", deklaroi zyrtarja e lartë e BE. **KRYEMINISTRI**
Nga ana e tij, kryeministri Edi Rama u shpreh: "Nuk po them se jemi gati për anëtarësim që sot dhe as po

SHEFJA E BE-SË

"Besoj se është e qartë se ju i shihni problemet që ende ka vendi juaj. Ky është një proces, dhe vetingu është një reformë që po prodhon rezultate. Lufta ndaj krimit të organizuar është një betejë që vijon edhe ne vende të tjera. Duhet pranuar që problemet ekzistojnë, dhe të punojmë së bashku për t'i zgjidhur ato", tha dje, Mogherini.

kërkojmë ndonjë dhuratë apo kënaqësi të pamerituar. Po them vetëm se ka ardhur koha të hapim bisedimet, sepse e meritojmë. Gjërat i kemi bërë një nga një dhe saktësisht sipas udhëzimeve, jo sepse kështu na kërkoi Brukseli, por sepse kështu është mirë për vendin dhe brezin e ardhshëm". "Ne mendojmë se meritojmë plotësisht çeljen e bisedimeve për anëtarësim", tha Rama, që në nisje të fjalës së tij. Rama tha se rajoni i Ballkanit sot është i është përkushtuar tërësisht projektit evropian. Kryeministri u bëri eurodeputetëve një paraqitje të përmblendur të viteve të vështira që ka kaluar Shqipëria dhe po ashtu vendosmërisë e vullnetit që ka për t'u anëtarësuar në mesin e 28 vendeve të BE-së. Duke iu folur për reformën në drejtësi dhe garancitë që ka ky proces përmes ONM-së, Rama u shpreh: "sot, së paku 17 peshat të rënda të sistemit të vjetër janë tërhequr. Nuk kanë hyrë në procesin e vetingut, ndaj në një farë mënyre janë vetëpërfunduar, duke nisur nga ish-Prokurori i Përgjithshëm dhe gjyqtarët të Gjykatës Kushtetuese e të Gjykatës së Lartë, që është një ndryshim i jashtëzakonshëm". Rama kujtoi që ky ishte kusht i komisionit në 2016. "Ne kemi

probleme me krimin e organizuar, por asgjë të veçantë, ne këtë luftë duhet ta bëjmë, ashtu siç të gjitha vendet që e kanë kaluar këtë. Ne nuk po vijmë këtu të themi që duam të bëhemi anëtarë, sepse e dimë që nuk jemi të gatshëm të bëhemi anëtarë. Kemi probleme me korrupsionin, kemi probleme me krimin e organizuar, kemi probleme me ndërtimin e institucioneve dhe kjo është arsyeja pse duam të nisim bisedimet e të hyjmë në një fazë të re, e cila do të japë shumë herë më tepër ndikim edhe vetë komisionit dhe do të jetë një përgjegjësi shumë herë më e madhe për të gjithë ne", u shpreh Rama. "Kështu, dua ta përmbyll, dua të them që Shqipëria nuk po kërkon ndonjë dhuratë. Nuk po kërkon asnjë lloj favorit që nuk e meriton. Po kërkojmë thjesht çeljen e negociatave, sepse e meritojmë. Kemi bërë një nga një çdo gjë që është e shkruar në fletoren e detyrave të Shqipërisë dhe e kemi bërë sipas rregullave aty", u shpreh Rama. Më tej ai shtoi se, "duam të sigurohemi që ata që janë më skeptikë të kuptojnë që çelja e negociatave me Shqipërinë nuk është krijimi i një problemi të ri potencial, por është thjesht çelja e një procesi që do ta bëjë Europën më të fortë".

QEVERISJA AKUZAT

Kreu i PD: Mbi 20 mijë familje të përjashtuara nga ndihma ekonomike, vende pune 454

Basha i përgjigjet Ramës: Ka varfri dhe nuk ka punë

"Në Shqipërinë e vërtetë ka mjerim"

Valentina Madani

Kreu i opozitës Lulzim Basha, bëri dje publike shifrat që sipas tij tregojnë se në vend ka varfëri dhe papunësi. Në këtë mënyrë Basha iu përgjigj postimeve të kryeministrit Edi Rama, i cili përditë publikon historitë e grave të punësuar. Në postimin e tij z.Basha jep të dhëna për çdo qark sa familje janë në skemën e ndihmës ekonomike, sa janë përjashtuar dhe sa vende të lira pune. "Në Shqipërinë e vërtetë ka varfëri dhe nuk ka punë", shkruan Basha si kundërpërgjigje ndaj thënies së famshme të Ramës "Punë ka, por duhen profesionistë". Në videon e publikuar, kreu i PD tregon edhe njëherë personat me ndihmë ekonomike, të përjashtuarit dhe vendet e lira të punës. Në total janë 28 mijë e 836 të përjashtuar nga ndihma ekonomike dhe veç 454 vende të lira pune. Prej shumë javësh z.Basha akuzon ashpër kryeministrin Edi Rama, duke u shprehur se qytetarët janë hequr në mënyrë kriminale nga lista e ndihmës ekonomike, falë skemës së "Holokaustit të qeverisë Rama". "Është një dramë njerëzore, por edhe emergjencë kombëtare. Vendi i vetëm në Evropë që ka futur në karantinë urie, ka çuar në emigrim një përqindje të madhe të bashkëqytetarëve. Kemi një qeveri dhe kryeministër që përdor një metodë naziste, gjenocidale spastrimi ndaj popullit të vet", ka deklaruar z.Basha. Sipas tij një pjesë e madhe e qytetarëve i janë drejtuar opozitës dhe "ajo që kemi parë është një fraksion nga tmerrri që po përjeton populli". Basha ka theksuar se ndodhimi në një situatë urgjente, ku janë në rrezik mijëra jetë njerëzore dhe me shumë gjasa kjo do të prodhojë "një tjetër valë refugjatësh që do terrorizojnë Europën". Kreu i PD-së ka garantuar në mënyrë të vazhdueshme se opozita do të ndërmarret të gjithë hap-



Kreu i opozitës Lulzim Basha

SHQIPËRIA E VËRTETË

- 50 655 - me ndihmë ekonomike
- 28 836 - të përjashtuar
- 454 - vende të lira pune

20836

FAMILJE
Sipas kreut të opozitës Lulzim Basha, janë 20836 familje të përjashtuara nga skema e ndihmës ekonomike ndërsa sipas tij në gjithë Shqipërinë aktualisht ka vetëm 454 vende të lira pune.

FMN 'kritika' qeverisë për koncesionet

Vasili: Qeveria është bërë bisht i oligarkëve

Kreu i LSI Petrit Vasili kërkoi dje se qeveria bëhet njësh me oligarkët dhe del kundër FMN. Sipas tij FMN është shumë e qartë kur thotë të ndalen koncesionet. Por, tha Vasili, qeveria e shndërruar në bisht të oligarkëve, nuk i ndalon koncesionet edhe kur ia thotë prerë FMN. "FMN është përsëri e qartë në lidhje me përfshirjen në TVSH të bizneseve me xhiro mbi 2 milionë lekë, FMN këshilloi se "administrata do të shpërqendrohet, në vend të fokusohet te ndërmarjet e mëdha dhe ka rrezik të ulen të ardhurat, ndaj nuk ishim dakord që në fillim", shkruan Vasili.



në fillim". Qeveria e bërë njësh me oligarkët me te cilët ka bërë gati koncesionin për mbledhjen e TVSH as që pvet as për FMN dhe as për mijëra biznese që mby-



KËSHILLA

"FMN këshilloi se "administrata do të shpërqendrohet, në vend të fokusohet te ndërmarjet e mëdha dhe ka rrezik të ulen të ardhurat, ndaj nuk ishim dakord që në fillim", shkruan Vasili.

llen e mijëra njerëz, që mbeten pa bukë. Oligarkët dhe qeveria trashen dhe vegjëlja thahet. Shqiptarët janë pa drejtim", shprehet z. Vasili.

Permbaresi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shitje ne ankap pasurine :

* "Pentore+Truall+Ndertese me sip totale 620m2, nga e cila 200 m2eshte truall dhe 90 m2 eshte ndertese , me Numer pasurine 430/17, e ndodhur ne Zonen Kadrasale 1100, e regjistruar ne regjistrin hipotekore volumni 6, faqe 227.me adrese ne Fshatin Barbulustj Shkoder
2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankap për pasurinë e sipërpërkuruar, është në vlerën 1,568,000 (njemilione e pesëqind e gjashtëdhjetete mije) Lekë .

Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me date 26.03.2018 ora 16.16 ne Zyren e permbaresit gjyqësor Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko . Përballe Gjykares se rrethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhen perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

PD, Spahia: Skandal në shëndetësi, mungojnë epruvetat për analizat

Deputeti demokrat i Shkodrës Bardh Spahia, denoncoi faktin e privatizimit të bërë nga qeveria aktuale, të laboratorëve të analizave mjekësore si një dështim të madh. "Mjekët të shqetësuar për jetën e pacientëve ankohen për situatën e dëshpëruar në të cilën janë të detyruar t'u shërbejnë këtyre pacientëve. Në laboratorët e QSU-t mungojnë prej ditësh epruvetat për analiza. Nuk bëhet fjalë për ndonjë qendër shëndetësore të vogël në ndonjë fshat të vendit, por për laboratorin me të madh ku çdo ditë përplasen qindra të sëmurë në nevojë. Dhe kjo ndodh ndërkohe që ka hyrë në zbatim dhënia me koncesion e laboratorëve ku nga 18 që duhej të funksiononin janë hapur vetëm 3. Në një kohë kur nga 1 milion euro në vit, që paguante shteti për sistemin e laboratorëve, sot i detyrohet privatit 8 milionë euro. Të nderuar miq, në shëndetësinë e rilindur ministrat ndërrohen, vetëm vjedhja dhe papërgjegjshmëria nuk ndryshon", shprehet z.Spahia.



PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ

*Permbaresi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvillon ankandin e trete per shitjen e pasurive te paluajtshme :

1. Apartament me Nr. pasurie 118/57+2-10, ZK 3292, vol 38, faqe 184, me siperfaqe 94.5 m², te ndodhur ne Selite, Tirane;
2. Apartament me Nr. pasurie 118/57+2-11, ZK 3292, vol 38, faqe 185, me siperfaqe 99 m², te ndodhur ne Selite, Tirane,

per shlyerjen e detyrimit ne favor te kreditorit Shoqerise "EDIL-AL-IT" Sh.p.k., ne shumari 67'327(gjeshitedjete e shtate mije e nenteqind e njetze e shtate)Euro dhe 309'226(treqind e nente mije e dyqind njetze e pese) Lekë.

Çmimet me të cilat fillon ankandi i trete jane ne vlerat :

1. Apartament me nr. pasurie 118/57+2-10, ZK 3292,vol 38, faqe 184, me siperfaqe 94.5 m², te ndodhur ne Selite, Tirane, ne shumen 40'484(dyzete mije e katerqind e tetdhjete e kater)Euro;
2. Apartament me nr pasurie 118/57+2-11, ZK 3292,vol 38, faqe 185, me siperfaqe 99 m², te ndodhur ne Selite, Tirane, ne shumen 41'983(dyzete e nje mije e nenteqind e tetdhjete e tre)Euro;

Ankandi i trete zhvillohet ne date 03.04.2018, ora 16.00 ne zyren e permbaresit gjyqësor privat Ermir Godaj, Rruga "Abdi Toptani", Qendra Torre Drin, kt.2, nr.33, Tirane, dhe per informacion mund te kontaktoni ne nr.0682099471, 0695370060, email ermirgodaj@zyrapermbarimit.com."



Valentina Madani

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve publikoi dje raportin financiar të Partisë Demokratike për vitin 2017, ndërsa sipas deklarimeve rezultojnë se ky subjekt politik në një vit, përfshirë fushatën zgjedhore, ka shpenzuar 158.8 milionë lekë. Në këtë shumë Partia Demokratike llogarit 31.2 milionë lekë si shpenzime për shërbime dhe konsulencë, ku përfshihen edhe kontratat e shumë deputatëve të lobimit në Shtetet e Bashkuara. Në raportin vjetor financiar, Partia Demokratike raporton se të ardhura për vitin 2017 ka pasur 132.2 milionë lekë, ku pjesën më të madhe e zënë të ardhurat nga buxheti i shtetit me 108 milionë lekë, ndërsa pjesa tjetër janë donacione në vlerën 22 milionë lekë dhe tarifa anëtarësie. Konkretisht, në total sipas deklarimeve nga PD, e drejtuar prej Lulzism Bashës, në një vit aktiv për shkak edhe të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e 25 qershorit, ky subjekt politik ka shpenzuar 158.8 milionë lekë. Ky raport vjen në një kohë kur PD-ja është përfshirë nga akuzat e mazhorancës për financim nga biznesmenë rusë, nisur nga investigimi i revistës amerikane "Mother Jones". Kryeministri Edi Rama e quajti çështjen e financimit të PD "sallatë ruse" dhe hodhi dyshime për destabilizim të financuar nga Rusia në Shqipëri, ndërsa Bashës i kërkoi të shkonte në prokurori. E ndërsa Rama i kërkonte kryedemokratit të shkonte në prokurori dhe të jepte shpjegime, Basha është shprehur se kryeministri duhet të presë me qetësi hetimin nga prokuroria dhe FBI, pasi PD i ka bërë transparente të gjitha aspektet financiare në përputhje me ligjin. "Mjegulla dhe sulmet ndaj opozitës, që ka bërë transparente të plotë sipas ligjit nuk do të na mbyllin gojën për të çliruar ekonominë nga monopoli, krimi dhe drogë. PD i ka bërë të qarta si drita e diellit të gjitha aspektet financiare dhe zgjedhore të saj dhe gjithçka ka dalë në përputhje me ligjin. As ulërimat e Ramës dhe dëshpërimi i Ballës nuk mund ta heqin vëmendjen nga kokaina në Maminas dhe lirimimi i Tahirrit. Fokusi ynë është në lufta kundër krimi. Rama të presë verifikimin nga prokuroria. Dje na doli një lajm që po e verifikon edhe FBI, të presim rezultatin", - deklaroi kreu i PD-së. Basha e quan qesharake akuzën në fjalë, gatim të Ramës dhe qëndrimeve të tij anti-Trump dhe anti-administratës "Trump". Z.Basha akuzoi publikisht Ramën për lidhje të errëta me kompaninë ruse "Gunvor", ndërsa sipas tij, ai nuk u

Demokratët në një vit, përfshirë fushatën zgjedhore, kanë shpenzuar 158.8 milionë lekë

Lobimi, KQZ zbarch financa e PD-së për shpenzimet dhe konsulentat

31,2 milionë lekë, ku përfshihen edhe kontratat

Faksimile të raportit vjetor financiar të PD-së

Borchardt takon Markun: Ndjekje penale për krimet zgjedhore

Ndjekja penale e korrupsionit, krimeve zgjedhore dhe trafikimit të personave ishin në qendër të takimit që ambasadori Bernd Borchardt pati sot me Prokuroren e Përgjithshme, Arta Marku. Ambasadori OSBE në Tiranë, Bernd Borchardt ka zhvilluar sot një takim me Prokuroren e Përgjithshme, Arta Marku, ku në fokus të bisedimeve ka qenë lufta kundër korrupsionit. Njëpërjetje një postimi në statusin e tij "Twitter", ambasadori OSBE, Bernd Borchardt tha: "OSBE është e gatshme të fuqizojë prokurorinë në të gjitha këto fusha".



FINANCAT

KQZ publikoi raportin financiar të Partisë Demokratike për vitin 2017, ndërsa sipas deklarimeve rezultojnë se ky subjekt politik në një vit, përfshirë fushatën zgjedhore, ka shpenzuar 158.8 milionë lekë.



SHPENZIMET

Në këtë shumë Partia Demokratike llogarit 31.2 milionë lekë si shpenzime për shërbime dhe konsulencë, ku përfshihen edhe kontratat e shumëdebatuara të lobimit në Shtetet e Bashkuara.



RAPORTI

PD raporton se të ardhura për 2017-ën ka pasur 132.2 milionë lekë, ku pjesën më të madhe e zënë të ardhurat nga buxheti i shtetit me 108 milionë lekë, ndërsa pjesa tjetër janë donacione, 22 milionë lekë.

AKUZAT

Basha e quan qesharake akuzën në fjalë, gatim të Ramës dhe qëndrimeve të tij anti-Trump dhe anti-administratës "Trump". Z.Basha akuzoi publikisht Ramën për lidhje të errëta me kompaninë ruse "Gunvor", ndërsa sipas tij, ai nuk u përgjigj, duke gatuar një tjetër "sallatë ruse", si ajo e "Mother Jones", për të fshehur të vërtetat.

Felaj: Garda në veting, të mos përsëritet kurrë 21 janari

Vetingu



Kryetarja e Komisionit të Sigurisë, Ermonela Felaj

Kryetarja e Komisionit të Sigurisë, Ermonela Felaj, gjatë një vizite tek Garda e Republikës tha se ky institucion do të kalojë në veting, si e gjithë Policia e Shtetit. Felaj u shpreh se ky proces do ta depolitizojë institucionin, ndërsa përmendi edhe të kaluarën, ku theksoi se nuk duhet të përsëritet kurrë ngjarje si ajo e vrasjes së 4 protestuesve më 21 janar 2011.

flagrant që unë i referohem është ai i 21 janarit, ku Garda u keqpërdor dhe u keqpërdor në mënyrën më të ulët të mundshme, sepse u vranë

kalimin në sitë të afro 13 mijë efektiveve, ku një pjesë prej tyre i përket trupës së Gardës së Republikës.

Efektivat e Gardës së Republikës do të kalojnë në veting si e gjithë trupa e Policisë së Shtetit. Kryetarja e Komisionit të Sigurisë, Ermonela Felaj, gjatë një vizite dje në ambientet e Gardës, e shoqëruar edhe nga anëtarët e tjerë të këtij komisioni tha se vetingu do të ndihmojë vëç të tjerash edhe depolitizimin e institucionit. "Instrumenti më i ri ligjor që po ofrojmë së fundi, ai i vetingut edhe në radhët e Gardës së bashku me Policinë e Shtetit, do të shërbejë që pjesë e Gardës të jenë njerëz që kanë integritet të lartë profesional dhe moral", tha deputetja e PS. Më tej, Felaj përmendi edhe vrasjet e 21 janarit të vitit 2011, duke apeluar që episode të tilla të mos përsëriten në të ardhmen. "Duhet të jetë sa më e depolitizuar. Shembulli më

përgjigj, duke gatuar një tjetër "sallatë ruse", si ajo e "Mother Jones", për të fshehur të vërtetat. "Nëse ka rrezik rus në Shqipëri, ai vjen përmes Ramës kryeministër! Jo vetëm sepse si njeri i zhytur në krim ai është lehtësisht i shantazhueshëm nga kushdo, por sepse ai konkretisht ka mirëpritur ndikimin rus! Edi Rama duhet të sqarojë publikisht

se kush ia solli, çfarë ka biseduar dhe çfarë ka premtuar kompanisë "Gunvor", me të cilën është takuar të paktën një herë në zyrën e tij në Tiranë. Ai duhet të sqarojë gjithashtu se pse mbështet tezën e përkrahur edhe nga Rusia për shkëmbim territori midis Shqipërisë dhe Serbisë. Rama duhet të sqarojë gjithashtu aferën me kompaninë turke, që do të

ndërtotë aeroportin e Vlorës, kompani e cila ka kontratë me kompani sh-

tetërore ruse për ndërtim centralesh bërthamore", theksoi z.Basha.

NJOFTIM
Studio Përmbarimore Zyber SHEHU zhvillon ankandin e II(Dytë) për pasurinë:
a. Pasuria Nr.2/32+1-8/1, vol 6, faqe 183, Z.K.8514, e apartament, me sipërfaqe totale 70,13m2, e ndodhur në Durrës, çmimi 27.490,4 Euro.
Ankandi zhvillohet në datë 26.03.2018 në ambientet e Studios Përmbarimore Zyber SHEHU me adresë: Pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Lushnjë, Cel.0682089539, osë adresën e-mail: shehzyber@yahoo.com

SKANDALI ME PRONAT DOSJA

Zbardhet dosja e plotë e prokurorisë, ja personat e përfshirë në këtë aferë

Skandali i pronave në Lezhë, ja si u tjetërsuan dhjetëra ha tokë të shtetit

Dokumentet e 9 përfituesve u firmosën nga kryetari i Bashkisë Lezhë

Ina Allkanjari

LEZHË

Zbardhet skandali i pronave në bregdetin e Lezhës. "Gazeta Shqiptare" ka mundur të sigurojë dosjen e plotë në lidhje me tjetërsimin e pronësive së tokave në zonën "Rana e Hedhun" në Shëngjin. Në këtë dosje jepet në mënyrë të detajuar sesi shtetasit Zef Ndue Gjini, Ndue Frrok Frroku, Frrok Mark Frroku, Gjin Frrok Frroku, Martin Ndue Frroku, Nikoll Gjergj Tinaj, Vasi Fran Gjoni, Pjetër Fran Gjoni dhe Renato Zef Malotaj përfituan padrejtësisht tokë në Malin e Shëngjinit dhe Malin e Rencit. Në dosjen e prokurorisë thuhet se nga veprimet hetimore të kryera personat e sipërpërmendur kanë tjetërsuar pronën e shtetit duke e kaluar në emër të tyre.

PËRFITUESI ZEF NDUE GJINI

Toka me sipërfaqen 13730 m², në fshatin Mali Shëngjin, Lezhë, e regjistruar në pronësi të familjes Zef Ndue Gjini, (në tabelën e dokumentit lista e familjeve që morën tokë në pronësi), në katër dokumentet e vërtetimit, objektet e ekspertimit për këtë pronë janë lëshuar nga 1 njëjti person. Akti i marrjes së tokës në pronësi të familjes Gjini, me nr. regjistrimi të aktit 5594, rezultoi në datën 06.09.2003. Vërtetimi për pronësinë është lëshuar më datë 27.06.2004.

Katër dokumentet e titulluara 'Konfirmim' për pajisjen me tokë të shtetasit Zef Ndue Gjini të lëshuara më datë 27.06.2004 (2 copë) dhe 13.11.2005 (2 copë), nga komuna Shëngjin. Katër dokumentet e titulluara 'Vërtetim', për marrjen në pronësi të parcelave nga familja e shtetasit e Zef Ndue Gjini, të lëshuara më datë 27.06.2004 (dy copë) dhe 13.11.2005 (dy copë), nga komuna Shëngjin objekte ekspertimi, mu mund të konkludohet. Sipas aktit të ekspertimit nr.1534 më datë 06.02.2018, është arritur në konkluzionin se tek shkresa me nr. 295 prot, datë 10.08.2015, me lëndë 'Dokument toke' drejtuar Z.V.Rr.P.P. Lezhë nga komuna Shëngjin, objekt ekspertimi, nënshkrimet (firma) në emër të shtetasit Salvador Kaçaj, ndodhur tek rubrika me përmbajtje 'Kryetari-Salvador Kaçaj', nuk është nënshkrimi i shtetasit Kaçaj, krahasuar me modelet respektive të paraqitura. Nënshkrimi në emër të Kaçaj, është firma e shtetasit Eduart Leka, krahasuar me modelet respektive të paraqitura. Shenja e vulës së njomë rrethore me përmbajtje teksti "Republika e Shqipërisë-Komuna Shëngjin", e ndodhur tek rubrika me përmbajtje 'Kryetari-Salvador Kaçaj', në dokumentin e sipërcituar objekt ekspertimi dhe shenjat e vulës së njomë rrethore me të njëjtën përmbajtje teksti, të komunës Shëngjin, modele krahasimi, janë formuar nga e njëjta klishe vule. Gjatë hetimeve është kryer edhe ekspertimi topografik, ku sipas aktit të ekspertimit topografik datë 16.02.2018 është arritur në përfundimin se pasuritë me nr.964/6, 969/2 shtrihen në ngastrën pjore me nr. 50, e cila ka qenë dhe është pyll prodhues. "Pishë Mesdhetare", që vazhdon në formën e qeverisjes 'Pyll', por në ngastrë pjore, përfshihet edhe brezi i rërës. Kësh-



Kryetari i Bashkisë së Lezhës, Fran Frrokaj

tu pasuria nr. 969/2 ndodhet e tëra mbi brezin ranor, ndërsa pasuria nr. 964/6 në pjesën më të madhe të saj është 'Pyll Prodhuës', edhe në pjesën në drejtim të detit, është ranore, brezi i plazhit.

PËRFITUESI NDUE FRROK FRROKU

Pasuritë me nr. 558/2, 551/2 dhe 552/A (e pa regjistruar në Z.V.Rr.P.P. Lezhë, shtrihen në ngastrën pjore me nr.62, e cila përbëhet nga një pyll prodhues, një pjesë pyll mbrojtës. Sipërfaqet e pasurive me nr. 558/2, 551/2 dhe 552/A, shtrihen në brezin ranor të plazhit tek vendi i quajtur "Rëra e Hedhun", sipërfaqe kjo e cilësuar që prej vitit 1985 e deri më sot. Gjatë hetimeve ka rezultuar se sipas shkresës nr.7421 prot, datë

paraqitur prej saj për rastin konkret, pasi gjatë procesit të shqyrtimit të dokumentacionit për regjistrimin është evidentuar se AMTP me nr.9275, datë 16.06.2002, në emër të Ndue Frrokut nuk është administruar më parë nga kjo zyrë. Po ashtu nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se pasuria me nr. 938/4-D, është pasuri e llojit 'pyll', pasuria nr.552/2 është tokë ranishte dhe pasuria nr.951/1 është tokë arë me pronar 'shtet'. Në përgjigje të kërkesës për konfirmim të Z.V.Rr.P.P. Lezhë, nga bashkia Lezhë, me shkresë nr. 7421/2 prot, datë 21.08.2017, e nënshkruar dhe vulosur nga kryetari i bashkisë Fran Frrokaj, është konfirmuar së lloji i pasurisë nr. 938/4 dhe 552/2, është tokë arë. Po ashtu bashkëlidhur kësaj shkrese, Z.V.Rr.P.P. Lezhë i është dërguar kopje e vendimit me nr.2/1, datë 27.05.2002, i firmosur dhe nënshkruar nga kryetari i komisionit të tokës, në qarkun Lezhë, Luigj Isufi, ku sipas së cilës, konfirmohet pajisja me tokë e familjeve të fshatit Ishull/Shëngjin në fshatin Mali i Rencit. Më tej në këtë informacion evidentohet se norma për frymë në fshatin Mali i Rencit dhe fshatin Ishull Shëngjin, është 3300 m², pasi kjo tokë nuk ka sistem vadije dhe kjo familje është trajtuar me tokë nga komisioni i tokës, në zbatim të VK.M. nr. 255, datë 02.08.1991, pika 5, duke konvertuar tokën nën ujë dhe mbi ujë, me koeficientin ngal në 1.5, deri në 2 dyqym për frymë. Lidhur me kërkesën e shtetasit Ndue Frroku, Për regjistrimin e pasurisë mbi bazën e dokumentacionit të ardhur nga Bashkia Lezhë, me shkresën nr. 6894/2 prot, datë 18.08.2017 i është drejtuar me kërkesë për konfirmim Këshillit të Qarkut Lezhë. Në këtë shkresë evidentohet se pas verifikimeve të dokumentacionit dhe kartelës përkatëse të pasurisë në ZVRP Lezhë, kjo pasuri është e regjistruar 'pyll'. Në këto rrethana ZVRPP Lezhë, i ka kërkuar Këshillit të Qarkut Lezhë, të konfirmojë gjendjen juridike të datës 01.08.1991, të llojit të pasurisë n. 938/4, të zonës kadastrale nr. 2568, të zonës kadastrale nr. 2569. Këshilli i Qarkut Lezhë, me shkresë nr. 871/1 prt, datë 21.08.2017, të nënshkruar dhe vulosur nga kryetari Gjok Ndoka, i ka kthyer përgjigje Z.V.Rr.P.P. Lezhë, ku ndër të tjera ka evidentuar se parcela nr. 938/4, fshati Mali i Rencit, është me zërin kadastral 'tokë pemtore'. Ndërsa për pasurinë nr. 552/2 nuk ka kthyer përgjigje. Kjo shkresë është protokolluar me nr. 7007 prot, datë 22.08.2017. Pasuria me nr. 938/4-B, e regjistruar në volumn 6 faqe 151, ZK 2568, nga pasuria 'Shtet', është regjistruar në emër të shtetasit Ndue Frrok Frroku, me një sipërfaqe prej 17601 m², me llojin e pasurisë 'arë'. Nga verifikimi i praktikës dhe konkretisht të shkresës së dërguar nga bashkia Lezhë për konfirmim të zërit kadastral, rezultoi se në shkresën e mbajtur nga bashkia Lezhë është e shënjuar si konceptuese e kësaj shkrese shtetasja Juxhina Mema, si dhe nënshkruar e vulosur nga kryetari Fran Frrokaj. Pas administrimit



Plazhi i Shëngjinit

të shkresave për konfirmimin e zërit kadastral të dërguara nga bashkia Lezhë dhe Këshilli i Qarkut Lezhë, nga ana e ZVRPP Lezhë, me urdhër të regjistruarit Artan Djala, është miratuar urdhri për ndarjen e pasurisë nr. 938/21, dhe më pas është nxjerrë urdhri për korrigjimin e pasurisë nr. 938/23 nga 'pyll' në 'arë' në emër të shtetasit Ndue Frrok Frroku. Pastaj është nxjerrë urdhri për regjistrimin e pasurisë 938/23 në emër të shtetasit Ndue Frrok Frroku. Gjithashtu, është nxjerrë dhe një urdhër për regjistrimin e pasurisë nr. 959/1 në emër të shtetasit Frroku. Këta urdhra janë nxjerrë nga regjistruari Artan Djala dhe nënshkruar nga ana e tij. Kërkesa për regjistrim nga shtetasit Ndue Frroku është pranuar nga juristi Ermendo Jakaj, hartografi Enkelejd Zefi si dhe në fund janë hedhur në kartelën e pasurisë. Më pas nga shtetasi Ndue Frroku janë kryer veprime juridike të ndryshme për kalimin e pronësive së pasurive të të mësipërme shpëtasve të tjerë.

PËRFITUESI FRROK MARK FRROKU

Gjatë hetimeve ka rezultuar se sipas shkresës nr. 7418 prot, datë 16.06.2017 Bashkia Lezhë ka dërguar për regjistrim dokumentacionin për regjistrimin e pasurisë në emër të shtetasit Frrok Frroku, e cila është regjistruar me nr. 6895 prot, datë 16.08.2017 në ZVRPPLezhë. Më datë 17.08.2017 shtetasi Frrok Frroku, ka aplikuar për regjistrimin e pasurisë nr. 938/4-B. Në vijim të kësaj praktike regjistrimi, nga ana e VRRP Lezhë, me shkresën nr. 6895/1 prot, datë 18.08.2017, i është kërkuar bashkisë Lezhë konfirmim i dokumentacionit të paraqitur prej tij si dhe i zërit kadastral për këto pasuri, pasi gjatë procesit të shqyrtimit të dokumentacionit për regjistrim është evidentuar se AMTP me nr.9272, datë 16.05.2002, në emër të Frrok Frroku, nuk është administruar më parë nga kjo zyrë. Po ashtu nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se pasuria me nr. 938/4-B, është pasuri e llojit 'pyll' me pronar 'shtet'. Në përgjigje të kërkesës për konfirmim të ZVRPP Lezhë, nga Bashkia Lezhë, me shkresë nr. 7418/2, datë 21.08.2017, e nënshkruar dhe vulosur nga kryetari Fran Frrokaj, është konfirmuar se lloji i pasurisë nr. 938/4-B është tokë 'arë+pemtore'. Po ashtu bashkëlidhur kësaj shkrese, ZVRPP Lezhë i është dërguar nga ana e Bashkisë Lezhë dhe një kopje e vendimit nr. 2/1, datë 27.05.2002, i firmosur dhe nënshkruar nga kryetari i komisionit të tokës, në qarkun Lezhë, Luigj Isufi, ku sipas së cilës konfirmohet pajisja me tokë e familjeve të fshatit ishull Shëngjin, në fshatin Mali i Rencit. Lidhur me kërkesën e shtetasit Frrok Frroku, për regjistrimin e pasurisë mbi bazën e dokumentacionit të ardhur nga Bashkia Lezhë, ZVRPP Lezhë, me shkresë nr. 6895/2 prot, datë 18.08.2017 i

SALVADOR KAÇAJ

Më datë 10.08.2015, me lëndë 'Dokument toke' drejtuar Z.V.Rr.P.P. Lezhë nga komuna Shëngjin, objekt ekspertimi, nënshkrimet (firma) në emër të shtetasit Salvador Kaçaj, ndodhur tek rubrika me përmbajtje "Kryetari-Salvador Kaçaj", nuk është nënshkrimi i shtetasit Kaçaj, krahasuar me modelet respektive të paraqitura.

16.08.2017, bashkia Lezhë ka dërguar në Z.V.Rr.P.P. Lezhë edhe praktikën e regjistrimit të pasurive në emër të shtetasit Ndue Frrok Frroku. Praktikë e cila në Z.V.Rr.P.P. Lezhë është regjistruar me nr. 6894, datë 16.08.2017. Më datë 17.08.2017, shtetasi Ndue Frrok Frroku, ka aplikuar për regjistrimin e pasurive me nr. 938/4/A, 552/2 dhe 959/1. Në vijim të kësaj praktike regjistrimi, nga ana e Z.V.Rr.P.P. Lezhë, me shkresë nr. 6894/1 prot, datë 18.08.2017, i është kërkuar bashkisë Lezhë konfirmim i dokumentacionit të

938/23, e regjistruar në volumn 6 faqe 151, ZK 2568, nga pasuria 'Shtet', është regjistruar në emër të shtetasit Ndue Frrok Frroku, me një sipërfaqe prej 17601 m², me llojin e pasurisë 'arë'. Nga verifikimi i praktikës dhe konkretisht të shkresës së dërguar nga bashkia Lezhë për konfirmim të zërit kadastral, rezultoi se në shkresën e mbajtur nga bashkia Lezhë është e shënjuar si konceptuese e kësaj shkrese shtetasja Juxhina Mema, si dhe nënshkruar e vulosur nga kryetari Fran Frrokaj. Pas administrimit



← është drejtuar me kërkesë për konfirmim këshillit të qarkut Lezhë. Në këtë shkresë evidentohet se pas verifikimeve të dokumentacionit dhe kartelës përkatëse të pasurisë në ZVRPP Lezhë, kjo pasuri është e regjistruar 'pyll'. Pas verifikimeve është evidentuar se parcela 938/4-B fshati Mali i Rencit, është me zërin kadastral tokë pemtore. Shkresa përcjellëse e këtyre dokumenteve në Bashkinë Lezhë është konceptuar dhe nënshkruar nga Juxhina Mema si dhe nënshkruar e vulosur nga kryetari Fran Frokaj. Nga Z.V.Rr.PP Lezhë, me urdhër të regjistruarit Artan Djala është miratuar urdhri për ndarjen e pasurisë 938/4-B, më pas është nxjerrë urdhri për korrigjimin e pasurisë nr 938/4-B në 'arë' në emër të shtetasit Frok Mark Frokaj, pastaj është nxjerrë urdhri për regjistrimin e pasurisë 938/4-B në emër të shtetasit Frok Mark Frokaj. Kërkesa për regjistrimin nga shtetasi Frok Frokaj është pranuar nga regjistruarit Artan Djala, juristi Ermando Jakaj dhe hartografi Enkelejd Zefi si dhe në fund janë hedhur në kartelën e pasurisë ku është pasqyruar si pasuria nr 938/16. Vol 16 faqe 143, ZK 2568 nga pronar shtet të shtetasit Frok Mark Frokaj. Më pas nga shtetasi Frok Frokaj janë kryer veprime juridike të ndryshme për kalimin e pronësisë të pasurisë së mësipërme shtetasve të tjerë.

PËRFITUESI GJIN FRROK FRROKU
Gjatë hetimeve ka rezultuar se në datë 16.08.2017, Bashkia Lezhë ka dërguar dokumentacionin për regjistrimin e pasurisë në emër të shtetasit Gjin Frok Frokaj, e cila është protokolluar me nr 6898 datë 18.08.2017 në ZVRPP Lezhë. Më datë 16.08.2017 shtetasi Gjin Frokaj, ka aplikuar për regjistrimin e pasurisë nr 938/4-C. Më datë 18.08.2017 ZVRPP Lezhë, i ka kërkuar Bashkisë Lezhë konfirmim të dokumentacionit të paraqitur prej bashkisë pasi gjatë procesit të shqyrtimit të dokumentacionit për regjistrimin, është evidentuar se AMTP me nr 9267 datë 16.05.2002, në emër të Gjin Frokaj, nuk është administruar më parë nga kjo zyrë. Po ashtu nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se pasuria me nr 938/4-C, është pasuri e llojit 'pyll', me pronar 'shtet'. Nga Bashkia Lezhë më datë 21.08.2017 e nënshkruar dhe vulosur nga kryetari Fran Frokaj është konfirmuar se lloji i pasurisë nr 938/4-C, është tokë 'arë'+pemtore'. Po ashtu bashkëlidhur kësaj kërkesë, ZVRPP Lezhë i është dërguar kopje e vendimit me nr 2/1 datë 27.05.2002, i firmosur dhe nënshkruar nga kryetari i



komisionit të tokës, në qarkun Lezhë, Luigj Isufi, ku sipas së cilës konfirmohet pajisja me tokë e familjeve të fshatit ishull/Shëngjin, në fshatin Mali i Rencit. Më tej pas verifikimeve të dokumentacionit dhe kartelës përkatëse të pasurisë në ZVRPP Lezhë, kjo pasuri është regjistruar 'pyll'. ZVRPP Lezhë me urdhër të regjistruarit Artan Djala ka miratuar urdhin për ndarjen e pasurisë 938/4-C më pas është nxjerrë urdhri për korrigjimin e kësaj pasurie në emër të shtetasit Gjin Frokaj. Dhe më pas është nxjerrë urdhri për regjistrimin e kësaj pasurie në emër të shtetasit Gjin Frokaj. Në kartelën e pasurisë me nr 938/16, faqe 147, ZK 2568 është pasqyruar nga pronar shtet tek shtetasi Gjin Frokaj Frokaj, kalimi është bërë më datë 23.08.2017.

PËRFITUESI MARTIN NDUE FRROKU

Gjatë hetimeve ka rezultuar se më datë 16.08.2017 Bashkia Lezhë ka dërguar dokumentacionin për regjistrimin e pasurisë në emër të shtetasit Martin Ndue Frokaj. Më datë 18.08.2017 ZVRPP Lezhë, i ka kërkuar Bashkisë Lezhë konfirmim të dokumentacionit të paraqitur prej bashkisë pasi gjatë procesit të shqyrtimit të dokumentacionit për regjistrimin është evidentuar se AMTP me nr 9274 datë 16.05.2002, në emër të Martin Frokaj, nuk është administruar më parë nga kjo zyrë. Po ashtu nga shqyrtimi i do-

FIRMA E KRYEBASHKIAKUT

Nga shqyrtimi i dokumentacioni ka rezultuar se pasuria me nr 938/4-C, është pasuri e llojit 'pyll', me pronar 'shtet'. Nga Bashkia Lezhë më datë 21.08.2017 e nënshkruar dhe vulosur nga kryetari Fran Frokaj është konfirmuar se lloji i pasurisë nr 938/4-C, është tokë 'arë'+pemtore'.

kumentacioni ka rezultuar se pasuria me nr 938/4-D, është pasuri e llojit 'pyll', me pronar 'shtet'. Nga Bashkia Lezhë më datë 21.08.2017 e nënshkruar dhe vulosur nga kryetari Fran Frokaj është konfirmuar se lloji i pasurisë nr 938/4-D, është tokë 'pemtore'. Po ashtu bashkëlidhur kësaj kërkesë, ZVRPP Lezhë i është dërguar kopje e vendimit me nr 2/1 datë 27.05.2002, i firmosur dhe nënshkruar nga kryetari i komisionit të tokës, në qarkun Lezhë, Luigj Isufi, ku sipas së cilës konfirmohet pajisja me tokë e familjeve të fshatit ishull/Shëngjin, në fshatin Mali i Rencit. Më tej pas verifikimeve të dokumentacionit dhe kartelës përkatëse të pasurisë në ZVRPP Lezhë, kjo pasuri është regjistruar 'pyll'. Këshilli i Lartë i Lezhës me shkresë me datë 21.08.2017 të nënshkruar dhe vulosur nga kryetari i Këshillit të qarkut Lezhë, Gjak Ndoka, ka evidentuar se parcela me nr 938/4-D fshati mali i Rencit, është me zërin kadastral "tokë pemtore". Z.V.Rr.PP Lezhë me urdhër të regjistruarit Artan Djala ka miratuar urdhin për ndarjen e pasurisë 938/4-D më pas është nxjerrë urdhri për korrigjimin e kësaj pasurie në emër të shtetasit Gjin Frokaj. Dhe më pas është nxjerrë urdhri për regjistrimin e kësaj pasurie në emër të shtetasit Martin Frokaj. Në kartelën e pasurisë me nr 938/22, Vol 6 Faqe 148, ZK 2568 është pasqyruar nga pronar shtet tek shtetasi Martin Frokaj Frokaj, kalimi është

bërë më datë 23.08.2017. PËRFITUESI NIKOLL GJERGJ TINAJ

Gjatë hetimeve ka rezultuar se më datë 16.08.2017 Bashkia Lezhë ka dërguar dokumentacionin për regjistrimin e pasurisë në emër të shtetasit Nikoll Gjergj Tinaj. Më datë 18.08.2017 ZVRPP Lezhë, i ka kërkuar Bashkisë Lezhë konfirmim të dokumentacionit të paraqitur prej bashkisë pasi gjatë procesit të shqyrtimit të dokumentacionit për regjistrimin është evidentuar se AMTP me nr 9265 datë 22.04.2002, në emër të Nikoll Tinaj, nuk është administruar më parë nga kjo zyrë. Po ashtu nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se pasuria me nr 938/4-A, është pasuri e llojit 'pyll', me pronar 'shtet'. Nga Bashkia Lezhë më datë 21.08.2017 e nënshkruar dhe vulosur nga kryetari Fran Frokaj është konfirmuar se lloji i pasurisë nr 938/4-A, është tokë 'pemtore'. Po ashtu bashkëlidhur kësaj kërkesë, ZVRPP Lezhë i është dërguar kopje e vendimit me nr 2/1 datë 27.05.2002, i firmosur dhe nënshkruar nga kryetari i komisionit të tokës, në qarkun Lezhë, Luigj Isufi, ku sipas së cilës konfirmohet pajisja me tokë e familjeve të fshatit ishull/Shëngjin, në fshatin Mali i Rencit. Më tej pas verifikimeve të dokumentacionit dhe kartelës përkatëse të pasurisë në ZVRPP Lezhë, kjo pasuri është regjistruar 'pyll'. Këshilli i Lartë i Lezhës me shkresë me datë 21.08.2017 të nënshkruar dhe vulosur nga kryetari i Këshillit të qarkut Lezhë Gjak Ndoka, ka evidentuar se parcela me nr 938/4-D fshati mali i Rencit, është me zërin kadastral tokë pemtore. ZVRPP Lezhë me urdhër të regjistruarit Artan Djala ka miratuar urdhin për ndarjen e pasurisë 938/4-A më pas është nxjerrë urdhri për korrigjimin e kësaj pasurie në emër të shtetasit Nikoll Tinaj. Dhe më pas është nxjerrë urdhri për regjistrimin e kësaj pasurie në emër të shtetasit Nikoll Tinaj. Kërkesa për regjistrimin e kësaj pasurie është bërë nga shtetasi Nikoll Tinaj dhe pranuar nga juristi ZVRPP Lezhë, Ermando Jakaj. Më pas nga shtetasi Nikoll Tinaj janë kryer veprime juridike të ndryshme për kalimin e pronësisë të pasurisë së mësipërme shtetasve të tjerë.

PËRFITUESI VASIL FRAN GJONI

Gjatë hetimeve ka rezultuar se më datë 1.08.2017 bashkia Lezhë ka dërguar dokumentacionin për regjistrimin e pasurisë në emër të shtetasit Vasil Fran Gjoni. Më datë 29.06.2016 shtetasi Eduart Karaçi, i pajisur me prokurë, ka aplikuar për regjistrimin e pasurisë nr 821/15. Më datë 19.01.2017 ZVRPP Lezhë, i ka kërkuar Bashkisë Lezhë konfirmim të dokumentacionit të paraqitur prej bashkisë pasi gjatë procesit të shqyrtimit të dokumentacionit për regjistrimin është evidentuar se AMTP me nr 1954 datë 26.04.2003, në emër të Vasil Fran Gjoni, nuk është administruar më parë nga kjo zyrë. Po ashtu nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se pasuria me nr 821/15, është pasuri e llojit 'ranishte', me pronar 'shtet'. Nga Bashkia Lezhë më datë 21.08.2017 e nënshkruar dhe vulosur prej kryetarit Fran Frokaj nga nënkryetari Enver Hafizi është konfirmuar se lloji i pasurisë nr 821/15, është tokë 'arë'. Më tej evidentohet se pas verifikimeve të dokumentacionit dhe kartelës përkatëse të pasurisë në ZVRPP Lezhë, kjo pasuri është regjistruar në 'ranishte'. Këshilli i qarkut Lezhë me shkresë me datë 10.07.2017 të nënshkruar dhe vulosur nga kryetari i Këshillit të qarkut Lezhë Gjak Ndoka, ka evidentuar se parcela me nr 821/15 fshati mali i Rencit, është me

zërin kadastral tokë arë.

ZVRPP Lezhë me urdhër të regjistruarit Artan Djala ka miratuar urdhin për ndarjen e pasurisë 821/15 më pas është nxjerrë urdhri për korrigjimin e kësaj pasurie në emër të shtetasit Vasil Fran Gjoni. Dhe më pas është nxjerrë urdhri për regjistrimin e kësaj pasurie në emër të shtetasit Vasil Fran Gjoni. Kërkesa për regjistrimin e kësaj pasurie është bërë nga Vasil Fran Gjoni dhe pranuar nga juristi ZVRPP Lezhë, Ermando Jakaj. Më pas nga shtetasi Vasil Fran Gjoni janë kryer veprime juridike të ndryshme për kalimin e pronësisë të pasurisë së mësipërme shtetasve të tjerë.

PËRFITUESI PJETËR FRAN GJONI

Gjatë hetimeve ka rezultuar se më datë 1.08.2016 Bashkia Lezhë ka dërguar dokumentacionin për regjistrimin e pasurisë në emër të shtetasit Pjetër Fran Gjoni. Më datë 29.08.2016 shtetasi Eduart Karaçi, i pajisur me prokurë, ka aplikuar për regjistrimin e pasurisë nr 821/15-C. Më datë 19.01.2017 ZVRPP Lezhë, i ka kërkuar Bashkisë Lezhë konfirmim të dokumentacionit të paraqitur prej bashkisë pasi gjatë procesit të shqyrtimit të dokumentacionit për regjistrimin është evidentuar se AMTP me nr 1962 datë 26.04.2003, në emër të Pjetër Fran Gjoni, nuk është administruar më parë nga kjo zyrë. Po ashtu nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se pasuria me nr 821/15-C, është pasuri e llojit 'ranishte', me pronar 'shtet'. Nga Bashkia Lezhë më datë 31.05.2017 e nënshkruar dhe vulosur nga kryetari Fran Frokaj është konfirmuar se lloji i pasurisë nr 821/15-C, është tokë 'arë'. Më tej evidentohet se pas verifikimeve të dokumentacionit dhe kartelës përkatëse të pasurisë në ZVRPP Lezhë, kjo pasuri është regjistruar në 'ranishte'. Këshilli i qarkut Lezhë me shkresë me datë 10.07.2017 të nënshkruar dhe vulosur nga kryetari i Këshillit të qarkut Lezhë Gjak Ndoka, ka evidentuar se parcela me nr 821/15-C fshati mali i Rencit, është me zërin kadastral tokë arë. ZVRPP Lezhë me urdhër të regjistruarit Artan Djala ka miratuar urdhin për ndarjen e pasurisë 821/15-C më pas është nxjerrë urdhri për korrigjimin e kësaj pasurie në emër të shtetasit Pjetër Fran Gjoni. Dhe më pas është nxjerrë urdhri për regjistrimin e kësaj pasurie në emër të shtetasit Pjetër Fran Gjoni. Kërkesa për regjistrimin e kësaj pasurie është bërë nga Pjetër Fran Gjoni dhe pranuar nga juristi ZVRPP Lezhë, Ermando Jakaj. Më pas nga shtetasi Pjetër Fran Gjoni janë kryer veprime juridike të ndryshme për kalimin e pronësisë të pasurisë së mësipërme shtetasve të tjerë.

PËRFITUESI RENATO ZEF MALOTAJ

Gjatë hetimeve ka rezultuar se më datë 16.08.2017 Bashkia Lezhë ka dërguar dokumentacionin për regjistrimin e pasurisë në emër të shtetasit Renato Zef Malotaj. Më datë 17.08.2017 shtetasi Renato Malotaj, ka aplikuar për regjistrimin e pasurisë nr 1003/A. Më datë 18.08.2017 ZVRPP Lezhë, i ka kërkuar Bashkisë Lezhë konfirmim të dokumentacionit të paraqitur prej bashkisë pasi gjatë procesit të shqyrtimit të dokumentacionit për regjistrimin është evidentuar se AMTP me nr 9266 datë 11.02.2002, në emër të Renato Malotaj, nuk është administruar më parë nga kjo zyrë. Po ashtu nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se pasuria me nr 1003/A, është pasuri e llojit 'ranishte', me pronar 'shtet'. Nga Bashkia Lezhë më datë 21.08.2017 e nënshkruar dhe vulosur nga kryetarin Fran Frokaj është konfirmuar se lloji i pasurisë nr 1003/A është tokë 'arë'. Më tej evidentohet se pas verifikimeve të dokumentacionit dhe kartelës përkatëse të pasurisë në ZVRPP Lezhë, kjo pasuri është regjistruar në 'ranishte'. Këshilli i qarkut Lezhë me shkresë me datë 10.07.2017 të nënshkruar dhe vulosur nga kryetari i Këshillit të qarkut Lezhë Gjak Ndoka, ka evidentuar se parcela me nr 1003/A fshati mali i Rencit, është me zërin kadastral tokë arë. ZVRPP Lezhë me urdhër të regjistruarit Artan Djala ka miratuar urdhin për ndarjen e pasurisë 1003/A më pas është nxjerrë urdhri për korrigjimin e kësaj pasurie në emër të shtetasit Renato Malotaj. Dhe më pas është nxjerrë urdhri për regjistrimin e kësaj pasurie në emër të shtetasit Renato Malotaj. Kërkesa për regjistrimin e kësaj pasurie është pranuar nga juristi i ZVRPP Lezhë, Ermando Jakaj. Më pas nga shtetasi Renato Malotaj janë kryer veprime juridike të ndryshme për kalimin e pronësisë të pasurisë së mësipërme shtetasve të tjerë.

Enti Shtetëror i Banesave, "fshirja" për periudhën 1995 e deri më 31 dhjetor të vitit 2015

Ornela Manjani

Falen kreditë e banesave për mbi 1084 familje

Kategoritë përfituese, çlirohen nga 609 milionë lekë detyrim

Qeveria shqiptare do të falë kreditë për 1084 familje që përfshijnë vitin e largët 1995 e deri më 31 dhjetor të vitit 2015, kryesisht familje të prekura nga përmbytjet dhe që kanë përfituar banesa nëpërmjet Entit Shtetëror të Banesave. Në relacionin që shoqëron projektligjin e depozituar në parlament dhe që pritet të kalojë në komisionet përgjegjëse theksohet se pjesa më e madhe e familjeve janë të varfra dhe nuk mund t'i shlyejnë kreditë. Lista e banorëve përfitues shtrihet në Has, Lezhë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Shkodër dhe Fier dhe me një total prej rreth 609 milionë lekësh.

RELACIONI

Për pikën ku përcaktohet falja e detyrimeve të mbetura të kredisë për familjet në Kukës, Has, Tropojë dhe Pukë të shpërngulura nga ndërtimi i Hidrocentralit të Fierzës sqarohet se kredia është akorduar për mënjanimin e dëmeve të përmbytjes së dhjetorit 1995. Kredia iu kalua për t'u trajtuar nëpërmjet EKB-së. Në vitin 2006, me urdhrin nr.225, datë 19.9.2006, të kryeministrit është ngritur një grup ndërministror për verifikimin e listës së familjeve të përmbytura nga Hidrocentrali i Fierzës. Nga sa është bërë e ditur nga puna e kryer nga ky grup lidhur me këtë problematikë, nuk është arritur një konkluzion apo zgjidhje përfundimtare. Për këtë proces nuk disponohet material. Nga familjet banuese në këto banesa është ngritur shqetësimi dhe pretendimi se e kanë të pamun-



Enti Shtetëror i Banesave

dur shlyerjen e detyrimeve (paradhënies apo paradhënies dhe një pjesë të kredisë). Arsyet që paraqesin janë si më poshtë: - Paafësia paguese. Pjesa më e madhe e familjeve kanë deklaruar se jetojnë në kushte të vështira dhe nuk kanë mundësi financiare për shlyerjen e kredisë. - Kërkohej falja e kredisë me arsyetimin se banesat e tyre dhe tokat e përmbytura në vendin e origjinës kanë një vlerë më të madhe se vlera e kredisë. Me fondin e vënë në dispozicion, me vlerë 150 000

lekë për frymë nuk mund të përfundonin ndërtimin e banesës dhe se për këtë janë detyruar të përdorin fonde të tjera. Kjo ka ndikuar në pamundësinë e shlyerjes së vlerës së kredisë. Nga ana tjetër, Enti Kombëtar i Banesave ka hapur procese gjyqësore, duke kërkuar kthimin e vlerave të tërhequra nga këta qytetarë. Por, në këtë proces të ndjekur nga Enti kanë rezultuar shumë pengesa për arsyet e mëposhtme: shpenzimet gjyqësore për hapjen e padive dhe pagimin e tatimit

E DREJTA PËR STREHIM

- Detyrimet e institucioneve shtetërore dhe përgjegjësitë e të tretëve lidhur me të drejtën për strehim, në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë:
 - E drejta për strehim duhet të respektohet pa diskriminim.
 - E drejta për strehim duhet të jetë objekt i një realizimi progresiv.
 - E drejta për strehim duhet të realizohet nga institucionet shtetërore në mënyrë të menjëhershme ose në pamundësi, të dëshmohej përpjekjet dhe masat maksimale të ndërmarra për sigurimin e tij.

të planifikuar të ndërtohej, por janë larguar duke ndërtuar diku tjetër, ose duke mos ndërtuar fare. Përfaqësuesit e EKB-së në disa qarqe kanë realizuar takime në bashkitë dhe ish-komunat përkatëse, por përgjigjja nga këto takime ka qenë se këta qytetarë janë larguar nga ajo komunë apo bashki. Njëkohsisht është kërkuar ndihmesë edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile për të bërë të mundur marrjen e adresave të reja për qytetarët që kanë ndërruar adresat. Për kreditë e lëvruara për përmbytjet, kontratat nuk janë lidhur pranë noterit. Duke gjykuar se këto të dhëna dhe argumente do të jenë të vlefshme në funksion të gjetjes së një rrugëzgjdhjeje për këtë problematikë, është propozuar përfshirja e kësaj pike në dispozitat transitorë të projektligjit të ri të strehimit. Aktualisht, shumica e fondeve të dhëna nga buxheti i shtetit për përmbytjet konsiderohet e vështirë dhe problematike për t'u arkëtuar nga banorët, ndërsa heqja e këtyre detyrimeve nga bilanci nuk ka faturre financiare për buxhetin e shtetit apo për Entin Kombëtar të Banesave.

për vlerën e kërkuar nëpërmjet çdo padie të ngritur rëndojnë shumë shpenzimet e EKB-së. Largimi i këtyre qytetarëve (familjeve) në emigracion. Proceset gjyqësore

janë mbyllur disa herë, si nuk gjenden adresat e sakta të këtyre qytetarëve, të cilësuar si "të paditur", nisur fakti se ata nuk kanë ndërtuar banesën në vendin ku është

'Fondi', qeverisë: Kujdes me PPP-të!

FMN, kundër TVSH-së për biznesin e vogël

Në lidhje me përfshirjen në TVSH të bizneseve me xhiro mbi 2 milionë lekë, FMN këshilloi se "administrata do të shpërqendrohet, në vend që të fokusohet të ndërmarrjet e mëdha dhe ka rrezik të ulen të ardhurat, ndaj nuk ishim dakord që në fillim. Nuk mendojmë se është një masë e mirë në drejtim të rritjes së të ardhurave". Ky fakt u bë i ditur dje nga misioni i parë i FMN-së për Monitorimin e post-programit në një takim me mediat. FMN përsëriti edhe një herë se nuk është kundër koncesioneve me Partneritet Publik Privat, por se duhen përzgjedhur projekte cilësore, që duhet të kalojnë në një mekanizëm të qartë dhe transparent se si do të realizohen. Misioni i parë i FMN-së për monitorimin e post-programit në një takim me mediat pohoi se ka mosmarrëveshje me qeverinë për PPP-të. "E këshillova qeverinë dy javë më parë të ngrinte koncesionet, me qëllim që të



ngrinte kuadrin e duhur, pasi ngritja e tij kërkon kohë", shtoi përfaqësuesi i FMN-së në vendin tonë, Jens Reinke, i cili pohoi se 'Fondi' po jep asistencë teknike për këtë çështje, por qeveria i ka thënë 'Fondit' se e ka gati mekanizmin. Misioni i FMN-së pohoi se në rastin e projekteve me PPP ka ndarje të rrishtit mes shtetit dhe privatit. Spas tij, "është e rëndësishme që qeveria shqiptare të mos marrë më shumë risk se çfarë duhet. Për projektet PPP ka shumë rreziqe nisur nga përvojat e vendeve të tjera, pran-

daj 'Fondi' i ka kërkuar qeverisë të bëjë analizat e duhura në lidhje me këto projekte". Më tej, përfaqësuesja e misionit të FMN-së në Tiranë, Anita Tuludhar tha: "Nuk jemi në program me Shqipërinë, po japim këshilla, ndaj për çdo rrezik është përgjegjësia e autoriteteve. Shpresojmë se në rast se qeveria do të vazhdojë me koncesionet, atëherë risqet të pasqyrohen në bilanc".

RRITJA EKONOMIKE

"Rritja ekonomike në Shqipëri është e fortë, 3.9% këtë vit dhe 3.7% në vitin e ardhshëm, nga më të lartat në rajon. Inflacioni është i ulët, ekspozimet të forta, rezervat të kënaqshme. Nuk është koha për vetëkënaqje se rritja mund të mos zgjasë. Tregu ndërkombëtar mund të ngadalësohet në afat të mesëm. Në tregun e brendshëm ka borxh të lartë, NPL të larta dhe mjedis të vështirë për biznes", vuri në dukje misioni i FMN-së, duke këshilluar vijimësinë e konsolidimit fiskal.

VACANCY ANNOUNCEMENT

The Health for All Project (HAP) in Albania is funded by Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) and is being implemented by a consortium of three organizations: the Swiss Tropical and Public Health Institute (Swiss TPH), and the NGOs Terre des hommes (TdH) and Save the Children (SC), through HAP Center. The project started in January 2015 and will have an implementation timeframe of 4 years. Its overall goal is that the Albanian population, particularly the most vulnerable, benefit from better health due to improved Primary Health Care (PHC) services and health promotion activities.

Save the Children is recruiting for motivated and experienced staff for the project "HAP project"

Post title: **Procurement Assistant for HAP project**
 Albania Country Office

Application deadline: **3rd April 2018, 1:00pm**

The Procurement Assistant for HAP maintain effective procurement and logistic system, supporting the project to deliver objectives effectively and efficiently.

REQUIRED QUALIFICATIONS AND EXPERIENCES

- Bachelor degree on Management, Administration or relevant equivalent qualification with relevant experience in the field of procurement/logistic.
- Communication skills both written and verbal in order to establish effective relationships with a wide variety of internal and external audiences.
- Good understanding of the Albanian market.
- 5 years of experience in implementing procurement for different public and/or private organizations and/or technical cooperation projects. Extensive knowledge of procurement procedures and guidelines would be an asset.
- Previous experience in a logistic/administrative role.
- Strong attention to detail and organizational skills.
- Ability to work in a challenging environment.
- Solution focused with the ability to work under pressure, quickly and flexibly.
- Empathy with the values and objectives of SC and the Swiss Agency for Development and Cooperation.
- Good written and spoken Albanian and English language skill.
- Computer literate and internet applications.

Information regarding the duties and responsibilities (Job Description) you may find on the website of Save the Children <https://albania.savethechildren.net/jobs>

Interested candidates should submit the following within the application deadline:

- Cover letter clearly explaining your motivation for applying your motivation for applying for the position and how you meet the position criteria;
- Detailed CV
- List of reference with contact details

Application should be sent by email with subject **"Procurement Assistant – HAP project"** to the address below.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë nxjerr urdhrin e miratimit për privatizim

Vendim i ri, procedurat për privatizimin dhe shitjen të tokave shtetërore

Kërkesa duhet të shqyrtohet brenda 30 ditëve

Ornela Manjani

Ndryshojnë procedurat për privatizimin dhe shitjen e tokave shtetërore. Këshilli i Ministrave ka miratuar ndryshimin e kritereve të vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes. Qeveria vendosi që kësaj procedure t'i nënshtrohen të gjitha ndërmarrjet apo objektet e veçuara, mjetet kryesore, mjetet e xhiros në administrim apo në ruajtje të institucioneve, ndërmarrjeve dhe shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror, për të cilat është dhënë miratimi i ministrit përgjegjës për ekonominë për fillimin e procedurave të privatizimit apo të transformimit në shoqëri tregtare. Në ndryshimet e fundit ligjore të botuara dje në Fletoren Zyrtare mësohet se kërkesa duhet të shqyrtohet brenda 30 ditë nga marrja e saj. "Institucionet qendrore dhe organet e njësive të vetëqeverisjes vendore dërgojnë kërkesat e tyre për privatizimin e ndërmarrjeve apo të institucioneve që kanë në varësi administrative ose në pronësi, në ministrinë përgjegjëse për ekonominë. Ministri përgjegjës për ekonominë nxjerr urdhrin e miratimit për privatizim, sipas kërkesave të përmendura më sipër. Në rast se ministria përgjegjëse për ekonominë u kërkon institucioneve qendrore apo organet e njësive të vetëqeverisjes vendore kërkesën për prononcim privatizimi për pasuritë e ndërmarrjeve apo të institucioneve që kanë në varësi administrative, këto institucione janë të detyruara që brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, të dërgojnë mendimin e tyre për privatizimin e këtyre pasurive", thuhet në VKM-në.

PROCEDURA

Në vendim është përcaktuar që për dokumentacionin e përgatitur nga komisioni i vlerësimit ndiqet kjo procedurë: a) I dërgohet ministrit përgjegjës për ekonominë: i) për objektet ndërtimore, linjat e prodhimit/shërbimit, ku përcaktohen vlera e objektit, sipërfaqja e përgjithshme, ajo nën objekt dhe ajo funksionale; ii) për makineritë, pajisjet, mjetet e transportit, inventarin ekonomik, mjetet e xhiros etj., kur asetet do të shiten të veçanta. Fletorja Zyrtare Viti 2018 - Numri 37.

VENDIMMARRJA

Ministria e Financave dhe Ekonomisë pasi kontrollon nëse ky dokumentacion ka kaluar në strukturat përkatëse, ia përcjell atë Komisionit të Shqyrtimit dhe Transparençës, të ngritur me urdhrë të ministrit përgjegjës për ekonominë, për verifikimin, konfirmimin dhe transparençën e procedurës së dokumentacionit të priva-

VENDIM
Nr. 141, datë 13.3.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 54, DATË 5.2.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURËS E TË MËNYRËS SË DHËNIES ME QIRA, ENFITEOZË APO KONTRATA TË TJERA TË PASURISË SHTETËRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, si amur 3, të akteve normative nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërie tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të shërbimit të këtyre ndërmarrjeve", të miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, dhe të nenit 784 e 801, të ligjit nr. 7830, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", si ndryshime, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesa të mëposhtme:

1. Kode në vendim, emërtimet "Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme" dhe "Agjencia për Këmbimin dhe Kompenzimin e Transerit" shënohen, përkatësisht, me fjalët "Regjistrimi i pasurive të paluajtshme" dhe "institucioni i këmbimit dhe kompenzimit të transerit".

Vendimi i qeverisë



SHITJA
Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pasi kontrollon nëse ky dokumentacion ka kaluar në strukturat përkatëse, ia përcjell atë Komisionit të Shqyrtimit dhe Transparençës, të ngritur me urdhrë të ministrit përgjegjës për ekonominë, për verifikimin, konfirmimin dhe transparençën e procedurës së dokumentacionit të privatizimit të pronës shtetërore, që dërgohet për shitje.

Për sipërfaqet 200-500 m2 është deri në 10 vjet

Toka me qira, afatet dhe çmimet e reja



VENDIMI

Kushtet e reja janë vendosur nga qeveria pas disa ndryshimeve dhe shtesave në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave

Personat që duan të marrin tokë shtetërore me qira do të përballen me afate dhe tarifa të reja. Kështu, për një sipërfaqet 200-500 m2 afati i kontratës është deri në 10 vjet, ndërsa për sipërfaqet mbi 500 m2 afati i kontratës është deri në 20 vjet. Kushtet e reja janë vendosur nga qeveria pas disa ndryshimeve dhe shtesave në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar. Dokumentacioni për marrjen me qira që paraqesin konkurrentët i dorëzohet komisionit në orën e hapjes së konkurrit dhe përmban: a) Kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore, ku të deklarohet oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore, si dhe treguesit e konkurrimit, të parashikuar sipas planit të biznesit. b) Plan-biznesin e hollësishtëm për vënie në funksionim të objektit, në

të cilin duhet të përfshihet informacioni i mëposhtëm: identiteti i subjektit kërkuës, historiku i aktivitetit që kryen. Përkrahimi i projektit të investimit, i punimeve që do të realizohen, i shërbimeve që do të ofrohen, i burimeve financiare të investimit. Analiza e detajuar e afateve kohore, që do të duhen për të realizuar projektin investues, si

dhe fazat e përcaktuara të realizimit të tij. Niveli i punësimit që do të realizohet sipas fazave kohore të përcaktuara. Dokumentacioni për marrjen me enfiteozë që paraqesin konkurrentët, të cilët duhet të jenë shoqëri tregtare i dorëzohet komisionit dhe përmban: a) kërkesën e subjektit për marrje me enfiteozë të pasurisë shtetërore, ku të

deklarohet oferta për vlerën e detyrimit mujor, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore, si dhe treguesit kryesorë financiarë të parashikuar sipas planit të biznesit. b) CV-në e subjektit, ku të tregohet përvoja në fushën e aktivitetit ekonomik që do të ushtrohet në pasurinë që jepet me enfiteozë, të shoqëruar me dokumentacion vërtetues. c)

Plan-biznesi i hollësishtëm për përmirësimin e pronës. ç) Përkrahimi i projektideve të investimit, të dhëna për nivelin e investimeve të parashikuar në pasuri të paluajtshme dhe në objektin në tërësi, shoqëruar me projektet, skica dhe dokumentacion tjetër paraprak, si dhe burimin e financimit të projektit. Brenda 15 ditëve bën shqyrtimin e ofertave të paraqitura, verifikim dokumentacionin e paraqitur nëpërmjet platformës elektronike 'e-Albania' ose nëpërmjet komunikimit e ndërveprimit ndërinstitucional, sipas përcaktimit në urdhrin e titullarit dhe vlerëson me pikë çdo element konkurrimi, sipas përcaktimit në urdhrin e titullarit. Subjektit, i cili paraqet vlerën më të lartë të propozuar të jepen pikët maksimale të çdo elementit konkurrimi, ndërsa subjekteve të tjera pikët u llogariten në përpjesëtim të drejtë me vlerën më të lartë të propozuar. Në përfundim, konkurruesit renditen në bazë të shumës së pikeve të përfuturara.

MFE, anëtar. SHQYRTIMI

Komisioni i Shqyrtimit dhe Transparençës i rekomandon ministrit përgjegjës për ekonominë vijimin e procedurës së privatizimit nga struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike, nëse

përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe të Përpunshmerisë, MFE, anëtar; dy përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, MFE, anëtar dhe një përfaqësues të Drejtorisë së Auditimit,

ekziston dokumentacioni i kërkuar ligjor dhe ka kaluar në të gjitha strukturat e parashikuara në këtë vendim. Në rast të kundërt, Komisioni i Shqyrtimit dhe Transparençës kërkon plotësimin e dokumentacionit. Për kontratat e shitjes të dek-

laruara të pavlefshme me vendim gjykatë të formës së prerë, duke kthyer palët në gjendjen e mëparshme, procedurat e rivlerësimit të objektit bashkë me trullin II të bëhen sipas kreut II të këtij vendimi dhe legjislacionit në fuqi për privatizimin.

Në shtator të vitit 2008, Elvis Belba tentoi të vriste një efektiv të FNSH-së

TIRANË

Arrestohet pjesëtari i bandës "Toni i zi", kërkohet nga Italia për grabitje e eksploziv 35-vjeçari nga Pogradeci u prangos në Tiranë

Policia e Tiranës ka vënë në pranga 35-vjeçarin Erlis Belba nga Pogradeci, i cili ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet italiane, pasi ishte pjesë e një organizate kriminale që bënte vjedhje me dhunë. Mësohet se Belba ishte pjesë e bandës famëkeqe, drejtuar nga "Toni i zi" (Antonino Pinto). Në janar të vitit 2016, Erlis Belba u arrestua bashkë me 5 italianë. Preja e fundit e grupit përpara arrestimit ishte një çantë prej lëkure me vlerë 55 mijë euro. Çdo pjesëtar i grupit ku bënte pjesë 35-vjeçari kishte detyra të caktuara. Por, Erlis Belba ka qenë emër i njohur edhe për policinë shqiptare. Në vitin 2008, ai së bashku me Ardian Bregasin kanë tentuar të vrasin një efektiv të FNSH-së.

NGJARJA NË 2008

Më datën 28.09.2008, në rr. "Babë Rexha", rreth orës 19:00, është tentuar të vritet me anë të një arme luftarakë tip kallashnikov shtetasi Artan Metuku, me banim në qytetin e Tiranës dhe polic pranë forcave speciale FNSH, Tiranë. Ngjarja ka ndodhur për motive të dobëta, pas një grindjeje të castit ndërmjet shtetasve Ardian Bregasi, Erlis Belba dhe Artan Metuku. Shtetasi Artan Metuku, i cili është me cilësinë e të dëmtuarit ditën e ngjarjes rreth orës 17.00-17.30 ka qenë në lokalin "Mirilind" që ndodhet në rrugën "Babë Rexha" me shtetasit Naim Ruci dhe Sokol Shuka. Ndërkohë, jashtë lokalit kanë parë shtetasin Erlis Belba, së bashku me një shoqen e tij, që kanë filluar të debatojnë dhe më pas shtetasi Erlis Belba po e godiste këtë shtetas. Duke parë këto veprime, shtetasit Artan Metuku dhe Naim Ruci kanë shkruar afër tyre dhe i kanë pyetur shtetasit

e mësipërm nëse kishin ndonjë problem. Pas sqarimit, të dyja palët janë larguar që aty. Më pas, shtetasi Erlis Belba është takuar me të pandehurin Ardian Bregasi dhe e vuri në dijeni të shërrit që kishte ndodhur me të njohurën e tij dhe konfliktin me shtetasin Artan Metuku.

Kur po ktheheshin në banesat e tyre, Ardian Bregasi dhe shtetasi Erlis Belba kanë shkruar më parë tek lokali "Mirilind" ku ishin akoma në kafë shtetasit Artan Metuku, Naim Ruci dhe Krenar Terpollari. Mes këtyre personave ka nisur një grindjeje në fillim me fjalë dhe më pas duke u goditur me grushte. Pas këtij momenti, shtetasi Ardian Bregasi është drejtuar në banesën e tij, e cila ndodhej përballë dhe pas tij ka shkruar edhe shtetasi Erlis Belba. Pas disa momentesh, ka dalë nga banesa e tij shtetasi Ardian Bregasi duke mbajtur në dorë një arme automatik, që e mbante pa leje të organeve kompetente dhe ka filluar të qëllojë në drejtim të shtetasit Artan Metuku. Më pas ka dalë shtetasi Erlis Belba. Si pasojë e të shtënave me armë ka mbetur i plagosur shtetasi Artan Metuku. Pas kësaj ngjarjeje, i pandehuri Ardian Bregasi dhe shtetasi Erlis Belba janë larguar së bashku me armën e krimit, të cilën i pandehuri e ka hedhur pas disa metrash rrugë dhe vetë është larguar duke iu fshehur organeve të drejtësisë.




AKUZAT

35-vjeçari shqiptar Erlis Belba është shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Roma, pasi autoritetet gjyqësore italiane me urdhër-arresti mi nr.OÇ 9307, datë më 12.12.2017, kanë caktuar masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj tij. Ai akuzohet për kryerjen e veprave penale: "Anëtar i organizatës kriminale në vjedhjet me dhunë, marrja e sendeve të vjedhura, përdorimi i lëndëve eksplozive", të parashikuara nga Kodi Penal italian.

KPK çon për ndjekje penale ish-anëtarin e Gjykatës Kushtetuese, Besnik Ymeraj

TIRANË - Procesi i vetingut dhe zbatimit i reformës në drejtësi duket se ka nisur të japë efektet e para. Kështu, ish-anëtarin e Gjykatës Kushtetuese, Besnik Ymeraj është referuar për ndjekje penale nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Është ky komision që në përfundim të rivlerësimit të figurës së Ymerajt, i cili dha dorëheqjen në janar të këtij viti nga Gjykata Kushtetuese, ka referuar pranë zyrës së Prokurorisë së Përgjithshme dokumentacionin për ish-gjyqtarin. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se në bazë të nenit 281 të Kodit të Procedurës Pe-



Ish-anëtarin e Gjykatës Kushtetuese, Besnik Ymeraj

nale ka referuar pranë Zyrës së Prokurorisë së Përgjithshme të gjithë dokumentacionin që rezultoi nga hetimi administrativ gjatë procesit të rivlerësimit të ish-gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Besnik Ymeraj", thuhet në njoftimin e KPK-së. Më 31

janar të këtij viti, ish-anëtarin e Gjykatës Kushtetuese, Besnik Ymeraj dha dorëheqjen për arsye personale. Ai ishte ndër të parët në listën e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese që do të thirrej nga organet e vetingut.

Kokaina në Durrës, Apeli i në burg 2 të arrestuarit

TIRANË - Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda ka lënë në burg Armando Pezakun dhe Donald Lushajn, si të implikuar me ngarkesën prej 613 kg kokainë të kapur në kontejnerin me banane në Maminë të Durrësit. 25-vjeçari Armando Pezaku ishte shoferi i trailerit që transportonte ngarkesën me banane, në të cilën u kap sasia rekord e drogës. Ndërsa Donald Lushaj ishte menaxheri i firmës "Arbri Garden" në pronësi të Arbër Çekaj, që kishte porositur ngarkesën nga Kolumbia. Dy të rinjtë janë të vetmit të arrestuar në lidhje me ngjarjen, ndërsa Arbër Çekaj, pronari i kompanisë "Arbri Garden" është shpallur në kërkim. 41-vjeçari nga arratia ka mohuar përfshirjen e tij, duke deklaruar në media se do të kthehej në Shqipëri për t'u përballur me akuza. Por kur kanë kaluar gati tri javë, kjo gjë ende nuk ka ndodhur. Për prokurorinë, dëshmia e tij konsiderohet mjaft e rëndësishme. Në Gjermani, ku ai mendohet se fshihet, janë bërë disa kontrole në adresën e dhënë, por nuk është gjetur.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Mirëmbajtja vjetore e sistemit Cisco Web Content"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 4,671,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në logarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
 BIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Mirëmbajtja vjetore e sistemit Cisco Web Content"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, deri më datë 11 Prill 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

SCPA PROGRAM

STRENGTHENING COMMUNITY POLICING IN ALBANIA

Call for Proposals

Call for a contractor to conduct a Police Satisfaction Study in the 12 regions (Qarqet) of Albania:

Type of Contract - Short term consultancy
 Languages Required - English and Albanian
 Location - 12 Regional areas of Albania
 Commencement Date - 9 April 2018

With the support of the SCPA project the ASP wants to acquire reliable data on the level of satisfaction of citizens towards the services provided by the police, in order to adjust the strategies, action plans and resources to the areas that concern the most the public.

The terms of reference for this study can be downloaded from the following link : <http://www.cp-project.al/web/en/2018/03/call-for-proposals/>

Deadline for receipt of applications: - 30th of March 2018, 17:00 hrs

The applications shall be submitted by email at info@cp-project.al.

TIRANË - Prona mbi 10 milionë euro dhe një kompani ndërtimi janë sekuestruar nga Policia e Shtetit, me vendim të Gjykatës së Krimeve të Rënda. Të gjitha këto ishin të regjistruar në emrin e Luan Spahiut, 53 vjeç, ndërsa dyshohet se kjo pasuri është përfituar nga trafiku i kokainës. Biznesmeni Spahiu rezultoi i dënuar edhe më herët në vitin 2011 me 5



Kokainë në Kolombi, biznesmenit i sekuestruon pronën me vlerë 10 mln euro e një kompani ndërtimi

vite burg për trafikim të lëndëve narkotike nga Gjykata e Frajbugut. 53-vjeçari është dënuar për trafikimin e sasive të mëdha të kokainës nga Kolombia drejt Gjermanisë dhe vendeve të tjera. Paratë e fituara nga kjo linjë e trafikimit të ko-

kainës, dyshohet se Spahiu i kishte investuar në kompaninë e ndërtimit "Pinari" në Tiranë, si dhe në disa troje ndërtimi dhe sipërfaqe tokë në Selitë dhe në rrugën "Naim Frashëri". Pas hetimit të prokurorisë, gjykata vendosi që 32 apar-

tamente me sipërfaqe 3400 m² të sekuestruon. Sekuestro u vendos edhe mbi tri njësi tregtare në të njëjtin kompleks, me sipërfaqe 230 m². Po ashtu një vilë tri katëshe në rrugën "Hoxha Tahsim", me sipërfaqe 340 m², si dhe disa garazhe u

sekuestruan. Gjykata vendosi të njëjtin masë për dy sipërfaqe trojesh në rrugën "Naim Frashëri" dhe në Selitë, përkatësisht 5600 metra dhe 18 mijë m², si dhe tri automjete të shtrenjta. Asetet e kompanisë Pinari dhe llogaritë bankare të kësaj kompanie, të Luan Spahiut dhe të të afërmeve të tij, u bllokuan deri në përfundim të procesit gjyqësor.

Arrestohet autori Mahmut Gega. Policia: Ngjarja, për motive të dobëta



Enver Doçi

DIBËR

Një 32-vjeçar nga Dibra është ekzekutuar me kallashnikov në oborrin e shtëpisë së tij. Elsim Kosiqi sapo ishte kthyer nga Maqedonia dhe po mbyllte portën e banesës së tij, kur është qëlluar për vdekje me tre plumba në gjoks. Mësohet se babai tre fëmijëve, ishte pronar i një hoteli 5 katësh tek Llixhat në Peshkopë. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Dibrës bënë me dije se ngjarja e rëndë ndodhi në orët e para të mëngjesit të djeshëm në fshatin Maqellarë. Menjëherë pas sinjalizimit për vrasjen e biznesmenit, uniformat blu kanë shkuar në vendngjarje dhe kanë nisur hetimet. Pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprake, blutë kanë mundur të identifikojnë dhe të vënë në pranga autorin e krimit. Bëhet fjalë për 24-vjeçarin Mahmut Gega nga Shupenza, i cili akuzohet për veprat penale: "Vrasje me dashje" dhe "Armëmbajtje pa leje". Pas arrestimit, policia deklaroi se paraprakisht dyshohet se ngjarja ka ndodhur për motive të dobëta. Sipas hetuesve të çështjes, po hetohet intensivisht për zbardhjen e plotë të rrethanave të kësaj ngjarjeje që ka tronditur banorët e zonës.

VRASJA

Rreth orës 01:30, krismat e armës kanë terrorizuar pjesëtarët e familjes Kosiqi në Maqellarë. Në momentin që kanë dalë jashtë, ata kanë parë trupin e pajetë të 32-vjeçarit dhe menjëherë kanë sinjalizuar policinë, e cila ka mbërritur shpejt në vendngjarje. Pas kryerjes së veprimeve paraprake, blutë kanë gjetur dhe sekuestruar në oborrin e banesës së kësaj familjeje dy gëzhoja kallashnikovi. Ndërkaq, burime konfidenciale nga policia pohuan se mëngjesin e së hënës, Elsi Kosiqi kishte shkuar në Dibër të Madhe ku kishte qëndruar me disa shqiptarë dhe një shtetas maqedonas gjatë gjithë ditës, deri në mesnatë. Në orën 01:30 ai është kthyer në banesë, por sapo ka parkuar në oborr makinën e tij tip "Benz" para derës së shtëpisë, autori ka përfituar nga porta e hapur dhe është futur në oborr duke e qëlluar tri herë me armë zjarri.

Ekzekutohet me kallashnikov në derë të shtëpisë biznesmeni Elsi Kosiqi

Babai i 3 fëmijëve u qëllua me tre plumba në gjoks



Viktima Elsim Kosiqi



Banesa e familjes Kosiqi ku ndodhi ngjarja

Sipas policisë, 32-vjeçari njihet si person problematik në zonë dhe se për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes po hetohet e shkuara e tij dhe e vrasësit. Në të njëjtin linjë kanë qenë dhe banorët e zonës. Këta të fundit u shprehën dje për "Gazeta Shqiptare" se viktima kishte të kaluar të dyshimtit. Gjithashtu, banorët pohuan se autori i krimit dhe viktima kanë qenë kohë më parë emigrantë në Itali.

BANORËT

Ngjarja ka ndodhur te veranda e banesës. Më pas autori është larguar me shpejtësi (ka përfituar nga errësira), duke qenë se shtëpia e familjes Kosiqi ndodhet vetëm disa metra larg nga rruga nacionale dhe 500 metra nga kufiri me Maqedoninë.

HETIMET

Vrasja e babait të tre fëmijëve ka alarmuar policinë, e cila është vënë në kërkim të autorit të krimit. Blutë kanë ngritur postblogoje të shumta në rrugë, ndërsa kanë bërë krehjen e gjithë zonës. Pas ngjarjes, policia deklaroi se vrasësi/it mund

të identifikohen shumë shpejt, pasi në ilke e sipërkanë lënë gjurmë në vendin e ngjarjes. Vetëm në orët e vona të mëngjesit të martës, blutë kanë arritur të identifikojnë dhe të arrestojnë ekzekutorin e biznesmenit Elsi Kosiqi. Zyrtarisht, policia bëri me dije se

krimi dyshohet të ketë ndodhur për motive të dobëta pa dhënë detaje të tjera për shkak të ruajtjes së sekretit hetimor. Po sipas policisë, 32-vjeçari njihet si person problematik në zonë dhe se për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes po hetohet e shkuara e tij dhe e vrasësit Mahmut Gega. Në të njëjtin linjë kanë qenë dhe banorët e zonës. Këta të fundit u shprehën dje për "Gazeta Shqiptare" se viktima kishte të kaluar të dyshimtit. Gjithashtu, banorët pohuan se autori i krimit dhe viktima kanë qenë kohë më parë emigrantë në Itali.




Takimi në Elbasan

Prefekti i Elbasanit mbledh Task Forcën kundër drogës. Qato: Luftë pa kompromis

ELBASAN - Prefekti i Elbasanit, Maksim Malaj mbledh Task Forcën Vendore kundër kultivimit dhe trafikimit të drogës. Drejtori i Policisë së Elbasanit, Altin Qato tha se do të ketë luftë pa kompromis kundër kultivimit dhe trafikimit të narkotikëve. Në tryezë u

dhanë edhe shifra për operacionet kundër drogës. "Gjatë 2017-ës u zbuluan 10 raste kultivimi të narkotikëve dhe qarku Elbasan ka pasur një sipërfaqe të papërfillshme të mbjellë me kanabis dhe është një nga qarqet më pak i prekur nga kanabizimi. Edhe rastet e

zbuluara nga kultivimi rezultuan se kishin shfrytëzuar në 87% të rasteve tokat publike. Elbasani mbetet qark me risk të ulët në kultivimin e narkotikëve, megjithatë edhe në bashkitë e qarkut Elbasan ka zona të preferuara nga grupet kriminale për t'i shfrytëzuar për kul-



Autori Dilaver Veshaj

Masakroi me sëpatë kushëririn në sy të djalit, gjykata lë në burg autorin

VLORË - Gjykata e Shkallës së Parë e Vlorës dje ka vendosur masën e sigurisë "arrest me burg" për 40-vjeçarin Dilaver Veshaj, i cili masakroi me sëpatë kushëririn 37-vjeçar, Arben Veshaj. Ngjarja kjo e ndodhur mëngjesin e sëshunës në fshatin Gumenicë të këtij rrethi. Pas krimit, babai i viktimës deklaroi se djali u vra në sy të të birit 7 vjeç. Pak ditë pas ngjarjes, mësohet se 37-vjeçari, i cili merrej me bagëti, mëngjesin e sëshunës ishte duke shkuar në stani i tij bashkë me djalin e tij të mitur. Pranë stanit të Arben Veshajt ndodhet dhe stani i kushëririt të tij, Dilaver Veshaj. Ndërsa 37-vjeçari po kalonte në afërsi të pronës së kushëririt bashkë me djalin e tij, i janë sulur qentë. Ai i ka qëlluar me gurë për t'i zbrapsur, por vetëm pak caste më pas kushëririn i tij, 40-vjeçari Dilaver Veshaj, pa asnjë paralajmërim ka nxjerrë pistoletën duke qëlluar katër herë në drejtim të tij. Pasi, nuk ka mundur dot ta vrasë me plumba, autori i është sulur edhe me sëpatë duke e goditur shumë herë në kokë dhe për pasojë e ka lënë të vdekur në vend.

tivimin e bimëve narkotike. Për t'i dhënë fund kultivimit, policia kërkon ndihmën e të gjitha strukturave shtetërore", deklaroi Qato. Josif Shtëmbari, përfaqësues i DPP tha se duhet të shkëputemi njëherë e përgjithmonë nga fenomeni i kultivimit dhe trafikimit të narkotikëve. "Gjatë 2017-ës u arritën rezultate spektakolare në luftën kundër këtij fenomeni", deklaroi Shtëmbari.



Foto ilustruese

Shpallen emrat e mësuesve kandidatë që do t'i nënshtrohen provimit sipas profileve

Që prej 6 marsit ka filluar testimi për mësuesit kandidatë që dëshirojnë të fillojnë punë në një nga institucionet e arsimit parauniversitar në vend. Në faqen e saj zyrtare AKP, ka përditësuar dje listat me emrat e të gjithë mësuesve që do të kryejnë testimin e informatizuar në peri-

udhën mars-prill, sipas kalendarit "Mësues për Shqipërinë". Të gjithë të interesuarit mund të verifikojnë në adresën akp.gov.al ditën e provimit sipas profileve Arsim Parashkollor, Gjuhë Angleze, Histori, Biologji, Gjeografi, Matematikë, Edukim Fizik, Kimi, Fizikë,

Shkenca Sociale etj. Testimi i informatizuar do të zhvillohet në godinën e Qendrës së Shërbimeve Arsimore në Tiranë ku kandidatit duhet të paraqitet 30 minuta para fillimit të testimit. Ai duhet të jetë i pajisur me letërnjoftim (Kartë ID ose Pasaportë); kopje të Kartë ID ose Pasaportë; si dhe duhet

të ketë formularin e pranimin nga ana e DAR/ZA për fazën e dytë të konkurimit. Të gjithë ata kandidatë, të cilëve u mungojnë këto dokumente, nuk mund të marrin pjesë në testimin e informatizuar. Ministria e Arsimit i bën thirrje të gjithë kandidatëve që të bëjnë verifikimin e emrit, biemërit, profilin si dhe datën dhe orën e testimit në faqen zyrtare të QSHA në adresën www.akp.gov.al.

Kreu i shoqatës: Ministria, po telefonon jofituesit për t'i kaluar në fazën tjetër



Voltiza Duro

Skandali me listën fituese në portalin e infermierëve, emrat përsëriten disa herë

"Pikë e pozicione të ndryshme për të njëjtin kandidat"


Pas publikimit të listës me emrat e kandidatëve fitues që aplikuan në portalin "Infermierë për Shqipërinë", janë konstatuar një sërë gabimesh që mund të ndikojnë edhe në penalizimin e aplikuesve. Pas verifikimeve të listës nga "Gazeta Shqiptare", si dhe pas ankesave të shumta të infermierëve, teknikëve të imazherisë, logopedistëve, e fizioterapistëve, rezultonte se në disa raste, emri i një kandidati rezultonte më shumë se një herë në listë, i pozicionuar në vende të ndryshme, me pikë të ndryshme. Ministria e Shëndetësisë në një deklaratë për mediat, bëri me dije dy ditë më parë se janë plot 1945 kandidatë që do të testohen, por mesa duket janë më pak se kaq, pasi emrat e kandidatëve përsëriten në të njëjtën listë, brenda të njëjtë qark. Kështu, është konstatuar se aplikanti Shqiponja Muharrem Ramadani (Haxhaja) rezultoi në listën e kandidatëve infermierë për Qarkun Tiranë plot 5 herë, ku është pozicionuar në vendin e 187-të me 8.6 pikë, në vendin e 254 me 8 pikë, më tej me 7.9 pikë në vendin e 275-të, për të vijuar me vendin e 304-të me 7.5 pikë dhe së fundmi rezultoi edhe në vendin e 464-të me 6.1 pikë në total.

REAGIMET

Kjo ka ndodhur edhe me shumë kandidatë të tjerë, të cilët kanë kërkuar një shpjegim në lidhje me situatën e krijuar. "Unë si dhe shumë të tjerë, nuk jam e kënaqur me vlerësimin, sepse doli që tabela e vlerësimit nuk është bërë ashtu siç thanë. Unë personalisht jam vlerësuar me 10.1 pikë, por mendoj se do të vlerësohesha më shumë pasi kam 7 vite punë pa ndërprerje dhe automatikisht vetëm nga kjo pjesë kam 7 pikë. Ndërkohë, vlerësimi për notën mesatare


187	Shqiponja Muharrem Ramadani (Haxhaja)	8.6
188	Safa Shaban Kaxhari	8.6
254	Shqiponja Muharrem Ramadani (Haxhaja)	8
275	Shqiponja Muharrem Ramadani (Haxhaja)	7.9
464	Shqiponja Muharrem Ramadani (Haxhaja)	6.1
304	Shqiponja Muharrem Ramadani (Haxhaja)	7.5
305	Violeta Baizem Dambazai	7.5

Një prej emrave të përsëritur 5 herë në listën e fituesve në portal




UEDA EJBEJA / PORTALI, TALLJE ME INFERMIERËT

Portali është "tallje" me infermierët e papunë, por korrupsionin në Shqipëri s'do zhduket kurrë. Nëse janë vërtetë siç thuhet, pra 420 vende pune të lira, askush s'do hyjë në punë falas, por me mik, parti dhe lekë; minimalisht kërkohen 3 mijë euro për t'u punësuar direkt me vendim ministrie", - thotë Ejbeja.



NERTILA LARAKU / VLERËSIM I GABUAR

"Unë si dhe shumë të tjerë, s'jam e kënaqur me vlerësimin. Jam vlerësuar me 10.1 pikë, por mendoj se do vlerësohesha më shumë pasi kam 7 vite punë pa ndërprerje dhe automatikisht vetëm nga kjo pjesë kam 7 pikë. Ndërkohë, vlerësimi për notën mesatare varioje nga 5-10 pikë. Por me vlerësimin e këtyre i bie që mesatarja është vlerësuar me 3.1 pikë", - thotë Laraku.



BAJAME PLAKU

"Në listën "Teknik imazherie", unë isha pozicionuar në vend të 14-të me 9.7 pikë, dhe më poshtë në vendin e 58-të me 8 pikë. Kam çuar një dosje dhe emri ka dalë dy herë, e këtu vetëm 9 vende të lira ka. Si mund të bëjnë eksperimente të tilla me njerëzit?! Ky portal nuk është transparent. Janë shumë raste që emri është përsëritur disa herë", - tregon Bajame Plaku.

varionte nga 5-10 pikë. Por me vlerësimin e këtyre i bie që mesatarja ime është vlerësuar me 3.1 pikë. Të shikojmë në vijim se çfarë do ndodhë, j-

tojmë në botën e çudirave", - thotë për "Gazeta Shqiptare", infermierja Nertila Laraku. Ndërkaq, kreu i Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë,

Elson Jaçaj tregon se reagimi i ministrisë erdhi fill pas publikimit të shqetësimit në "Gazeta Shqiptare". "U duk qartë që reagimi i ministrisë

ELSON JAÇAJ

95%, TË ZHGENJYER NGA PORTALI

"Nga anketimi që bëmë ne si shoqatë, mbi mënyrën e përzgjedhjes së dosjeve dhe besueshmërisë së transparencës mbi portalin; mbi 95% u shprehën të zhgënjyer dhe të fyer nga kjo mënyrë punësimi pasi kishte studentë me mesatare dhe me çdo kualifikim që rezultojnë me pikë të ulta. Pra, përzgjedhja e fituesve do bëhet siç ka ndodhur gjatë gjithë kësaj periudhe: kush ka mik më të forte ose kush paguan më shumë.



ishte pas intervistës sime në "Gazeta Shqiptare" e në datën 15 mars nuk u nxor asnjë njoftim se kur do të shpallej lista e fituesve pasi ishte thënë para që do publikoheshin po me datë 15. Kur lista u shpall, doli një numër i vogël fituesish, as gjysma e aplikantëve. Nga lista e fituesve rezultoi që ata që kishin qenë në listën e parë të shpallur para disa javësh si të përzgjedhur; në këtë listë nuk figuronin fare. Disa kandidatë që nuk u rezultojnë

emri te lista fituese po i marrin në telefon nga Ministria e Shëndetësisë duke u thënë që janë fitues, por për shkak të gabimit të sistemit nuk iu ka dalë emri", - thekson Jaçaj për "GSH". Ky i fundit shton se kishte disa fitues që edhe pse kishin aplikuar vetëm në Tiranë, u kishte dalë emri dhe në qarqe të tjera dhe tashmë nuk dinë si të veprojnë. Të zhgënjyer flasin edhe infermierët të tjerë që kanë aplikuar në portal, të cilët theksojnë se ky proces nuk është aspak transparent. "Shpallja e fituesve në bazë të dosjes që kanë dorëzuar nuk janë marrë në shqyrtim, e kjo duket qartë tek disa aplikantëve që sapa janë licencuar dhe janë vlerësuar me pikë maksimale, ndërsa disa të tjerë që kanë dhe eksperiencë punë janë vlerësuar me pak pikë, ose nuk janë përzgjedhur fare për fazën e dytë. Aplikantët nga qytete të ndryshme nuk janë përzgjedhur në qytetet përkatëse, por ministria ka bërë një lëmsh duke i çuar si fitues në qytetet e tjera", - thotë për "GSH" Ueda Ejbeja. Më tej kjo e fundit thekson se në momentin që doli lista e parë, rezultonte fituese si infermiere-mami në Fier, por te lista e dytë nuk rezultonte më fituese. "Në ministri më thanë se do njoftoheshin në telefon për datën e provimit, dhe ishte mundësia e dytë për aplikantë që nuk ishin zgjedhur, nuk e prisnin që të hiqeshin ne që na shpallën fitues dhe të vendoseshin të tjerë nga disa herë", - thotë e revoltuar infermierja për "GSH".

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 109 / 229 + 3 – 6, e Illojit 'Apartament', zona kadastrale 3292, volumni 24, faqe 166, sipërfaqe totale 110, 5 m2, në pronësi të AMARILDO NACO, me adresë: Selitë , Tiranë .

ÇMIMI 5.890.500 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 12.04.2018 .

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 7 / 392 – G8, e Illojit 'Garazhd', volumni 20, faqe 143, zona kadastrale 8370, me sipërfaqje totale 19,94 m2, në pronësi të SHOQËRISË 'IN CO' SHPK, NUIS: J62410017G, me adresë: Rruga "4 Dëshmorët", Tiranë .

ÇMIMI 2.000 EURO. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 11.04.2018 .

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURINË NR. 2/863-ND-1-43, E LLOJIT 'APARTAMENT', VOLUMI 55, FAQE 73, ZONA KADASTRALE 8513, ME SIPËRFAQJE 67.81 M2, NE ADRESËN : RRUGA "K. KËRTOVA", SHKALLA 1, KATI 7, DURRËS , NE PRONËSI TE SHITETASVE : Z. LUTFI GJYZELI DHE ZNJ. ENKELEJDA GJYZELI .

ÇMIMI 2.000.000 LEKË " Data e zhvillimit të ankandit do jetë 11.04.2018 .

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

VIP

Suplement
Pages

Emërkurë 21 Mars 2018

GAZETA SHQIPTARE

"BULEVARDI POLITIK"

- Deputeti demokrat pas ndeshjes, bën foto me Salvinin
- Lypësi e nis ditën me leximin e shtypit, kush e shkrepri foton
- E bija feston ditëlindjen, urimi prekës i deputetes socialiste
- Ndoka sulmon Ramën: Zot na ruaj nga kjo racë e keqe!

Elvana u bën thirrje të gjithëve: Falënderoj Zotin që i kam në jetë!



Sa shumë ëmbëlsi, Ami poston foton me vogëlushen Sia



Rrëfihet Disilva Muçopata: Policia është vetëm fillimi



Tërhoqi vëmendjen e të gjithëve, flet **policia seksi**: Kush nuk i pranon komplimentet?

"Gjatë një aksioni na kanë sulmuar, kemi përfunduar në spital"

Intervista

Rrëfëhet Disilva Muçopata: Policia është vetëm fillimi

Tërhoqi vëmendjen e të gjithëve, flet policja seksi: Kush nuk i pranon komplimentet?

"Gjatë një aksioni na kanë sulmuar, kemi përfunduar në spital"

Pamela Aliaj

Me rastin e 8 Marsit, kryetari i bashkisë, Erion Veliaj, prefroi që të paraqiste në faqen e tij një grup femrash, të cilat kryenin punë të ndryshme. Ndër to, ajo që tërhoqi vëmendjen dhe u bë edhe kryefjalë e mediave rozë ishte policja simpatike e Policisë Bashkiake, Disilva Muçopata. Në një intervistë ekskluzive për "Vip Pages" të "Gazeta Shqiptare", Disilva zbulon se si është të jesh pjesë e policisë, vështirësitë që has në përditshmërinë dhe paragjykimet apo edhe ngacmimet që mund të ketë duke qenë femër dhe për më tepër simpatike.

Jeni një nga policet simpatike të Tiranës, që kryebashkiaku zgjodhi të veçojë për 8 Mars. Si u ndjetë për këtë vlerësim?

Nuk e di nëse jam një nga policet simpatike që zgjodhi kryetari bashkisë. Ky është një vlerësim që duhet ta bëjnë të tjerët, nuk më takon mua ta bëj. U ndjeva e vlerësuar kur pash foton e nxjerrë nga kryetari i bashkisë.

Si është një ditë e zakonshme e Disilvës?

Një ditë e zakonshme punë fillon në orën 08:00 me marrjen e detyrave të ditës dhe daljen në terren për zgjidhjen e ankesave të qytetarëve të Tiranës, si dhe ruajtjen e hapësirës publike të këtij qyteti nga kundravajtjet administrative. Mbyllet me raportimin e detyrave të realizuara dhe përgatitjen për një ditë tjetër pune.

Ishte një dëshirë e juaja të zgjidhnit policinë apo...?

Zgjedha të konkurroj në Policinë Bashkiake për të ndihmuar në mbarëvajtjen e qytetit tim. Të kontribuoj edhe unë në ndërtimin e një



jete më të mirë në këtë qytet, që të ardhmen ta shohim këtu dhe jo me sy e mendje jashtë vendit. Duke qenë se rrjedh dhe nga një familje ushtarake, mendova se nuk do ta kisha të vështirë të përshtatesha.


Sa e vështirë është të jesh police në Shqipëri?

Për të qenë e sinqertë, nuk është e lehtë të jesh police, pasi mentaliteti i shoqërisë sonë është që polici ose ligjbatuesi duhet të jetë një mashkull, me autoritet dhe



mundësisht me pamje të egër. Por në të vërtetë nuk është kështu realiteti. Të zbatosh ligjin nuk ka nevojë të jesh një mashkull i vrazhdë, por një qytetar i sjellshëm, që thjesht bën detyrën për të cilën paguhesh nga taksapaguesit e këtij qyteti. Duke qenë se pjesa më e madhe e punës sime konsiston në terren përballim me karaktere të shumta, plus që shqiptarët karakterizohen paksa nga impulsiviteti e janë më nevririk nga natyra.

A keni pasur ngacmime nga kolegët në punë apo



Sa të vështirë e ka Disilva

Nuk është e lehtë të jesh police, pasi mentaliteti i shoqërisë sonë është që polici ose ligjbatuesi duhet të jetë një mashkull, me autoritet dhe mundësisht me pamje të egër. Por në të vërtetë nuk është kështu realiteti. Të zbatosh ligjin nuk ka nevojë të jesh një mashkull i vrazhdë, por një qytetar i sjellshëm, që thjesht bën detyrën për të cilën paguhesh nga taksapaguesit e këtij qyteti.

ndonjë incident? Si keni reaguar?

Nuk kam pasur asnjë ngacmim në punë nga kolegët, pasi i respektoj dhe më res-

kur i duhet të arrestojë një mashkull në një operacion policor?

Unë jam pjesë e Policisë Bashkiake dhe detyra funk-

cionale është kundravajtja administrative dhe jo veprat penale.

Mund të veçoni ndonjë incident që keni pasur gjatë ndonjë aksioni policor?

Aksionet e Policisë Bashkiake konsistojnë në kontrollin e hapësirave publike, në mbështetje të drejtorive të ndryshme të Bashkinë Tiranë, si dhe ruajtjen e pronës së bashkisë. Duke iu referuar kësaj të fundit, kemi pasur incidente me disa qytetarë, të cilët kundërshtojnë ndërtimin e lodrave të fëmijëve në parkun e liqenit artificial. Gjatë këtij incidenti kemi qenë në kryerjen e detyrës dhe jemi sulmuar dhunshëm, ku mund të përmend më plagosjen e disa kolegeve, të cilat morën ndihmën e parë në spitalin e traumës.

Ju zgjodhi terreni juve, apo ju terrenin?

Të them të vërtetën, më ka zgjedhur terreni mua dhe jo anasjelltas. Që ditën e parë të punës jam caktuar





NGACMIMET

Kur më bëjnë komplimente, të cilat për hir të vërtetës nuk mungojnë, më bëhet qejfi, pasi ndihem e privilegjuar dhe e vlerësuar në aspektin femëror.

tore dhe kam kryer dhe kryej detyrat e dhëna, si dhe jap detyra në varësi të problematikave. E kam kryer me sukses dhe do vazhdoj që ta kryej. Qenia femër, apo bukurorë, siç po më etiketoni, në radhë të parë më pëlqen ky etiketim, si çdo femër, nuk më ka bërë të ndjehem e paragjykuar, përkundrazi e vlerësuar dhe e vendosur në qendër të vëmendjes nga meshkuj të ndryshëm.

Ju jeni një police shumë simpatike. Cili është komenti më interesant që ju ka bërë përshtypje në punë nga kolegët? Po ndonjë i dyshuar? Si keni reaguar?

Faleminderit dhe një herë për komplimentin! Komentet e kolegëve në kuadrin e shakasë kanë qenë të shumta, si psh., "na ke zbuluar policinë bashkiake" ose "më në fund do na shohin me sy tjetër" etj.

Si e kalon kohën e lirë Disilva pasi mbaron turnin?


Mbasi mbaroj turnin, e kaloj ditën duke u marrë pak me veten time, duke bërë pak palestër ose aktivitete sportive, ndonjë kafe me shoqërinë dhe pse jo edhe ndonjë argëtim gjatë fundjavës në "club"-et e shumëllojshme të Tiranës. Me pak fjalë, si çdo femër e moshës sime, pa asnjë ngurrim.

Si reagoni kur ju ngacmojnë kur jeni veshur me uniformë? Po civile?

Kur më bëjnë komplimente, të cilat për hir të vërtetës nuk mungojnë, më bëhet qejfi, pasi ndihem e privilegjuar dhe e vlerësuar në aspektin femëror. Ngacmimet gjatë kohës kur jam në marrëdhënie pune, i kaloj me sportivitet. Në jetën civile fjalët e bukura kush nuk i pranon?


Prioritet është të vazhdoni në polici apo ky është vetëm hapi i parë?

Normal që ky është vetëm një hap. Ndihej mirë dhe e vlerësuar me punën që bëj. Prioritet për mua është shkola që kam mbaruar, ekonomiku.




në sektorin e Kontrollit të Territorit si inspektore e një njësie përkatëse, sektor i cili kryesisht merret me detyra në terren në lidhje me kundravajtjet administrative, siç ju përmenda

edhe më parë. **A keni pasur bërëlla apo paragjykimet në punë për shkak se jeni femër dhe për më tepër bukurorë?** Nuk kam pasur bërëlla në punë. Jam caktuar inspek-



Jo rrallëherë e shohim që këngëtarja e njohur, Elvana Gjata, pasi zgjedhi të rikthehej në Shqipëri, vijon të jetë në qendër të vëmendjes me postimet e saj të herëpashershme në "Instagram". Pas recitalit të saj në shkurt, me shumë të ftuar VIP dhe komente pozitive, kësaj radhe në "Instagram", ajo vendosi të ndajë me ndjekësit e saj një postim të para 5 viteve. Është një rikujtim që i bën thonë që i duan. Vërtet një dedikim prekes! "Zgjedh ta ndaj me ju këtë ndjesi timen shumë të sigurtë... Ndonjëherë rutina, problemet dhe streset e puneve ditore na bëjnë të lëmë pas dore disa nga gjërat që na shtrenjta që kemi në jetë, duke harruar që nuk jemi të përjetshëm... Ndaj kur u ktheva në shtëpi, vrapova drejt prindërve të mi dhe me lot në sy nisa t'i uth e përqafoj pa pushim, duke falënderuar Zotin që i kam në jetë... Bekime mirënjohje dhe përluje atyre që na dhane jetë!"

Elvana u bën thirrje të gjithëve: Falënderoj Zotin që i kam në jetë!



Vetëm pak ditë nga ardhja në jetë e fëmijës të dytë, të quajtur Sia, ka qenë vetë Ami që kësaj radhe ka preferuar të publikojë foton e parë me vogëlushen. Të shumta ishin urimet e bëra nga ndjekësit e saj dhe s'kishin se si të mungonin edhe urimet e VIP-ave. Ditën e djeshme në faqen e saj në "Instagram", Ami postoi foton ku duket se vogëlushja po i shtrengon me duart e saj të vogla gishtat e të ëmës. Sa shumë dashuri e mbledhur vetëm në një foto!

Sa shumë ëmbëlsi, Ami poston foton me vogëlushen Sia

BULEVARDI

QË MERRNI SERIOZISHT!



Deputeti demokrat pas ndeshjes, bën foto me Salvini

Deputeti biznesmen i PD, Agron Shehaj ndoqi në Itali ndeshjen Milan-Kievo. Para tri ditësh aty takoi edhe kreun e Lega Nord, Matteo Salvini me të cilin shkrepri edhe një foto, e cila ngjalli jo pak reagime. Fotoja e deputetit Shehaj ka marrë vëmendje të madhe në rrjetet me politikanin e njohur të së djathtës italiane, që pret të bëhet kryeministri i Italisë. "Me Salvini na bashkon pasioni për Milanin, por edhe përkatësia si forca të qendrës së djathtë", shkruan Shehaj. Ndjekësit i kujtojnë Shehaj se partia e Salviniit kur emigrantët shqiptarë kalonin Otranton, luteshe që anijet të fundoseshin. Por pavarësisht këtyre komenteve, Shehaj ka replikuar i pashqetësuar duke u thënë se nuk e ka fajin Salvini, por politikantët e korruptuar.



Lypësi e nis ditën me leximin e shtypit, kush e shkrepri foton

Pas shumë debatesh që ka hapur ndërtimi i një teatri të ri, prapa nuk kanë ngelur edhe reagimet e artistëve. Para dy ditëve u mbledhën të gjithë aktorët, të cilët kanë zgjedhur të diskutojnë se çfarë mendojnë ata për ndërtimin e teatrit të ri. Gjithsecili ka treguar qartë se kërkojnë një debat të hapur dhe publik me qeverinë, për t'u treguar se çfarë ata kanë vendosur të bëjnë me godinën aktuale dhe atë të re. Robert Ndrenika është shprehur kundër ndërtimit të teatrit me anë të Partneritetit Publik-Privat, duke theksuar se detyra i përket qeverisë për t'u përfunduar.

Ndoka sulmon Ramën: Zot na ruaj nga kjo racë e keqe!

Kreu i PDK, Nard Ndoka, akuzon kryeministrin Rama se ky i fundit sipas tij, po shantazhon bashkitë që drejtohen nga opozita. Ndërsa shton më tej se sondazhet e nxjerrin Rilindjen sërisht të humbur në Shkodër e Lezhë, ndaj kryeministri ka hartuar një strategji ogurzeze, siç e quan ai. "Qeveria braktis dhe shantazhon bashkitë që drejtohen nga opozita! Shkodra është totalisht e përmbytur nga uji. Reshjet dhe keqmenaxhimi i kaskatës së Drinit kanë krijuar një situatë tej mase emergjente! Kryeministri hesht, ministrit sulmojnë bashkinë, banorët dhe pronat e tyre, në mëshirë të fatit! Sondazhet e nxjerrin rilindjen sërisht të humbur në Shkodër e Lezhë, ndaj kryeministri ka hartuar një strategji ogurzeze: të godasë Shkodrën me indiferencë e varfëri dhe të gjunjëzohë kryetarin e Bashkisë së Lezhës me pranga dhe presion politik ndaj çdo zëri opozitar! Zot na ruaj nga kjo racë e keqe!", shkruan Ndoka.



E bija feston ditëlindjen, urimi prekës i deputetes socialiste

Vajza e deputetes socialiste Vilma Bello festoi me datën 18 mars ditëlindjen. Në ditën e saj të veçantë nuk mund të mos mungonte edhe urimi i nënës së saj. Deputetja ka zgjedhur rrjetin social "Facebook" për ta uruar publikisht të bijën. "18 mars 2001, ditë e bukur me diell, e diel, pasdreke ora 16:00... Ishte dita kur ndjeva se isha e plotësuar bukur me ty, Eni Bello. Edhe 100 e bukura ti, embëlsi, mirësi, mençuri, çmenduri e bukur! Të uroj që jeta jote të jetë e qeshur! Të uroj që të mirën që ke në shpirt, ta kesh tërë jetën, për vete dhe për të dhënë mirësi kudo dhe me këdo! Paç zemrën të gëzuar dhe sytë të qeshur! Paç sukses në tërë rrugëtimin tënd të jetës! Të dua pafund, vajza ime (që më mungon)! Je dashuria ime e pakushlet!", shkruan Bello.



BULEVARDI

QË MERRNI SERIOZISHT!

Na merrni seriozisht!



INTERVISTA

Fatmira Nikolli

Bujar Kapexhiu nuk është një prej atyre artistëve që përfshihen lehtë politikisht, as në

ide, por e as në ide kundra pushteteve, tek të cilat nuk shih ndryshim ndryshim kushedi ç'është (të paktën sipas punës së tij). Shpesh, përmes karikataturave, ai ka kritikuar me ironi të hollë aktualitetin politik prej të cilit varen politika sociale, çështje sociale (ose çështje me ndjeshmëri sociale). Por, kur vjen puna te Teatri Kombëtar, godina aktuale a një projekt për një të re, Kapexhiu del në radhë të parë. Në një intervistë për "Gazetën Shqiptare", sa i takon projektin të qeverisë, thotë se "në tezgëz qeveritare të shitjes për ne blerësit artistë, ky produkt nuk preferohet, sepse kjo godinë, me formën e saj moderne, mund të qëndrojë në çdo hapësirë të bulevardit të ri, ku priten të ndërtohen ndërtime moderne, ndërsa në sheshin ku është teatri sot, ajo stonon me konfiguracionin e saj dhe nuk lidhet me godinat e tjera që ka rreth e rrotull".

Ndalet edhe tek skicë-ideja e tij për teatrin, skicë-ide që parashikon një godinë mes dy ekzistueseve (TK dhe TKEKS), teksa thekson se fjala "shembje", në paragrafin hyrës të fjalimit të kryeministrit përpara artistëve në mjediset e Kryeministrit, i tulati pjesëmarrësit; goditja "shembje" e thërmoi gëzimin dhe e zgërlaqi entuziazmin. U shembën edhe ëndrrat tona, shton ai.

Në fund, ai u bën thirrje ndërtuesve: "Ju lutem, mos u bëni të babëzitur dhe mos na grabisni pronën tonë, pronë mbi të cilën do të ndërtohet një vepër arti, e cila do t'ju japë kënaqësi juve, familjes dhe fëmijëve tuaj!"

- Kur e keni ideuar projektin për Teatrin Kombëtar?

Fillimisht kërkoi mirëkuptimin tuaj që këtë krijimin tim modest, gjatë bisedës, të mos e quajmë projekt, por thjesht një skicë-ide. Projekt është fjalë e madhe, profesionale, që do shumë punë e shumë studim. Atëherë, në përgjigje të pyetjes suaj po them se kjo skicë-ide u nxi mbi letër pikërisht duke shoqëruar zhurmën e diskutimeve të këtyre ditëve në mjediset zyrtare e artistike, për ndërtimin e një teatri të ri dhe shembjen e teatrit të vjetër. Bukur! Më entuziazmoi ndërtimi i një teatri të ri. Më pezmatoi prishja e teatrit të vjetër. Përzjerja e këtyre ndjesive brenda meje, si dy lëngje brenda një gotë, në formimin e një kokteili, më fiksuam idenë e bashkimit të dy gjërave. E vjetra dhe e reja. Pak histori: fjalën "shembje" e kam dëgjuar për herë të parë në fillim të viteve '60, kur nisa rrugën e vështirë të shkollimit për t'u bërë aktor. Qysh në fillimet e para, si student në Institutin e Lartë për Aktor, në interpretimet në skenë, midis aktorëve të shquar të asaj kohe dhe në bisedat e lira jashtë skenës, artistët ankoheshin për kushtet mjerane dhe mungesën funksionale të këtyre mjedisit artistik, që quhej në atë kohë "Teatri Popullor". "Ah, kur do të vijë ajo ditë që të shembet kjo karaktinë që po na merr spirtin!". Kështu shpreheshin, duke shfaqur dëshirën për një shembje të kësaj karaktinës e për ndërtimin e një teatri të ri. Që nga ajo kohë janë bërë disa rikonstruksione dhe, me sa di unë, shpresat e popullit janë zhdukur e janë zëvendësuar me tulla e beton. Ja, dita e teatrit të ri erdhi. Ndiej kënaqësi kur mendoj se ëndrra e të parëve, e pedagogëve tanë dhe e jona, sot do të realizohet. Duhen falënderuar kryeministrit dhe kryetari i bashkisë, që vendosën të gëzojnë artistët me një teatër të ri, por fjala e parë "shembje", në paragrafin hyrës të fjalimit të kryeministrit përpara artistëve në mjediset e Kryeministrit, i tulati pjesëmarrësit. Goditja "shembje" e thërmoi gëzimin dhe e zgërlaqi entuziazmin. U shembën edhe ëndrrat tona.

- Zgjuani nga ëndrrat, ato u shembën. Projektin tuaj, kur lindoi?

Në furtunën e diskutimeve. Për herë të parë, për problem e teatrit mora pjesë në një debat televiziv, së bashku me tre kolegë të tjerë artistë të teatrit. Aty unë parashitrova pikëpamjen time, mbi projektin e ardhshëm sesi duhet të jetë ky teatër. Para se të shkoja në emision, kisha bërë një skicë-ide, të cilën e pashë të arsyeshme të mos e paraqisja gjatë emisionit. Mendimi im është të rikonstruktohen dy teatrot e vjetër e të bashkohen me një ndërtim të tretë, duke krijuar kështu një kompleks teatror. Godina e re

Bujar Kapexhiu:

Nuk e gëlltisim me pahir! Projekti i qeverisë për teatrin stonon, ju rrëfej skicë-idenë time

Artisti: Nuk mund të na tregojnë tenxheren e të thonë do ju pëlqejë gatimi



Në foto: Projekti i Bujar Kapexhiu



Në foto: Bujar Kapexhiu

shtesë që do të bashkojë dy të vjetrat nuk do të ketë sallë shfaqjesh, sepse tashmë në teatrot ekzistues janë funksionale 3 sallat të tilla. Në këtë godinë shtesë duhet të shtohen ato mjedise që nuk funksionojnë si duhet në teatrot e vjetër dhe të tjera që nuk ekzistojnë fare. Të domosdoshme për një funksionim sa më të mirë të artit skenik. Si për shembull, zyra, dy-tri sallat që në procesin teatror quhen "provat në tavolinë", ku bëhet zbrëthimi dhe interpretimi fillëstar i pjesës, sallat e provave, për vendosjen e dramaturgjisë në lëvizje para se të dalë në skenë, biblioteka, zyra e arkivit, garderobera për ruajtjen e fondit të veshjeve teatrorë etj., etj. Pse jo edhe një bar-kafe ku të çlodhen artistët. Mbas emisionit, miku im pjesëmarrës në debat, regjisor i njohur Kastriot Cipi, një nga zërat e fuqishëm në mbrojtjen e teatrit, më tregoi në celular një projekt të një arkitektheje të re, që kishte krijuar një godinë teatri sipas kërkesës së pedagogut të saj. Dy godinat e vjetra dhe një godinë e tretë në mes, që lidh dy godinat ekzistuese. Shumë bukur! U entuziazmova. Qe e konkretizuar figurativisht pikërisht ideja ime që sapo e kisha shprehur para dy minutash në emision. Botoje menjëherë, i thashë Kastriotit, por ai nuk pranoi, duke u justifikuar se nuk ka autorizimin e autores. Mëkati! Unë, pak më parë, në emision, duke ditur skicën time i bëra thirrje kryeministrit si piktor, që të hedhë edhe ai disa viza brenda kësaj ideje dhe më tej kërkova pjesëmarrjen në këtë krijimtarë të piktorit, skenografit dhe arkitektit Bashkim Zahaj, që të vizatonte një skicë pikërisht me këtë përmbajtje, dy të vjetrat e rikonstruktuar dhe të lidhura me një të re. Në këtë mënyrë, pa dashje, krejt rastësisht, kisha dhënë sinjalin e fillimit të një konkursi.

- Duket godinë neoklasike. Synonit që kjo t'i ngjante në stil godinave ekzistuese përthe teatrit, si ato të ministrive?

Krijimtaria ime që momentale, e shpejtë, skicë-ide, pa pasur qëllimin dhe detyrimisht pretendimin se po projektoj një kompleks me të dhëna të sakta arkitekturore. Jo! Vetëm një impresion figurativ i fasadave të bashkuara. Sesi do të jenë ato, më bukur e më saktë këtë e dinë arkitektët e konstrukturët, që do të marrin pjesë në konkurs (nëse do të bëhet). Unë shfrytëzoja konfiguracionin ballor të godinës ekzistuese me linjat vertikale, volumnet dhe hapësirat në raportet ekzistuese. Dhe shtova në godinën e re disa elemente, si dyert, dritaret e godinave të vjetra. Kjo nuk do të thotë që godina e re të ruajë elementet dhe stilin e godinave të vjetra. Sot gjuha e arkitekturës moderne mund të kërkojë një fasadë krejt të re, fjala vjen, moderne, prej xhami, që të kujton hyrjen në Muzeun e Luvrin. Një piramidë e qelqtë në mes të oborrit, rrethuar me fasadat ornamentale të ndërtesave klasike.

- Çfarë thonë artistët për të?

E kanë parë miq të mi artistë e arkitektë dhe të tjerë dashamirës të teatrit, të profesioneve të ndryshme. E kanë pëlqyer. Kanë bërë vërejtje. Të tjerë kanë sugjeruar llojllojmendimesh, por ajo që

të shumë i suksesshëm dhe i pëlqyeshëm. Fillojmë nga embrioni i shoqërisë. Familja: burrë, grua, fëmijë. Tjetër: malësorët tanë, me mençurinë e tyre, stolat për t'u ulur, që i quajnë shkamb, i kanë bërë me tri këmbë. Se vetëm me tre është qëndrueshmëria më e madhe. Rastësia e sjell që edhe ky kompleks teatror të përbëhet nga tri godina. Dy të vjetra dhe në mes një e re. Numri tre na ndihmon edhe në sigurimin e fondeve. Shteti, biznesi, shqiptarët. Të gjithë së bashku, me kontributin e tyre, me siguri do të realizojnë ndërtimin e këtij kompleksi teatror.

- Sa hapësirë zë Teatri, sipas projektit tuaj?

Edhe një herë, ju lutem, mos e quani projekt, por një skicë-ide. Po të që projekt, atëherë unë mund t'ju përgjigjem me saktësi sesa hapësirë do të zërë ky teatër. Hapësirën do e përcaktojnë projektuesit e urbanistët me projektin e tyre të përfunduar, ku përmblen të gjitha kërkesat e mjediseve funksionale për artin skenik, që do të marrë patjetër edhe pëlqimin e miratimin e artistëve të Teatrit, të cilët do të zhvillojnë aktivitetin e tyre në këto mjedise, sa më komodë e sa më moderne. Përsa i takon hapësirën, në qoftë se nga prona e Teatrit të përfunduar do të teprojnë disa metra, me siguri artistët me shpirtin e tyre fisnik, këtë hapësirë do t'ia dhurojnë biznesit që të plotësojë projektin e tij, që padyshim do të jetë në shërbim dhe interes të qytetarëve. Gjej rastin t'u bëj thirrje ndërtuesve: Ju lutem, mos u bëni të babëzitur dhe mos na grabisni pronën tonë, pronë mbi të cilën do të ndërtohet një vepër arti, e cila do t'ju japë kënaqësi juve, familjes dhe fëmijëve tuaj!

- Si ju duket projekti i qeverisë?

Projekti i paraqitur nga arkitekti danez, si ide, si fantazi, si një kontakt vizual me të, është interesant e të bën përshtypje. Forma e përgjithshme, në zgjatimin e saj është e gjetur bukur, si një papion ku kombinohen saktë volumnet dhe hapësirat. Një projekt që mund ta blejë çdo qeveri në botë që ka në planin e saj për të ndërtuar një teatër. Këtu tek ne, në tezgëz qeveritare të shitjes për ne blerësit artistë, ky produkt nuk preferohet, sepse kjo godinë, me formën e saj moderne, mund të qëndrojë në çdo hapësirë të bulevardit të ri, ku priten të ndërtohen ndërtime moderne, ndërsa në sheshin ku është teatri sot, ajo stonon me konfiguracionin e saj dhe nuk lidhet me godinat e tjera që ka rreth e rrotull, Galerinë e Arteve, Ministrinë e Brendshme, godinën e KLSH-së, bashkinë, hotel "Dajtin" etj. Kjo më mirë do të përforcohej nga opinionet profesionale të arkitektëve e urbanistëve. Paraqitja përpara artistëve e këtij projekti, vetëm nga ana e jashtme, e padetajuar nga ana e brendshme funksionale, bën që të heshtësh e të dyshosh për vlerën e tij funksionale. Është një lloj sikur të duash të joshësh dikë duke i thënë se sot do të të kënaq me gatimin tim, duke i treguar vetëm tenxheren me kapak të mbyllur dhe jo atë që është gatuar. Servire në pjatë, vendose mbi tavolinë, me të gjithë aksesoret e ngjërës dhe, pasi klienti ta këtë parë e ta këtë shijuar, atëherë merr guximin e pyete: a ju pëlqeu? Kur klienti thotë 'po, ju lumshin duart!', atëherë të takon ty të thuash 'ju bëftë mirë!'. Në të kundërt, je i dëshuar kur dikujt i jep dikë që nuk i pëlqen e ta gëlltisë me pahir. Prandaj në kuzhinën e qeverisë le të përfundojë një gatim me të gjithë ingredientët, që t'u shijojë ju vetëm artistëve, por edhe qytetarëve që frekuentojnë gatimet e kësaj kuzhine.

më intereson dhe më pëlqen nga mendimet e tyre është se të gjithë, pa përjashtim, mbështesin të njëjtin parim. Të ruhet teatri i vjetër dhe midis tyre të ndërtohet një godinë e re. Edhe mendimi qytetar është i rëndësishëm, se janë ata që frekuentojnë spektaklet e teatrit. Për t'u konsultuar me qytetarët, këtë skicë-ide e vendosa në "Facebook"-un tim, ashtu siç bëj çdo ditë që vendos karikaturat e mia për të marrë mendimet e qytetarëve. U kënaqa. Gjer tani e kanë parë 17 000 shikues, kanë dhënë pëlqimin e tyre rreth 700 vetë dhe nuk mungojnë me komentet e gjata rreth 80 vetë, profesionistë e specialistë të ndryshëm. Ju lutem edhe një herë, një sqarim, kjo skicë që kam bërë e që është botuar në disa gazeta është thjesht një ide, duke mos pretenduar që ky të jetë një projekt i saktë dhe i përshatshëm për Teatrin Kombëtar. Jo! Unë nuk jam arkitekt. Por si një profesionist i artit, si shumë e shumë të tjerë dhashë vetëm idenë që e kanë edhe të tjerë, që godinat e vjetra të ruhen e të bashkohen me një ndërtim shtesë. Është konkursi i arkitektëve profesionistë, kombëtarë e ndërkombëtarë, që do të vendosë për projektin fitues. Por më parë nga ky konkurs dhe nga ky angazhim i arkitektëve e konstrukturëve, duhet të konfirmohet dikë tjetër më thelbësore, më e rëndësishme dhe jetike për teatrin e së ardhmes, mendimi dhe vendimi i qeverisë që godinat të mos prishen (inshallah!).

- Sa mendoni se do të kushtojë? A mendoni se do të bëhet me para të mblidhura nga shqiptarët?

Të pamundur e kam ta përcaktoj. Unë nuk jam arkitekt e as urbanist e as kam kërkuar ndihmën e ndonjë financieri. Siç e theksova edhe më parë, unë kam krijuar thjesht një skicë-ide, të cilën mund ta bëjë çdo njeri që i kërkohet mendimi sesi dëshiron ai të jetë teatri i ri. Të shembet, do të ruhet? Për sa i takon vlerën, unë si artist them le të kushtojë sa të dojë, vetëm të ndërtohet ky kompleks teatror: Ju pyesni sesi do të gjenden paratë. Për të dhënë përgjigjen për këtë pyetje, fillimisht dua të theksoj dikë. Numri tre është numër i shenjtë, numër i artë, kombinimi i gjërave kudo në fusha të ndryshme, përdorimi i shifrës tre është

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 4900 përfituesit

ATP: Dosjet e vitit 1996, pronarët që kompensohen

Ish-pronarët, aplikimet e ezauruara

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 4900 pronarë, të cilëve u është njohur drejta për kompensim. Dosjet i përkasin vitit 1996. Lista me vlerësimin përfundimtar për subjekte është botuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Trajtimit të Pronave. Lista përmban të dhëna lidhur me numrin e vendimit, gjeneralitetet e subjekteve të shpronësuar, sipërfaqja e njohur për kompensim, mangësitë në dokumentacion apo vlerësimin përkatës jepen të detajuara në regjistrin që shqëron këtë njoftim. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit si dhe vlerësimin financiar për çdo dosje.

KOMPENSIMI FINANCIAR

Bazuar në skemën që po ndjek qeveria në zbatim të ligjit të ri për pronat, prioritet do të ketë prona truall, përkundër tokave bujqësore, që do të jepen për kompensim fizik. Pas shqyrtimit të

kërkesave, kompensimi financiar bëhet vetëm për ato subjekte, vendimi i të cilëve është përfundimtar, i ekzekutueshëm ose për kërkesat që nuk janë trajtuar asnjëherë për kompensim. Të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuar financiarisht si tokë truall, do të përfitojnë kompensim financiar nga fondi i kompensimit, deri në masën 50 milionë lekë. Ndërkohë, pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar do të kompensohet fizikisht nga fondi i tokës. Në rastet kur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar rezultojnë se pjesa e mbetur është deri në 5 për qind me



e madhe se vlera 50 milionë lekë, atëherë subjekti kompensohet për të gjithë vlerën, në rastet kur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar rezultojnë se pjesa e

mbetur është më e madhe se 5 për qind mbi vlerën 50 milionë lekë, atëherë subjekti për diferencën mbi 50 milionë lekë, kompensohet fizikisht, nga fondi i tokës.

KOMPENSIMI FIZIK

Agjencia e Pronës ka në zotërim 23 mijë hektarë tokë bujqësore, për të cilat ka përfunduar më herët edhe vlerësimi ekonomik, të cilat do të përdoren për skemën e kompensimit fizik. Për ndarjen e kësaj sipërfaqjeje, dy do të jenë kriteret bazë. Kriteri i parë është rendi kronologjik i vendimeve, që do të thotë se, sikurse kompensimi financiar, edhe ky kompensim do të fillojë me vendimet më të vjetra në kohë. Kriteri i dytë lidhet me vendndodhjen e pronës që do të përfitojnë si kompensim fizik. Pra, pronari do të kompensohet me një pronë nga fondi

fizik, e cila gjeografikisht është më afër me pronën që i është njohur për kompensim. Në lidhje me dokumentet që duhet të depozitohen, ato nuk ndryshojnë, por mbeten të njëjta, si në rastin e kompensimit financiar. Ndryshon vetëm formulari i aplikimit, i cili është specifik për secilin rast. Në total janë 26 mijë vendime të formës së prerë, të cilat presin të kompensohen. Bazuar në ligjin e ri, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka nisur një proces të ri rivlerësimi, ku një metër katror tokë do të llogaritet me çmimet e tregut, por zëri ka dastral nuk do të jetë ky i sotmi, por ai që ka pasur prona në çastin e shpronësimit.

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	Mbiemri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
-------	-------------------------	--------	----------------------------	-----------

(Vijon nga numri i djeshëm)

Fier	Rraze Kumani			7,864,707
Fier	Xhelal Keri			7,825,965
Fier	Kovac Hasa			5,113,997
Fier	Sokrat Samarchiu			
Fier	Napolon Glina			
Fier	Piro Xhelili			3,641,786
Fier	Sybejde Sanshaktari			7,748,480
Fier	Egerem Malaj			
Fier				8,569,819
Fier	Laze Shpata			720,609
Fier	Sefer Metaj			8,600,813
Fier	Xhemili Baho			7,980,934
Fier	Njazi Luzati			7,787,222
Fier	Krauna Beca			8,345,113
Shkodër	Barbara Serreqi			
Shkodër	Jonuz Rroji			-
Tiranë	Mehmet Saraci			1,118,660
Tiranë	NUH HOTI			2,220,750
Tiranë	TRASHEGIMTARET E ISMAIL ELEZI EL			1,626,200
Tiranë	TRASHGIMTARET TRASHGIMTARET			1,496,950
Tiranë				65,800
Tiranë	MIHANE KETA			1,200,803
Tiranë	SAMI MUCA			651,420
Elbasan	RAMIZ MOLLAJ			1,692,268
Tiranë	Genc Pajuni			
Fier				120,101
Fier	Hekuran Maneku			2,324,544
Fier	Sefedin Shpata			1,162,272
Berat	Daut Nishani			
Vlorë	Miti Naudi			859,656
Korçë	Ismail Shahinasi			1,801,307
Berat	Gori Druga			-
Gjirokastër	Nefo Ibrahim			
Gjirokastër	Harikli Kaci			EZAURUAR
Tiranë	MUSTAFA DOLLIA			-

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	Mbiemri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
-------	-------------------------	--------	----------------------------	-----------

Tiranë	MEREME KOTORRI			619,600
Tiranë	SHPRESA, GEZIM PASHALLIU			766,755
Durrës	Sherife Sesei			
Tiranë	GJUZI			
Tiranë	GJUZI			EZAURUAR
Durrës	Ruzhdi Muharrem Tepshi			
Tiranë				
Durrës	Hysen Çegi			
Durrës	Sali Miça			
Tiranë	MUHARREM VRAPI			9,208,238
Tiranë	FLUTURA, TEUTA QYRA			7,902,342
Tiranë	ZENEL HYSKAJ			20,583,025
Durrës	Ahmet Miça			302,000
Berat	Luto Shkurti			
Korçë	Robert Venetiku			
Korçë	Pandi Allabashi			1,407,922
Korçë	Mihallaq Bellovoda			EZAURUAR
Korçë	Adriatik Molla			EZAURUAR
Korçë	Engjell Bushi			
Kukës	Avdyll Gjoni			
Kukës	Hysen Metallaj			
Shkodër	File Sokrat Nako			810,039
Tiranë	PETRIT RADOVICKA			
Durrës	Vath Kokomani			
Durrës	Bardhyl Kokomani			
Durrës	Hiqmet Agolli			
Durrës	Ymer Shala			
Durrës	Eleni Trungu			
Durrës	Ymer Hydi			
Durrës	Kimete Vogli			4,692,975
Durrës	Eleonora Tunj			
Durrës	Hajdar Bera			
Durrës	Simon Çepeli			7,734,400
Durrës	Xhovalin Dabertaku			
Durrës	Demir Abazi			
Durrës	Shpend Taga			

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	Mbiemri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
-------	-------------------------	--------	----------------------------	-----------

Fier	Haredin Malaj			1,846,379
Fier	Baki Rakipaj			
Fier	Kujtim Halimaj			1,237,897
Fier	Elmas Shehaj			
Fier	Hair Shehu			7,665,411
Shkodër	Mrika Gjinaj			24,900
Shkodër	Mark Preng Gjini			
Shkodër	Riza Sadri Bala			
Shkodër	Mehmet Beqir Arifaj			
Shkodër	Drane Mjeka			
Shkodër	Trash. Toplana			-
Tiranë	SULEJMAN TUSHA			200,907
Tiranë	BADRI HALEBI			10,715,040
Tiranë	NEXHAT GJUZI			10,045,350
Tiranë				
Elbasan	GAFUR DALIP DOSKU			341,778
Elbasan	IDRIZ HOXHA			3,856,906
Gjirokastër	Emion Caci			
Gjirokastër	Thanas Thanasi			715,156
Gjirokastër	Hiqmet Meco			453,754
Gjirokastër	Qemal Meco			2,345,906
Korçë	Stavri Stefa			EZAURUAR
Tiranë	RASIM NELAJ			3,513,874
Berat	Gene Sinjori			
Durrës	Leonard Topi			5,554,950
Berat	Muhamet Nalibani			EZAURUAR
Elbasan	BEQIR YMER ASHIKU			10,849,400
Elbasan	NDRICIM PLANGARICA			-
Korçë	Refat Agolli			
Korçë	Ei'hem Aliku			200,000
Korçë	Rajmond Xhafa			300,000
Korçë	Demirali Kupe			49,000
Korçë	Pëllumb Skëndo			
Korçë	Nebi Sulejmani			181,400
Korçë	Adem Sulejmani			
Korçë	Enver Braçe			111,078
Korçë	Enver Braçe			
Korçë	Ali Shkëmbi			EZAURUAR

Korçë	SANDRI MILE		495,680
Kukës	Ibrahim Jeminaj		
Kukës	Haxhi Aslani		
Kukës	Ramadan Lusha		
Kukës	Zhuje Ali Metaliaj		
Kukës	Bajram Metaliaj		
Kukës	Feta Sakajani		
Kukës	Isuf Mus Muca		
Shkodër	Lutfi Sokoli		14,863,168
Tiranë	ALI QORALIU		-
Korçë	Themistokli Marko		
Dibër	Kapllan Keçi		
Korçë	Shefki Gora		34,400
Korçë			
Dibër	ISLAM NDREU		
Dibër	FRROK PRENG TOSKU		
Dibër	ADEM BIBA		
Dibër	PETRIT BIBA		
Dibër	ELEZ NDREU		
Dibër	Zenel Spahiu		
Dibër	SALI BUSHI		
Lezhë	Mark Ndrej Gjoka		
Vlorë	Fadil Rumani		387,200
Vlorë	Vasil Shameti	EZAURUAR	
Vlorë	Thanas Fotini	EZAURUAR	
Dibër	Shaqir Palamani		
Vlorë	Shaqire Shero		9,000
Vlorë	Vangjel Nino		
Elbasan	Hajrie Riza Shengjergji		702,020
Elbasan	LUFTI BRAHIMI		7,785,266
Elbasan	SHEQERE DERMYSHI		-
Elbasan	NEVRUS RIKA		1,211,887
Elbasan	AGIM KALA		
Elbasan	IBRAHIM MEMA		
Elbasan	SELAJDIR FACIA		1,201,680
Elbasan	HAXHI FACE		713,808
Elbasan	BAJRAM HIDRI		
Gjirokastrë	Hekuran Bleta		596,996
Korçë	Hajredin Musa		
Korçë	Aferdita Koçbelli		
Lezhë	Nikolin Vlasi		
Lezhë	Ndue Gjin Ndoka		
Elbasan	ALI ZENEJA		3,264,482
Shkodër	Ruzhdi Duli		
Shkodër	Hasije Dibra		2,468,190
Tiranë	JONUS HOXHA		-
Tiranë	AGIM KOKONOZI		
Tiranë	BESIM ZANA		10,278,108
Tiranë	XHEVDET KUMBARCE		16,742,250
Tiranë	ISMAIL AGALLIU		19,688,886
Fier			9,489,248
Gjirokastrë	Mevlan Lico Serjani		331,921
Gjirokastrë	Myftar Haxhia		172,107
Korçë	Idriz Isaku		47,190
Kukës	Hamit Bajraktari		210,970
Kukës	Qamil Nerguti		554,058
Kukës	Enver Taci		550,028
Kukës	Rasim Isuf Pashku		11,872
Kukës	Kujtim Duraku		-
Shkodër	Beqir Lac Laca		
Tiranë	CLIRIMTAR KAZAZI		11,103,915
Tiranë	VASIL FINDIKU		1,875,132
Tiranë	HYSEN QATIPI		
Tiranë	BESIM MUZHAI		3,750,264
Tiranë	JORGJI TERCA		24,108,840
Durrës	Skënder Hoxha		-
Durrës	Mereme Tivari		
Durrës	Irfan Brinja		
Durrës	Stefan Lipja		
Durrës	Mihal Kisi		
Durrës	Alma Kraja		
Durrës	Eugen Korreta		3,329,028
Korçë	Muazes Kadilli, Radije Kadilli		624,582
Durrës	Vangjel Anastasiadhi		5,497,485

Shkodër	Ramadan Kukaj		
Durrës	Kostandina Doniska		
Durrës	Gazmend Kodra		
Elbasan	KAMBER TAFANI		17,760
Elbasan	HYSEN KOTHERJA		EZAURUAR
Elbasan	RITVAN KANA		EZAURUAR
Elbasan	MAHMUT STAMBOLLXHIU		1,708,250
Kukës	Hysen Kastrati		
Kukës	Sejdi Kastrati		
Elbasan	PETRIT GORDURI		2,305,350
Fier	Shahin Majaci		3,965,600
Fier	Llambi Bare		1,076,562
Fier			
Fier	Mina Bare		3,489,728
Fier	Artur Bare		
Fier			6,424,272
Fier	Qani Sulejmani		8,581,558
Fier	Hedije Baxhia		9,676,064
Fier	Etëm Arapaj		9,213,576
Fier	Lili Xhako		4,441,472
Gjirokastrë	Shyqyri Xhaferaj		625,697
Kukës	Kadri Koka		
Kukës	Zenel Koka		
Kukës	Gezim Metaliaj		
Kukës	Selman Metaliaj		
Kukës	Besim Metaliaj		
Shkodër	Osman Mehmeti		
Shkodër	Berhan Cuciqi		
Shkodër	Belkize Shehi		-
Shkodër	Bajram Cuciqi		EZAURUAR
Shkodër	Qamil Bushati		63,131,795
Tiranë	JORGJI ADHAMI		7,969,311
Vlorë	Spiro Bituni		
Fier	Trifon Gjoni		-
Fier	Seri Resuli		7,982,753
Kukës	Hazir Meshi		
Tiranë	SHERIF BICI		6,295,086
Gjirokastrë	Agron Vishe		
Gjirokastrë	Ollha Tako		428,285
Gjirokastrë	Zaho Maliq Bushi		526,770
Gjirokastrë	Jonuz Dervishaj		4,385,920
Shkodër	Trash. Hajdari, Dibra dhe Halluni		-
Tiranë	MUHAMET KUCI		-
Tiranë	RUSHDI HUQI		11,692,800
Tiranë	ASTRIT NURISHMI		3,817,233
Elbasan	BEQIR YMER HOXHA		
Elbasan	HALIL SYRYKU		1,011,476
Dibër	Shefqet Daçi		
Dibër	NAZIMETE ET-HEMI		
Korçë	Jani Mio		
Korçë	Kristaq Korumi		
Korçë	Fiqeri Leka		400,000
Kukës	Elez Thaci		
Kukës	Baftjar Kastrati		
Kukës	Sali Dinaj		
Kukës	Shpend Meshi		
Kukës	Begishe Metaliaj		
Kukës	Ali Ceka		
Kukës	Kadri Metaliaj		
Kukës	Ramadan Metaliaj		
Kukës	Mashun Metaliaj		
Kukës	Aslan Metaliaj		
Kukës	Avdyll Morina		
Kukës	Mehmet Dema		
Vlorë	Kosta Papa		10,780
Korçë	Spanja Pipa		
Vlorë	Ndriçim Xhelili		237,600
Vlorë	Agja Ruçi		523,710
Dibër	YLLI MEHJA		
Korçë	Mendor Kolami		EZAURUAR
Shkodër	Gazmend Llazani		
Shkodër	Izedin Domnori		
Shkodër	Sherafete Gusha		

Shkodër	Adnan Basha		3,676,752
Berat	Rexhep Kapxhiu		
Berat	Qani Brami		2,980,545
Berat	Skënder Meçe		491,635
Berat	Petrit Korbi		
Berat			5,551,840
Dibër	IBRAHIM BASHA		
Dibër	DILAVER BAJRAM BASHA		
Dibër	FIQIRI DESTAN KURTI		17,821
Dibër	QEMAL MIFTARI		10,038
Korçë	Hamdije Hyska		
Kukës	Arif Thaci		
Durrës	Dervish Arapi		EZAURUAR
Tiranë	SALI KORA (KORRA) KORA (KORRA)		514,430
Tiranë	FIQIRI KARAPICI		40,181,400
Tiranë	SEJFULLA KARAPICI		43,328,943
Tiranë	VAJE LINXA		10,827,272
Tiranë	Mehmet Karapici		23,305,212
Tiranë	IDRIZ BLAKÇORI (BLAKSORI)		EZAURUAR
Durrës	Selami Kapedani		
Durrës	Kristaq Manabeu		
Durrës	Emerjeta Çullhaj		
Korçë	Thanas Shano, Vasil Shano		97,598
Berat	Perparim Zyla		
Elbasan	ISMETE MUSMUCA		
Elbasan	TASIM DUSHKU		204,224
Elbasan	YMER MUSTA		1,309,800
Gjirokastrë	Yzeir Gjoni		4,583,178
Korçë	Jorgjia Thimo		25,350
Korçë	Petro Isak		
Korçë	Bardhyl Panolli		39,780
Korçë	Ajet Sallanji		
Korçë	Koço Shule		
Korçë	Nazmi Hasani		
Korçë	Xhafer Pashollari		
Korçë	Pelivan Bejko		448,800
Korçë	Ali Kulla		
Korçë	Sotirraq Foto		
Shkodër	Xhemal Urci		EZAURUAR
Tiranë	MYSLYM BEKA		EZAURUAR
Fier	Tajdar Sulaj		237,936
Fier	Avni Kalkanji		
Fier	Ismail Klosi		EZAURUAR
Fier	Qemal Klosi		EZAURUAR
Gjirokastrë	Petraq Nako		
Fier	Aslan Elmazi		
Fier	Habib Pashaj		
Fier	Tajdar Shehu		7,138,080
Fier	Haki Taullai		1,982,800
Shkodër	Sulejman Halli		3,972,475
Shkodër	Muharrem Vuçi		
Tiranë	FITNETE MUSA LLESHI		
Fier	Sulo Resulaj		
Elbasan	HAZIZ ZOGOLLI		
Elbasan	IBRAHIM MEMA		713,808
Dibër	YMER GJETA		
Korçë	Emil Shuke		346,203
Korçë			923,208
Kukës	Avdi Meshi		
Kukës	Selim Quni		
Kukës	Gani Begu		
Kukës	Selman Musa		
Kukës	Hume Sylja		1,199,167
Kukës	Skender Kumanova		810,068
Kukës	Hajdar Shuti		
Kukës	Isuf Morina		
Dibër	XHEMAL DISHUKA		
Dibër	LIFE TAKA		
Shkodër	Bernardina Kodra		1,191,540
Shkodër	Adnan Bushati		
Shkodër	Shefik Shami		153,198
Shkodër	Servet Llukaci		7,346,023
Shkodër	Myzafer Drishiti		
Tiranë	XHEVDET Tafa		3,062,759

(Vijon nesër)

Opinion **i** Ditës

Nga Miron Çako*

(Vijon nga faqja e parë)

... përdorur dhe sakrificuar të tjerët.

Lakmia e bën të pasurin të pangopur; ai i shton pasurisë pasuri edhe kjo bëhet shpesh në kurriz të të varfrit. Lakmia e bën shtetarin të papërgjegjshëm, gënjeshtar; vjedhës të arkës së shtetit që i është besuar atij me votat e popullit për një menaxhim të ndershëm. Lakmia e bën ruajtësin e rendit, prokurorin apo avokatit të marrë rryshfete dhe bashkëpunëtor me kriminelët e krimin dhe për para, ata e bëjnë të zezën të bardhë dhe të bardhën të zezë e për të dalë "të drejtë" para ligjit, dënojnë të pafajshmin edhe lirojnë fajtorin. Lakmia e transformon mjekun në antihuman, duke i shërbyer vetëm pacientit që paguan, kurse për të tjerët nuk kujdeset apo i lë të vdesin se nuk kanë të paguajnë.

Lakmia e bën bankierin hileqar; i cili me anë të hileve në skema ekonomike, mashtron klientët dhe duke nxjerrë për vete para nga hiçi, i fut debitorët në një rreth vicioz detyrimesh sa, kur nuk mund të paguajnë kredinë, u konfiskon shtëpinë, pronën edhe i nxjerr në rrugë të madhe. Lakmia e bën tregtarin mashtrues që vjedh në peshore edhe shet mall të skaduar si për të mirë dhe me çmim të lartë. Lakmia e bën fermerin të pandjeshëm dhe ai për të kapur fitimin më të lartë, përdor pesticidë, helme, hormone dhe çdo palogjës, që prodhimi të rritet artificialisht, pavarësisht se sa kjo e dëmton shëndetin e konsumatorit, e shtyn bujkun që të mos mbjellë në arë grurë, por hashash, pa u interesuar se droga shkatërron familje dhe merr jetë njerëzish. Lakmia e bën sipërmarrësin të pashpirt, të rrisë fitimet duke ulur pagën e punëtorit në minimumin jetik ose nuk ia jep fare me pretextin "nuk kam".

Lakmia për para e kthen burrin në kumarrxhi, gruan në prostitutë, madje edhe vëllezërit dhe miqtë i përçan etj., etj. Lakmia prish çdo bashkëjetesë paqësore edhe është shkak i krimeve më të shëmtuara dhe i luftërave më të përgjakshme midis njerëzve, kombeve me shumë viktima të pafajshme vetëm që disa të shtojnë pasuritë e tyre, ashtu si lexojmë në letërnë e Jakovit: "Nga vijnë luftërat dhe grindjet te ju? A nuk vijnë nga pasionet që luftojnë ndër gjymtyrë tua? Ju lakmoni dhe nuk keni; ju vrisni dhe keni smirë dhe nuk fitoni gjë; ju ziheni dhe luftoni, por nuk keni sepse nuk kërkoni. Ju kërkoni dhe nuk merrni, sepse kërkoni keqas që të shpenzoni për kënaqësitë tuaja" (Jakovi 4:1-3).

Lakmia është bijë e egoizmit. Rrënjë e termi egoizëm është fjala greke (ego), që do të thotë unë. Egoizmi ka të bëjë me një sërë qëndrimesh dhe sjelljesh që kanë si synim të vetëm ndjekjen e interesit të subjektit që është autor i këtyre veprimeve, pra egoist mendon vetëm për vete edhe gjithmonë nuk i mjaftojnë gjërat që zotëron, por lakmon gjithnjë e më shumë. Në Bibël flitet shumë për mëkatin e lakmisë, sepse ai është mëkati i parë. Njeriu nuk është mëkatar sepse gabon, por ai gabon se është mëkatar sepse "në mëkatin më lind nëna ime" (Psalmi 50) dhe këtu flitet për mëkatin stërgjyshor ose mëkatin fillestar të Adamit dhe të Evës, të cilët u mashtruan nga djalli dhe lakmuuan frutën e ndaluar, "por mos ha nga pema e njohjes të së mirës dhe të së keqes, sepse ditën që do të hash prej saj ke për të vdekur me siguri" (Zan. 2:17). "Dhe gruaja pa që pema ishte e mirë për t'u ngrënë, e këndshme për sytë dhe e dëshirueshme për ta bërë të zgjar dikë dhe ajo mori nga fruta e saj, e hëngri dhe i dha edhe burrit të saj që ishte me të dhe hëngri edhe ai" (Zanafilla 3: 6-7)".

Kështu, lakmia si mëkati i trashëguar tek të gjithë njerëzit, është një virus që e sëmur dhe e transformon qenien njerëzore nga një qenie shoqërore në një përbindësh, egoist dhe të pamëshirshëm, sa ai tradhton, shfrytëzon edhe vret jo vetëm të afërmit, por arrin deri

atje sa mohon edhe vetë Zotin, Krijuesin e tij. Njerëzit që kanë para hapin portofolin e tyre, i cili është plot edhe thonë: "Ky është zoti im". Njeriu të krijuar sipas ikonës të Perëndisë si qenie intelektuale me shpirt të arsyeshëm si mbret i krijesës me kryet lartë për një komunikim me Zotin Gjithëpushtetshëm lakmia e turpëron, sepse njeriu lakmiqar shtazohet, këthet si një kafshë pa arsye, që mendon dhe kënaqet vetëm instinktet mishore, me gjërat e tokës, nuk do të dijë për ato të shpirtërore edhe nuk e ngrë kokën lart drejt qiellit, ku është i fronëzuar Perëndia si burim i çdo të mire. Dikush ka thënë: "Se lakmiqari i ngjan derrat të egër në pyll, që ha lëndet në tokë, por asnjëherë nuk e ngrë kokën lartë të shikojë nga ku bien këto lende".

Të pasurit lakmiqarë zakonisht nuk besojnë se ka një Zot përmbi ata, janë ateistë arrogantë, ose indiferentë për gjërat shpirtërore. Prandaj edhe Zoti Jisu Krisht thotë tek ata që kanë veshë për të dëgjuar: "Sa e është vështirë për ata që kanë pasuri të hyjnë në mbretërinë e Perëndisë. Sepse është më lehtë deveja të hyjë në vrimën e gjilpërës, sesa i pasuri në mbretërinë e Perëndisë" (Luka 18:24-25).

Vetë jeta, me përvojat e saj të hidhura do t'ia mësojë faktin e hidhur dhe tragjik lakmiarit se "zoti" që ai shpresoi se do ta bënte të lumtur, doli në fund një "zot" i rremë ose mamona (demon i parasë), i cili mund t'i marrë edhe jetën. Shembull unikal i këtij fundi tragjik është Juda Iskarioti, i cili nga lakmia për para, tradhtoi Zotin Krisht, por në fund vari veten: "Ai pra, fitoi një arë me shpërblimin e paudhësisë dhe duke rënë kokëposhtë, plasi në mes dhe të gjitha të brendshmet e tij u derdhën" (Veprat 1:18).

Duke pasur parasysh të gjitha këto të këqija të lakmisë së bashku me viktimat, Pavli, apostulli i Krishtit, thotë: "Sepse lakmia për para është rrënjë e të gjitha të këqijave dhe duke e lakmuar atë fort, disa u larguan nga besimi dhe e depërtuan veten e tyre në shumë dhimbje" (Timotheut 6:10).

Por, duhet të theksojmë në njeriu që ka lakmi nuk është kurrë i lumtur dhe i përbushur, sepse paraja është një "zot" i rremë, që kërkon gjithnjë e më shumë energji mendore e fizike, sakrificat me parimin "qëllimi justifikon mjetin", por gjithmonë e zhgënjën, e mërzit, e streson dhe e hidhëron adhuruesin lakmiar; prandaj në Bibël urdhërohet nga Zoti: "Mos lakmo" (Eksodi 20:13).

Asnjë njeri nuk ka qenë më i pasur se mbreti i famshëm Solomoni (1037-998, para Kr.), por edhe pse ishte i tillë, ai nuk gjeti kurrë lumturinë të pasuria e tij. Në fund të jetës, thotë i zhgënjyer: "Ai që i do paratë, nuk do të ngopet me para dhe ai që i do pasurinë, nuk do të ketë dobi prej saj, sepse ajo është kotësi!" (Fjalët e urta 5:10).

Këtë konstatim zhgënjyes të Solomoni e kanë bërë edhe shumë burra e gra të mençura të kohëve tona, që thonë: "Paratë ende nuk e kanë bërë një njeri të lumtur. Njeriu sa më shumë të ketë, aq më shumë do të dojë. Në vend që të mbushë një vakum, krijon një tjetër". (Benjamin Franklin, 1706-1790).

Paratë nëse nuk të sjellin lumturi, të pakën të ndihmojnë të jesh i mjerueshëm në luks" (Helen Gurley Brown, 1922-2012).

"Paratë nuk kërkohen për të blerë një nevojë të shpirtit" (Henry David Thore, 1817-1862).

"Bëjini paratë si perëndinë tuaj dhe do t'ju shkatërrtojë si djalli" (Henry Fielding, 1702-1754).

Të jesh i pasur nuk është gjë e keqe,

Lakmia për para, burim i gjitha të këqijave

përkundraz kur ajo është produkt i punës së ndershme ose trashëgimi, të siguron një mirëqenie, të jep famë të mirë, miq, guxim shëndet, lehtësi për jetën etj., por pasuria nuk mund t'i blejë të gjitha, si psh: ajo nuk mund të blejë dashurinë që është energji shpirtërore dhe nuk e shmang vdekjen, borxhin edhe armikun më të madh të njerëzve.

Steve Jobs, një nga më të suksesshit më biznes edhe ndër më të pasurit e botës në shekullin XXI, para se të mbyllte sytë më 5 tetor 2011, pas betejës së gjatë me kancerin në pankreas, la këtë letër ku flet për jetën e tij, sukseset dhe dëshmitet: "Arrita majat e suksesit në botën e biznesit. Në sytë e të tjerëve, jeta ime ishte kulmi i suksesit. Sidoqoftë, përpos punës, unë kam pak gëzime. Në fund, pasuria është vetëm një fakt i jetës me të cilin unë jam mësuar. Në këtë çast, i shtrirë në shtrat i sëmurë, ndërsa reflektoj për jetën time, kuptoj se e gjithë fama dhe pasuria që i kushtova kaq shumë kohë janë zbehur dhe duken të pakuptimta përballë vdekjes së afërt. Në errësirë shoh dritat jeshile që vijnë nga pajisjet dhe dëgjoh zërat e aparatave, mund ta ndiej frymën e zotit të vdekjes që afrohet. Tani e di, kur kemi siguruar mjaftueshëm pasuri sa për të shtyrë gjithë jetën, duhet të merremi me çështje të

Mëkat në thelb do të thotë dështim i shprehur si pabesia, blasfemia, vrasja, tradhtia bashkëshortore, kurvëria, vjedhja, gënjeshtria, etj. Të gjitha këto mëkate ngjizen nga fara e keqe e lakmisë, e cila e përshpejton vdekjen që merr fuqi nga mëkati. Kjo gjë ndodh edhe për shkak të lodhjes, stresit që të jep siguriimi i parasë së madhe, abuzimit me ato për ç'do kënaqësi mëkatore, të cilat kanë kosto për jetën, por edhe të armiqve të shumtë që krijojnë lakmia për para. Në fjalët e urta lexojmë: "Më mirë pak me frikën e Zotit, se sa një thesar i madh me shqetësime. Më mirë një pjatë me perime në cilën ka dashuri se sa një ka i majmuri në të cilin ka urrejtje" (Fjalët e urta 15: 16-17)

Vdekja për njeriun si qenie trup-shpirt është e dyfishtë, fizike edhe shpirtërore. Ajo shpirtërore është vdekja e dytë, ose vdekja e përjetshme ku njeriu, si qenie mbetet i ndarë përgjithmonë nga Zoti, të afërmit dhe krijesa. Kjo është një gjendje e frikshme shpirtërore, e cila fillon për së gjalli, por vazhdon edhe përtej varrit, d.m.th. të qëndrosh me veten ku askush nuk të ngushëllon apo nuk të thotë një fjalë: ky është ferri më i keq. Syri lakmiar dhe ferri kanë një të përbashkët, që të dy thonë se: "kurrë nuk u ngopën" njëri me pasuri dhe tjetri me viktima.

Njeriu, qoftë i pasur apo i varfër, një ditë patjetër do të vdesë dhe dihet që asgjë nuk s'oll në këtë jetë dhe asgjë nuk do të marrë me vete nga pasuria ari, argjendi, dollari, euroja apo pronat. Zoti, i Cili është i vetmi që ekziston nga vetvetja, të pasurit egoistë edhe lakmiarë do t'i thotë në kulmin e ëndrrave lakmiarë: "O i marrë, sot do të vdesësh. Kujt do t'ia lësh ato që mblodeh?" (Luka 12:20).

Një histori të tillë e kanë vërtetuar këto fjalë. "Një mbret i pasur kishte kaq shumë pasuri sa as ai vetë nuk e dinte sa kishte, kështu thirrri ekonomistë të aftë, që t'ia matin pasurinë. Dhe ai do t'i shpërblente mirë. Shumë erdhën me makina logaritëse, të përparuar për kohën, por nuk mundën. Më në fund, u gjet një plak i urtë me një litar në dorë, i cili shkoi te mbreti dhe i tha se ishte gati t'ia maste pasurinë. Mbreti i kërkoi të shikonte makinën logaritëse, por ai i tregoi litarin. Mbreti i tha zhgënjyer se këtu kanë ardhur me makina logaritëse moderne edhe nuk e kanë matur dot pasurinë time edhe t'i kërkon ta matësh me një litar. Po, o mbret, i tha plaku i urtë, me këtë litar do ta mas, por para se të më tregosh pasurinë, më çoj te varri i babait tënd. Edhe, kur vajtën te varri, plaku u përkul me mundim edhe mati gjatësinë edhe gjërësinë e varrit: një metër gjatësi me dy metër gjatësi; u kthye nga mbreti edhe me shumë siguri i tha: O mbret, kaq është pasuria jote, një metër e dy metra, aq sa mori edhe babai yt, të tjerat nuk janë të tua, por të të tjerëve".

Prandaj, duke e parë në këtë perspektivë pasurinë e kësaj bote kalimtare me gjithë lakminë e saj, fjalët e Krishtit janë gjithmonë aktuale për çdo njeri të çdo kohe: "Kini kujdes dhe ruhuni nga lakmia, sepse jeta e njeriut nuk qëndron në mbushullinë e gjërave që zotëron" (Luka 12:15) dhe "Unë, pra, po ju them: Bëni miq me pasuri të drejta (jepni lëmoshë), sepse kur këto do t'ju mungojnë, t'ju pranojnë në banesat e përjetshme" (Luka 16:9).

Kurse për ata që mbeten në lakminë e tyre deri në fund të jetës, edhe nuk do t'u bëjnë mirë me paratë e tyre të tepërta njerëzve në nevojë, do të ketë një dënim të përjetshëm në ferrin e lakmisë së tyre: "Mos u gënjini, as vjedhësit, as lakmuësit... nuk do të trashëgojnë mbretërinë e Perëndisë" (I Korintasve 6:10)... "do të kenë pjesën e tyre në liqenin që digjet me zjarr dhe saqur, që është vdekja e dytë" (Zbulesa 21: 8).

* Përgjegjës i Zyrës së Katekizimit në Kryepiskopatin e Tiranës - KOASH



Opinion i Ditës

Nga dr. Jorgji Kote

(Vijon nga faqja e parë)

... ka vite që nuk po ndalet në të gjithë Evropën. Nderkaq, javën e kaluar dha dorëheqjen kryeministri social-demokrat slovak, Robert Fico përballë protestave publike në rritje pas vrasjes makabër të një gazetari investigativ; ky i fundit po hetonte një aferë mafioze, ku përflitej edhe vetë kryeministri Fico. Të njëjtën gjë bëri homologu i tij sloven i qendrës së majtë, Miro Cerar, pasi Gjykata Kushtetuese anuloi referendumin e vitit të kaluar lidhur me ndërtimin e një korridor hekurdhor, për pasojë në këto dy vende së shpejti mund të ketë zgjedhje të parakohshme, ku ka shumë të ngjarë që social-demokratët të kalojnë në opozitë dhe të marginalizohen më tej.

Këto vitet e fundit e kanë nxjerrë më shumë në pah "firon" e vazhdueshme të social-demokratëve në pushtet, që tashmë numërohen vërtet me gishta; qeverisin më vete vetëm në Shqipëri; nuk dihet fati i tyre në zgjedhjet e vitit të ardhshëm në Danimarkë dhe Rumani; në Portugali kanë qeveri pakice, kurse në Gjermani, Estoni dhe në Luksemburg janë partnerë të vegjël të koalicionit qeveritar. Kudo gjetkë janë në opozitë anemike dhe pa shenja rikthimi në pushtet së shpejti. Dalja nga kjo gjendje e nderë përbën objektivin kryesor madhor të përpjekjeve, analizave dhe parashtrimit të alternativave bindëse për forcat e qendrës së majtë pa përjashtim në Evropë.


Shqetësimi nuk është të qëndrimi me vite në opozitë, sepse demokracia e presupozon rotacionin politik, por sepse veç humbjeve të përsëritura e të radhës, social-demokracia vazhdon të tronditet nga disfata dhe katastrofa zgjedhore; për pasojë shumë prej tyre u shkon për shtat termi "Pasokzim". Kjo dukuri e re i referohet katastrofës tragjike të PASOK-ut të famshëm ose "Lëvizja Socialiste Panhelenike Greke" e themeluar më 1974 nga politikani legjendar A. Papandreu, që drejtoi me alternim me "Nea Demokracia" skenën politike greke deri në vitin 2014. Pas shpërthimit sizmik të krizës së borxheve, korrupsionit të shfrenuar dhe krijimit të SYRIA, PASOK bëri pikiatë dhe nga fitoret e bujshme të mëparshme me 45-50 për qind, tani nuk ka më shumë se 5 për qind të votave.

Gjithsesi, dukuria më tipike e pasokzimit u shfaq vitin e kaluar në Francë, ku PS-ja që ka qeverisur vendin me dekada pësoi katastrofën më të rëndë zgjedhore me rreth 6 për qind të votave, aq sa tani është detyruar të shesë godinën e saj qendrore për të shmanjur falimentin financiar.

Në këto nivele janë edhe "homologët" e tyre holandezë, që kanë qenë vazhdimisht në qeverisje e që mezi po mbahen në këmbë me shifrën posttëruese 5,7 për qind. Diçka më mirë, por gjithsesi në gjendje të vështirë janë social-demokratët spanjollë, norvegjezë, suedezë, belgë, finlandezë, etj.

Me përjashtim të Bullgarisë, Kroacisë e ndonjë vendi tjetër gjithsesi me pak peshë, pasokzimi

Pasokzimi i social-demokracisë



ka "infektuar" edhe disa parti social-demokratë në Evropën Qendrore dhe Juglindore. Tipike janë rastet e Hungarisë, Çekisë dhe Sllovenisë, ku social-demokratët, kjo ish-pararobje historike e anti-komunizmit dhe demokracisë në Evropën Qendrore dhe Lindore luhaten me 6-10 për qind të votave. Edhe laburistët izraelitë, që kanë dominuar për dekada me fitore plebishitare deri 40 për qind, tani luhaten me vështirësi në nivelin 16 për qind të elektoratit.

Ne po ndalem të pasokzimit, sepse ka edhe më keq se aq. Kështu, veç Rusisë, në Poloni, qendra e majtë që 15 vite më parë kishte presidentin e shquar Kvasnievski dhe udhëhiqte me 40 për qind, tani nuk ka asnjë deputet! E njëjta gjendje është dhe në Letoni dhe në Turqi, madje në këtë të fundit e Majta Demokratë në pushtet për shumë vite, u shua fare në vitin 2006 bashkë me yllin e saj, ish-kryeministrin Bulent Eçevit; të zgjedhjet e fundit ajo siguroi vetëm 0,07 për qind të votave.

Ekzistonte një fare besimi se në zgjedhjet më të fundit në Gjermani, Austri dhe në Itali gjërat do të shkonin në favour të social-demokratëve, duke shërbyer edhe si inkurajim për "simotrat" e tyre

më të dobta. Por, të tria këto parti të mëdha pësuan disfata historike. Social-demokratët në Austri me 13 për qind humbën pushtetin, po ashtu SPD-ja gjermane në zgjedhjet e shtatorit 2017 ra në kuotën më të ulët të pasluftës me 20,5 për qind, kurse në pjesën ish-lindore të saj, ajo luhatet në rreth 10 për qind. Të njëjtën disfatë pësoi edhe PD-ja italiane në zgjedhjet e 4 marsit 2018 me vetëm 18,5 për qind, duke rënë edhe ajo nga pushteti.

Vërtet që këto dhe disa parti të tjera nuk janë ende në nivelin e pasokzimit, por përgjysmimi i rezultateve të tyre zgjedhore e përmban në vetvete këtë rrezik të mundshëm. Përjashtim nga kjo tablo e zymtë bëjnë laburistët britanikë të Jeremy Corbyn, që brenda 5 viteve të fundit u ngritën nga 30 në 40 për qind, me shpresë se mund të rikthehen në qeverisje në vitin 2021.

Shkaqet kryesore të kësaj gjendjeje alarmante janë paaftësia e këtyre partive tradicionale në përbalimin/menaxhimin e krizave të njohura serioze- financiare, të azilit, emigracionit, sigurisë, terrorizmit ndërkombëtar etj. Veçse ndryshe nga të djathtët, ndëshkimi politik/zgjedhor për social-demokratët është shumë më i rëndë, për shkak të disa specifikave madhore lidhur

klimë, mjedis dhe sfond politik e social shumë të disfavorshëm për natyrën e tyre racionale. Kështu, në Austri, Itali dhe gjetkë në vend të alternativave, fushatat zgjedhore ishin plot llumë, baltë, shpifje dhe fabrikime të shumta.

Faktor tjetër specifik negativ për qendrën e majtë ka qenë koninktura ekonomike dhe sociale tejet e pafavorshme e viteve të fundit me vazhdimin e mbylljes së uzinave e fabrikave e shoqëruar me dobësimin e sindikatave, shtylla dhe baza solide e social-demokracisë.

Këto dukuri e kanë zënë "gafil" të majtën evropiane, si në pushtet dhe në opozitë, pa alternativa të përpunuara të besueshme përballë të djathtës dhe forcave ekstremiste e populiste.

Por dhe kur kanë ardhur në pushtet, ndryshe nga premtimet, ata kanë vazhduar me teprim e pa kritere shkurtim e fondeve, preken e sigurisë sociale etj., duke zhgënjyer në masë dhe elektoratin më besnik. Tipik këtu është rasti i Matteo Renzi në Itali, që "premtoi qiejt", por në katër vitet e fundit asgjë nuk u bë në praktikë.

Shkaku i fundit tejet i rëndësishëm ka qenë edhe mbetet mungesa e liderëve karizmatikë, me vizion dhe guxim të politikë në një kohë kur programet e partive kanë prirjen për t'u afruar drejt njësimi. Është fjala për liderë që të paktën t'u afrohen gjigantëve të tillë social-demokratë, si Mitterand/ Delor në Francë, Brandt/ Schmidt në Gjermani, Blair në Britani, Gonzales/Zapateros në Spanjë, Suarez/Guterres në Portugali, Vranitzky në Austri, Stoltenberg në Norvegji, Rasmussen në Danimarkë, Peres/Rabin në Izrael etj.

Mirëpo kjo nuk bëhet brenda një viti, as duke "importuar" liderë nga institucionet evropiane që janë "outsiders" për elektoratin e vendeve të tyre, qoftë edhe nga Parlamenti Evropian; si në rastin e dështimit të madh të ish-presidentit të Parlamentit Evropian, Martin Schulz përballë Merkel, që e thelloi më tej krizën e SPD-së gjermane.

Patkeqsisht, shmangien e pasokzimit nuk mund ta ndihmojë as Internacionala Socialiste e botës, e cila ka vite që vuan vetë mungesën e një lideri të vërtetë. Për ironi të fatit, president i saj është ende ish-lideri i rrëzuar i Pasokut dhe kryeministër i dësh-tuar i Greqisë, Jorgos Papandreu. Ndërsa sekretari i saj i Përgjithshëm, Louis Ajala qëndron i "patundur" për 29 vjet si sekretar i saj i përgjithshëm. Edhe në krye të grupit socialist dhe të Partisë Socialiste të Evropës në Bruksel janë drejtues të njohur të partive humbëse. Kësisoj, mbetet të shpresojmë daljen sa më shpejt në skenën politike të liderëve të rinj bindës, që jo vetëm të shmangin pasokzimin e mëtejshëm, por edhe të premtojnë sa më shpejt një rifillim të ri të madh të social-demokracisë evropiane e më gjerë. Një gjë e tillë është jo vetëm në të mirën e social-demokracisë, por edhe për stabilitetin politik, ekuilibrat institucionale dhe mirëqeverisjen evropiane e më gjerë.

me funksionimin e tyre të brendshëm, sjelljet elektorale në përgjithësi dhe ndaj anëtarëve dhe simpatizantëve të tyre në veçanti.

Së pari, gjatë gati 20 viteve të fundit këto parti kanë humbur shumë terren në betejat politike; "Rruga e Tretë ose e Mesme" e Blair dhe Schroder nuk dha rezultatet e pritura. Gjithashtu, ndryshe nga konservatorët që kanë pasur dhe ende kanë më shumë hapësira për manovrim për të lëvizur e për të bërë aleanca nga e djathta, jo vetëm me liberalët bashkëpunues, por edhe me ekstremin e djathtë, qendra e majtë sidomos në Francë, Gjermani, Greqi, Austri, Spanjë etj., e ka pasur pothuajse të pamundur të lëvizë apo hapet më majtas, për shkak edhe të trashëgimisë së saj ideologjike në të kaluarën.

Nga kjo situatë kanë përfituar forcat populiste dhe të ekstremit të majtë/djathtë, të cilat kanë bërë pothuajse tërësisht "pronë" të tyre edhe tematikën e fushatave zgjedhore, duke e kufizuar atë radikalisht tek azili, siguria, varfëria, papunësia, frika dhe urrejtja ndaj të huajve, emigracioni dhe terrorizmi nga social-demokratët janë treguar të lëkundur.

Veç sa sipër, social-demokratët janë detyruar të veprojnë në një

ISH-TRAJNERI KUQEZI



Xhani de Biazzi nga 27 nëntori i vitit 2017 ka nisur pushimet e zgjatura pas shkarkimit nga stoli i Deportivo Alaves, megjithatë mrekullia e realizuar në drejtimin e Kombëtares shqiptare ku arriti t'i kualifikonte kuqezinjtë për herë të parë në finale të një Europiani vijon të jetë një kartëvizitë mjaft tërheqëse. Së fundmi emri i tij ka dalë në skenë si një prej alterna-

De Bazi në listën e Kostakurtës për stolin e Italisë

tivave për të marrë drejtimin e Italisë. De Biazzi ishte mes dy kandidatëve kryesorë për të qenë trajner i Italisë në maj të vitit 2016, pra pak ditë përpara fillimit të Europianit, por federata italiane zgjodhi Venturën. Koha tregoi se ishte një vendim i gabuar.

Tashmë që të kaltrit dështuan duke mos u kualifikuar në Kupën e Botës, në krye institucionit që drejton futbollin në gadishullin Apenin nuk është më Tavekio, por presidenti i përkohshëm, Roberto Fabricini. Ky i fundit ia ka lënë në dorë

zgjedhjen e trajnerit të ri zv.presidentit, Alessandro Kostakurta. Pikërisht ish-mbrojtësi i Milanit, i ftuar në një studio televizive në Itali, ku ka qenë së bashku me De Biazin, e ka drejtuar gishtin nga ish-tekniku i kuqezinjtë si një prej alternativave të mundshme për stolin e kombëtares 4 herë kampione e botës. Natyrisht, De Biazzi nuk është në majën e listës së dëshirave, pasi aty

qëndrojnë emra më të njohur si Antonio Conte, Roberto Mançini e Karlo Anceloti, teksa një hipotezë e realizueshme është edhe ajo e trajnerit aktual Xhixhi Di Biaxho, megjithatë e rëndësishme është që 61-vjeçari nga Samede është pjesë e kandidaturave. Thuhet që treni i ëndrrave nuk kalon dy herë, ndoshta De Biazzi do ta përgjeshetrojë këtë thënie.

Panuçi e telefoni dhe mbrojtësi vendosi menjëherë të luante për fanellën kuqezi



Jeton Selimi

Lika rrëfen emocionet, Duka vizitë Kombëtares

Dëmtim në kofshë, Etrit Berisha rrezikon

Bujar Lika është "surpriza" e radhës në grumbullimin e përfaqësueses shqiptare të futbollit. Por me sa duket, ftesa kuqezi ka qenë një surprizë edhe për vetë mbrojtësin, i cili ka zbuluar se gjithçka ka ndodhur brenda javës së fundit. "Para një jave kishim ndeshje ndaj Jang Bojz. Më kontaktoi Panuçi me një telefonatë dhe u arrit gjithçka. Pas ndeshjes vendosa, mbaroi, do luaj për Shqipërinë, u bë gjithçka për 2-3 ditë", ka thënë futbollisti gjatë konferencës së djeshme për shtyp. "Jam shumë krenar për këtë mundësi që më kanë çuar ftesën. Është mundësi e madhe për mua. Më parë kam luajtur në Kategorinë e Dytë të Zvicrës, kam pasur shumë dëmtime. Tani po mendohem të tregoj veten siç duhet dhe erdhën kontaktet me Panuçin. Kam zgjedhur të luaj për Shqipërinë, nuk kam pasur kontakte nga Kosova. Por për mua ka qenë gjithmonë ëndërr. E kam vendosur të



luaj dhe për familjen time është kënaqësi e madhe që përfaqësoj shqiponjën kuqezi. Kur kam marrë ftesën,

janë gëzuar edhe lojtarët e Grasshoppers, pasi tani Shqipëria dihet që ka vlerë të madhe, është kënaqësi e

madhe që jam këtu", tha ai. Lika do të duhet të tregojë vlerat e tij, por për të fituar një vend në formacion do ta

ketë pak të vështirë, duke llogaritur se aktualisht në pozicionin e tij luan Elseid Hysaj. "Konkurrenca është shumë e madhe me Hysajn, por do të tregoj veten në stërvitje dhe të shohim se çfarë ndodhë", tha ai.

DUKA, VIZITË KOMBËTARES

Kombëtarja shqiptare e futbollit zhvilloi seancën e parë stërvitore të saj për vitin 2018 nën drejtimin e trajnerit Kristian Panuçi. Të gjithë futbollistët që janë grumbulluar në Durrës, janë vënë nën urdhrat e teknikut italian për këtë seancë të parë. Ndonëse ka kontaktuar me shumë prej lojtarëve gjatë 24 orëve të fundit në hotel, Panuçi ka

filluar zyrtarisht përgatitjet për Norvegjinë me një mbledhje në fushën e kompleksit, duke u folur lojtarëve për rreth 10 minuta për atë që pret prej tyre gjatë këtyre ditëve. Si vëzhgues në këtë mbledhje ishte edhe presidenti i FSHF-së, Armand Duka, i cili i është bashkuar grupit të lojtarëve në fushë për disa minuta duke dëgjuar monologun e Panuçit rreth punës që duhej bërë në ditët në vazhdim nga grupi dhe nga secili individualisht. Më pas, skuadra ka vijuar stërvitjen, kurse Duka është larguar i shoqëruar nga Etrit Berisha, me këtë të fundit që nuk është stërvitur pas problemeve në kofshë. Gardiani ka kryer vizitë të specializuara. Vetëm ditën e sotme do të mësohet nëse do të jetë i gatshëm për Norvegjinë. Nuk ka qenë prezent edhe Hysaj që ka marrë leje nga stafi teknik dhe do të bashkohet nesër me ekipin. Edhe Berat Gjimeshi, për shkak të një fatkeqësie familjare është larguar nga grumbullimi për të shkuar tek të afërmit e tij. Edhe ky i fundit do të bashkohet sot në seancat stërvitore me grupin.

Braziliani përfundoi tek ekipi i të rinjve

Refuzoi të luante në mbrojtje, Uollas i hap rrugën Mavrajt

Mërgim Mavraj do të ketë një shans të artë për të rifituar vendin në javët e fundit të Bundesligës në formacionin e Hamburgut, të cilin e ka humbur pasi drejtuesit aktualë të klubit mendonin se nuk e meritonte. Shkak për ndryshimin e situatës bëhet një budallëk i mirëfillt që ka bërë një nga shokët e tij të skuadrës, mesfushori brazilian Uollas Souza Silva. Ky i fundit ishte emri i planifikuar nga skuadra për të zënë vendin e Mavrajt në qendër të prapavijës, por pasi ka refuzuar ta bëjë një gjë të tillë, është përjashtuar nga ekipi i parë, duke përfunduar te skuadra e të rinjve. Trajneri Kristian



Titz i kishte kërkuar lojtarit para ndeshjes me Herta Berlin që të rreshtohet në qendër të mbrojtjes, pasi

dëshironte ta shihte në atë pozicion, ndërsa kishte lënë jashtë 18-shes Mavrajn. Por 22-vjeçari kishte refuzuar në

stërvitje ta bënte një gjë të tillë dhe pasi ishte lënë jashtë 18-shes, as nuk ishte paraqitur në stadium për të mbështetur ekipin. Dje klubi bëri të ditur nëpërmjet një komunikate për shtyp që do të pezullonte lojtarin duke e dërguar me ekipin e të rinjve për vazhdimin e sezonit, pa llogaritur këtu edhe një gjë të majme për futbollistin. Kjo situatë rihap edhe një herë mundësinë e kthimit të Mavrajt në formacionin titullar, në një moment ku Hamburgu ka shumë vështirësi dhe rrezikon rënien nga Bundesliga për herë të parë në histori.


RRËFIMI

Roho: Murinjo më ndalon "ta thyej në mes" Sançezin

Thuajse çdo ekip futbollit ka dy shokë skuadre që urrehen. Te Mançester Junajtid kjo dyshe përbëhet nga Markus Roho dhe Aleksis Sançez. Ndërsa të gjithë në Mançester ishin të lumtur për afrimin e kilianit në radhët e "dajave të kuq" në janar, mbrojtësi nuk kishte të njëjtën ide. "Reagimi im i parë ishte 'jo atë'", tregoi Roho për "TyC Sports", duke pranuar se rivaliteti mes Kombëtares argjentinase dhe asaj kiliane kishte ndikuar në këtë lloj qëndrimi. "Aleks është një lojtar i madh, por në fushë nuk ishim mësuar të ishim shokë. Kur Junajtid luante me Arsenalin apo në Kombëtare, unë e shkelmoja atë dhe ai më shkelmonte mua. Edhe e shaja, ndërsa ai më përgjigjej njëlljo. Kur mësova se do të vinte te ne, reagimi im ishte shumë negativ". Mbrojtësi pranon se që në fillim, Zhoze Murinjo ishte siguruar që mes të dyve të mos kishte përplasje. "Ai më tha 'do të firmosim me Aleks, nuk dua që ta thyes në mes që në stërvitje nesër' dhe më pas qeshi", tregoi Roho.



Fjalëkryqi (1)



- 36. Një pjesë e dimensioneve.
- 39. Eshhtë përfaqësuesja e Adriam Mutu.
- 41. Kalimi në ekstreme.
- 42. Eshhtë e re pas Krishtit.
- 43. Shkruset për të mos vazhduar më.
- 44. Si i gjithë.
- 47. Kush e thotë lutet.
- 48. Kufij elementit.
- 49. Ishte nija që preu Aleksandri i Madh.
- 50. Një pjesë e titanëve.
- 51. Mund të jetë kundërmuese.
- 52. Pak titanike.

VERTIKAL

- 1. Si i përshatëshëm.
- 2. Mund të jenë fetare.
- 3. Ai i kuq e ka një huq.
- 4. Pak analogji.
- 6. Eshhtë metri i roboqepësit.
- 7. Në hyrje të oazit.
- 8. Arte pa re.
- 9. Artur që qe dramaturg.

HORIZONTAL

- 1. Mund të jetë kursimi.
- 5. Ylli i Nostradamus.
- 8. Të pamam pa kufij.
- 11. Ross këngëtare.
- 13. I lashë.
- 15. Eshhtë Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
- 19. Kufijë e lëvizjes
- 20. I ka tek piepi.
- 21. Paguhen për shërbim.
- 23. Fillojnë lejen.
- 24. Kufizojnë trotualet.
- 25. Bëjnë karrierë në parti.
- 27. Thahet me bonifikim.
- 28. Mund të jetë unik një i tillë
- 29. Preka komik shkordran.
- 31. Fund dhjetor.
- 32. Fillojnë aksionin.
- 33. Ente Operative Tiranë.
- 34. Agjenci Ajrore Durrës.

- 10. Janë boshte.
- 12. Michelangelo regjisor.
- 14. Mund të bëjë stil të lirë.
- 16. Ishin monedhe të Tobias.
- 17. Eshhtë bas me katër tela.
- 18. Pak efikasitet.
- 22. Eshhtë marrëveshje me nola.
- 25. Ishte babai i AKILLIT.
- 26. Fillojnë nazet.
- 27. Në krye të kuadrove.
- 29. Eshhtë faqe muri.
- 30. Një apendisit i menjëhershëm.
- 35. Kurosawa që qe regjisor.
- 36. Vriten nga espada.
- 37. Eshhtë shtet aziatik.
- 38. Edouard piktor.
- 40. Një transporti është kamioni.
- 45. Unë i Freud.
- 46. Një cigan.
- 47. Fundi i një samurait.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL

- 1. Fillojnë panikun.
- 3. Gibson aktor.
- 5. Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
- 9. Mund të jetë trofe.
- 11. Janë vendet si Katar.
- 14. Maureen që qe aktore.
- 16. Janë kundërmuese.
- 17. Mund të fitojnë etapa.
- 20. Ushtojnë nga "ola".
- 22. Një thirrje
- 26. Janë ministritë.
- 27. Një mugë në Paris.
- 28. Markë cigareje.
- 29. Eshhtë ngjirja.
- 32. Ricciarelli soprano.
- 33. Fillojnë sefte.

VERTIKAL

- 1. Një votë në favor.
- 2. Filozofi me eksperimentin e gomartit.
- 3. Në hyrje makinës.
- 4. Fillojnë lehtë.
- 5. Infancia në Dublin.
- 6. Eshhtë edhe ajo e historisë.
- 7. Një pjesë e gamiljeve
- 8. Notat pa kufij.
- 9. Ishin komitë.
- 10. Ka kryeqytet Islamabad.
- 12. Don... i Interpretuar nga Terence
- 13. Mbyllin aktet.
- 15. Janë përmasa.
- 18. Gjysma e lujjes.
- 19. Castellitto aktor.
- 20. Inicialit e Dali, piktor.
- 21. Tanita këngëtare.
- 23. Eshhtë trysni
- 24. Në hyrje të Europës.
- 25. Janë rrobat për t'u larë.
- 30. Bën mëza.
- 31. Moreau aktore.
- 32. Janë thika
- 39. Një pjesë e satelitit.
- 40. Janë teke në sende.
- 41. Pak marramendëse.
- 42. I ka tek zdapi.
- 45. Inicialit e Nolte-s.



HOROSKOPI

DASHI
Nëse mbani inat ndaj dikujt apo diçkaje, do të jetë më e zgjuar dhe e frytshme të përballeni me problemet dhe t'i tejkaloni. Bëni një zgjedhje të saktë me personat me të cilët rri, jo të gjithë ju ndihmojnë të vlerësoni cilësitë tuaja.

DEMI

Dikush do t'ju afrohet me ndjenja të sinqerta, por ngadhënjimi nuk do të jetë i lehtë. Do të pretendoni gjithmonë shumë. Në horizont shquhen mundësi të mira profesionale, që duhen shfrytëzuar menjëherë. Mos lejoni t'ju shpëtojë mundësia.

BINJAKET

Gjatë ditës së sotme, forca e vullnetit do t'ju vihet në provë. Kujtohuni për aftësitë që keni për të zburat fërkime të mundshme. Thojni 'jo' arrogancës dhe qëndroni sa më afër të mundet një personi që ka nevojë për shumë vëmendje dhe mbështetje.

GAFORJA

Në punë do të keni sukses, duke zgjidhur edhe çështjet më të vështira. Gjallëria e juaj do t'ju ndihmojë të nisni një plan ekonomik shumë fitimprurës. Mos e kërkoni në vend tjetër atë që mund të jetoni edhe me partnerin. Bashkëbisedoni me shumë.

LUANI

Një mik i ngushtë do t'ju mundojë së tepërmi. Do të donit me të vërtetë ta kishit shmangur, por është një situatë nga e cila nuk mund të dilni, prandaj organizohuni. Radhija e planetëve do t'ju mundësojë të keni një intuitë të shkëlqyer.

VIRGJERESHA

Plutoni do të bëhet nxitës i ndryshimeve pozitive, edhe për shkak pozicionimit që krijon me Jupiterin dhe Saturnin. Do t'u kushtoni shumë energji miqësive. Do të fitoni pikë në sy të familjarëve me propozimet tuaja origjinale dhe të papritura.

PESHORJA

Kujdes nga krenaria e tepërt, që rrezikon të çojë në krizë edhe çitet me lidhje të qëndrueshme. Mos u dëshpëroni nga shumë seç duhet! Dashuria e vërtetë kur të vijë, do t'ju shfaqet me qartësi.

AKREPI

Eprori juaj do që t'ju besojë një detyrë delikate dhe të rëndësishme. Tashmë e di që jeni disi kryelartë, por askush nuk e ka aftësinë tuaj. Me Venusin që bashkëvepron me Marsin, favorizohen në veçanti të gjitha veprimtaritë artistike dhe krijuese.

SHIGJETARI

Mirëpritëni krahehapur forcën pozitive të Plutonit, që ju ndihmon të rinoheni dhe ta bëni jetën gjithmonë e më interesante dhe me shumë avantazhe. Me Saturnin që nuk ju mbështet, do të jetë mirë të kufizoni lëvizjet dhe të gjeni zgjidhje efektive për t'u qetësuar.

BRICJAPI

Mos i dëgjoni mendimet e trishita që ndonjëherë ju vijnë në kokë. Heshija do t'ju ndihmojë me siguri të rivendosni ekuilibrin e brendshëm. Jupiteri do që të jeni më të shëndetshëm, kështu që shmangni ushqimet e yndyrshme.


UJORI

Në dashuri preferoni qëndrueshmërinë dhe jo një aventura të castit, që do t'ju çonte ndoshta larg qetësisë. Do të keni ritzgjim të ndjenjave dhe pasioneve, që deri më tani i keni mbajtur të fshehta. Do ta keni rrugën e lirë për të përjetuar pasionin.


PESHQIT

Qëllime të mira ju mundësojnë të shprehni më së miri ide që do të jenë fituese. Me Jupiterin kundra Saturnit mund të dalin probleme të fshehura, të mbajtura deri më tani nën kontroll. Por me pak durim dhe qetësi do të dini t'i kaloni lehtësisht.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOK

4	3	7						6
				8	2			7
		9	3			4	1	
9				8	7	5	2	
	6		1	5		3		
7	1		2	4				8
	2	1			8	9		
	7			6	9			
6						5	8	3


Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

5	2	1	9	8	6	3	7	4
3	6	9	7	1	4	5	8	2
8	7	4	3	5	2	9	1	6
6	9	7	5	2	8	1	4	3
4	3	5	1	9	7	2	6	8
2	1	8	4	6	3	7	5	9
9	4	6	2	7	5	8	3	1
7	8	2	6	3	1	4	9	5
1	5	3	8	4	9	6	2	7

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm



Argëtim filozofik

- A s'e shoh që luani rri i heshtur, por nga ai të gjithë janë të frikësuar, e qeni leh pa ndalë por prapë është i përcjmar.
- Imam Shafiu
- Ka diferencë të madhe midis pëlqimit dhe dashurisë. Nëse të pëlqen një lule e këput menjëherë, ndërsa kur e do e 'ujit' dhe përkudësesh për të gjithmonë...
- Populli
- Fëmijët gjejnë gjithçkanë në asgjë, kurse të rriturit asgjenë në gjithçka!
(Giacomo Leopardi)

Thënie të mënçura

- Nëse A është sukses në jetë, atëherë A është e barabartë me x plus y plus z.
- Puna është x, y është loja; dhe z është të mbash gojën mbyllur.
- Albert Einstein (1879 - 1955), Observer, Jan. 15, 1950
- Paratë mund të bëjnë një mashkull të pasur... Por është edukata ajo e cila e bën atë Zotëri.
- Nuk kalohet jeta duke dhënë spjegime, pasi miqtë e tu nuk kanë nevojë për to, armiqtë nuk të besojnë ndërsa budallenjtë nuk të kuptojnë.

PERGJIGJET E FJALEKRYQVE TE NUMRIT TE KALUAR

FJALEKRYQI (1)

A	L	E	X	S	G	P	O	A	Z	I
M	I	S	H	N	D	O	R	E	S	H
A	R	A	M	O	G	O	A	U	T	O
M	K	I	M	N	O	V	A	K	O	N
T	S	E	R	I	A	L	I	A	R	T
P	R	E	T	E	N	D	I	M	I	O
R	O	N	A	L	D	O	I	O	K	E
M	A	L	E	N	G	O	R	E	T	
B	A	T	A	R	I	A	T	E	R	O
T	R	O	N	A	C	E	M	Y		
L	I	R	I	K	E	P	A	R	O	D
L	O	I	R	A	C	O	R	O	T	K

FJALEKRYQI (2)

F	A	L	L	I	K	F	S	D	O	R	A
A	D	A	M	P	A	L	I	M	I	N	
L	E	M	T	A	B	E	L	A	B	E	L
A	T	K	A	P	I	T	U	L	L	I	M
N	M	A	R	I	N	A	R	I	I	L	
G	R	E	M	I	N	A	U	E	F	E	
A	R	I	F	D	E	N	T	I	S	T	
P	I	K	A	T	E	S	E	R	T	E	
C	T	I	A	T	E	M	E	T	E	O	R
O	S	Z	R	A	M	L	E	T	R	T	
S	H	E	P	I	T	E	L	E	J	A	
A	E	N	A	M	I	V	I	S	A	R	I

Argëtim filozofik

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

GSH

www.gsh.al

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

Tashmë edhe lundroni!

